



ALBANIAN UNIVERSITY
FAKULTETI I SHKENCAVE SHOQËRORE
DEPARTAMENTI I SHKENCAVE POLITIKO-ADMINISTRATIVE

TEMË
PËR MBROJTJEN E GRADËS SHKENCORE “DOKTOR”

**“EKZEKUTIMI I VENDIMEVE GJYQËSORE TË FORMËS SË PRERË, NË
KUADËR TË MBROJTJES SË TË DREJTAVE TË NJERIUT”**

PUNOI:
Amanda GJYLI (VRIONI)

UDHËHEQËS SHKENCOR:
Prof. Asoc. Dr. Ervin KARAMUÇO

TIRANË, 2020



**EKZEKUTIMI I VENDIMEVE GJYQËSORE TË FORMËS SË PRERË NË
KUADËR TË MBROJTJES SË TË DREJTAVE TË NJERIUT**

Dorëzuar
Albanian University
Shkollës Doktorale

Në përmbushje të detyrimeve të programit të Doktoratës në Shkenca Administrative, për marrjen
e gradës shkencore “Doktor”

Numri i fjalëve: 52.129
Tiranë, 2020

Doktorante:
Amanda GJYLI (VRIONI)

Udhëheqës shkencor:
Prof. Asoc. Dr. Ervin KARAMUÇO

© DEKLARATA E AUTORËSISË

Ky material nuk është prezantuar më parë në këtë institucion dhe as në ndonjë institucion tjetër të ngjashëm me të. Mënyra e mbledhjes, përpunimit dhe analizimit të të dhënave të këtij punimi është krejtësisht origjinale dhe objektive.

Vërtetohet se ky Komision Vlerësimi është mbledhur në datë _____
për të bërë vlerësimin e këtij Disertacioni të Ciklit të Tretë të Studimeve për marrjen e gradës
shkencore “Doktor” në Shkenca Administrative.

Emër Mbiemër
Titulli
Kryetar Komisioni

Emër Mbiemër
Titulli
Anëtar Komisioni

Emër Mbiemër
Titulli
Anëtar Komisioni

Emër Mbiemër
Titulli
Anëtar Komisioni

Emër Mbiemër
Titulli
Anëtar Komisioni

ABSTRAKT

Problematika që lidhet me temën në fjalë është pikërisht cënimi i procesit të rregullt ligjor nga organet shtetërore në mosrealizimin e të drejtës. Kujtdo duhet t'i garantohet e drejta për një proces të rregullt ligjor, si një e drejtë themelore e individit. Kushdo që në mbrojtje të interesave të tij, i drejtohet gjykatës, si organi shtetëror më i përshtatshëm dhe efektiv për të realizuar këtë mbrojtje nëpërmjet vendimeve të veta, duhet të përfitoj nga kjo e drejtë dhe ta realizoj atë. Të gjitha burimet e së drejtës sonë të brendshme që lidhet me procesin e rregullt, qartësojnë detyrimin e shtetit shqiptar për të ekzekutuar vendimet e gjykatave që kanë marrë formë të prerë, por kjo nuk ka qenë e mjaftueshme për respektimin e tyre. Në këto kushte situata mbetet ende pa zgjidhje, por është pikërisht ky momenti në të cilin shteti shqiptar nuk mund të humbasë kohë po duhet të ndër marrë të gjitha masat për realizimin e të drejtave dhe në këtë mënyrë do ndikoj në uljen e numrit të ankimeve në Gjykatën e Evropiane të të drejtave të Njeriut dhe sipas direktivave të kësaj të fundit do realizojë edhe detyrimin tonë për ta bërë Gjykatën Kushtetuese një mjet efektiv garantues të së drejtave. Gjykata Kushtetuese, në kuadër edhe të rekomandimeve nga të GJEDNJ është vënë në lëvizje dhe ka investuar në zgjidhjen e kësaj problematike nëpërmjet vendimeve të saj, nga ana tjetër legjislatori ka investuar në përmirësimin e kuadrit rregullator lidhur me këtë të drejtë, në dritën e rekomandimeve të vazhdueshme në Raport Progreset e Komisionit Evropian. Por deri në ç' masë ka qenë rezultativ ky investim? Në këtë këndvështrim ky punim do të shtjellojë rrjedhën e rrugëtimit të përpjekjeve për të garantuar këtë të drejtë duke sjellë në vëmendje praktikën gjyqësore dhe ndryshimet ligjore, nëpërmjet një metode analitike dhe kritike.

***Fjalët kyçe :** Ekzekutim, Vendim gjyqësor i formës së prerë, Proces i rregullt ligjor, Mjet ligjor efektiv, Gjykata Kushtetuese, Gjykata e Evropiane e të Drejtave të Njeriut.*

ABSTRACT

The problem related to the topic in question is precisely the violation of the due process by state bodies in the non-realization of the law. Everyone should be guaranteed the right to a fair trial, as a fundamental right of the individual. Whoever, in defense of his interests, addresses the court, as the most appropriate and effective state body to realize this protection through its own decisions, should benefit of this right and realize it. All sources of our domestic law related to due process, clarify the obligation of the Albanian state to execute the decisions of the courts that have become final, but this has not been enough to respect them. In these conditions, the situation still remains unresolved, but this is exactly the moment in which the Albanian state cannot waste time but must take all measures to exercise the rights and thus will affect the reduction of the number of appeals to the European Court of Human Rights (ECHR) and according to the directives of the latter will fulfill our obligation to make the Constitutional Court an effective means of guaranteeing rights. The Constitutional Court, in the framework of the recommendations from the ECHR has been set in motion and has invested in resolving this issue through its decisions, on the other hand the legislator has invested in improving the regulatory framework regarding this right, in light of the ongoing recommendations of the European Commission Progress Report. But to what extent has this investment been effective? In this perspective, this paper will elaborate on the course of efforts to guarantee this right, bringing to attention judicial practices and legal changes, through an analytical and critical method.

Keywords: *Execution, Final court decision, Due process, Effective remedy, Constitutional Court, European Court of Human Rights.*

FALËNDERIME

Është shumë e vështirë të gjesh fjalët e duhura për të shprehur falënderime ndaj atyre njerëzve të cilët bëhen bashkudhëtarë të sfidave të tua. Megjithatë, unë nuk mundem të mos përcjell dy fjalë modeste dhe shumë të përzemërta për të shprehur mirënjohjen e thellë ndaj këtyre njerëzve.

Fillimisht falënderoj udhëheqësin e këtij disertacioni Prof. Asoc. Dr. Ervin Karamuço për udhëzimet, këshillat, inkurajimin, mbështetjen, por edhe vërejtjet që më ka përcjellë gjatë realizimit të këtij studimi i cili dukej mision i pamundur.

Falënderoj për kontributin dhe mbështetjen e tyre të gjithë anëtarët e Këshillit të Profesorëve të cilët udhëhoqën të gjithë rrugëtimin e këtij cikli doktorat me shumë përkushtim. Të gjithë stafin akademik të angazhuar në studimet tona teorike, të cilët na ofruan një mësimdhënie të një niveli shumë të lartë akademik. Falënderoj çdo studiues me të cilët kam shkëmbyer mendime dhe kam marrë sugjerime të tyre lidhur me temën time.

Falënderime shkojnë për Departamentin e Shkencave Politiko-Administrative pranë Fakultetit të Shkencave Shoqërore në Albanian University, Drejtuesen Dr. Dorianana Pano, si dhe Dekanen e Fakultetit, njëherazi kryetare e Këshillit të Profesorëve Prof. Dr. Kaliopi Naska, e cila me shumë përkushtim dhe profesionalizëm ndoqi mbarëvajtjen e këtij cikli dhe na ofroi mundësinë të finalizonim objektivat tona.

Një falënderim i veçantë shkon për Drejtuesen e Universitetit, Rektoren Prof. Dr. Vera Ostreni, e cila ndërtoi shkollën doktole në Albanian University dhe mbështeti çdo doktorant në këtë udhëtimin të vështirë e të mundimshëm të tyre.

Në mënyrë të veçantë falënderoj ideatorin, themeluesit dhe investitorin e Albanian University, Z. Astrit Veliaj, i cili na dha mundësi të përfitojmë nga studime të standardeve evropiane nga pikëpamja akademike dhe infrastrukture.

Dhe së fundi, por jo nga rëndësia, një falënderim shumë i sinqertë i kushtohet familjes sime, nënës, gjyshes, bashkëshortit dhe vajzës, të cilët kanë qenë udhëheqësit e mi shpirtërorë, që me dashurinë e tyre, durimin dhe kurajën më dhanë forcën për të përballuar këtë sfidë.

PASQYRA E LËNDËS

I.	HYRJE	1
II.	PËRCAKTIMI I PROBLEMIT DHE QËLLIMI I STUDMIT	3
III.	HIPOTEZA	5
IV.	METODOLOGJIA	6

KREU I – KUPTIMI I EKZEKUTIMIT TË VENDIMEVE TË FORMËS SË PRERË NË KUADËR TË MBROJTJES SË TË DREJTAVE TË NJERIUT, RËNDËSIA DHE DIMENSIONI HISTORIK.

1.1	Zhvillimi historik i të drejtës për një proces të rregullt ligjor dhe i institutit të ekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë	9
1.1.1	Fazat kryesore historike nëpër të cilat ka kaluar parimi i procesit të rregullt ligjor	9
1.1.2	Fazat historike nëpër të cilat ka kaluar instituti juridik i ekzekutimit të vendimeve gjyqësore	15
1.1.2.1	Fillesat e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore në Shqipëri	15
1.1.2.2	Instituti i ekzekutimit të vendimeve gjyqësore në Shqipëri pas pavarësisë, deri në luftën e dytë botërore	17
1.1.2.3	Instituti i ekzekutimit të vendimit gjyqësor pas çlirimit të Shqipërisë	21
1.1.2.4	Instituti i ekzekutimit të vendimit gjyqësor pas viteve 90'	22
1.2	Rëndësia e studimit të institutit të ekzekutimit të vendimeve të formës së prerë	25
1.3	Ekzekutimi i vendimeve të formës së prerë në këndvështrimin kushtetues	30
1.3.1	Kuptimi i “Shtetit të së drejtës” dhe lidhja e tij e ngushtë me “Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut.	30
1.4	Parimi i procesit të rregullt ligjor dhe përmbajtja e tij	34
1.4.1	Aksesi në gjykatë	36
1.4.2	Mirë administrimi i drejtësisë	39
1.4.3	Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore	43

KREU II

KORNIZA LIGJORE E EKZEKUTIMIT TË VENDIMEVE GJYQËSORE TË FORMËS SË PRERË NË PROCESIN CIVIL DHE ADMINISTRATIV

2.1	Procesi i ekzekutimit të vendimeve gjyqësore civile të formës së prerë	49
2.1.1	Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore civile dhe titujve ekzekutiv	49
2.1.2	Vendimet civile të formës së prere si tituj ekzekutiv	52
2.1.3	Vënia në ekzekutim i vendimeve gjyqësore civile të formës së prerë	57
2.1.4	Ekzekutimi i vendime penale të formës së prerë si tituj ekzekutiv	61
2.1.5	Vendimet e gjykatave dhe arbitrazheve të shteteve të huaja, si tituj ekzekutiv	62
2.1.6	Mjetet e mbrojtjes kundër ekzekutimit të detyrueshëm	63
2.1.7	Pezullimi e pushimi i ekzekutimit	65
2.1.7.1	Pezullimi i ekzekutimit	65
2.1.7.2	Pushimi i ekzekutimit	67
2.1.8	Ndryshimet e fundit ligjore lidhur me mjetin e ankimit për konstatimin e shkeljes së “afatit të arsyeshëm” dhe “shpërblimit të dëmit”	69
2.2	Vendimet gjyqësore administrative dhe ekzekutimi i tyre	77

KREU III

SHËRBIMI PËRMBARIMOR NË SHQIPËRI

3.1	Kuptimi i shërbimit përmbarimor	82
3.2	Shërbimi përmbarimor shtetëror	86
3.3	Shërbimi përmbarimor privat	88
3.3.1	Shërbimi përmbarimor privat, risitë ligjore në kuadër të Reformës në Drejtësi	90

KREU IV

GJYKATA KUSHTETUESE DHE VENDIMET GJYQËSORE

4.1	Vendimet e Gjykatës Kushtetuese dhe ekzekutimi i vendimeve gjyqësore	105
4.2	Jurisprudenca e GJK që ka trajtuar mosekzekutimin e vendimeve të formës së prerë si çënim të procesit të rregull ligjor	111
4.3	Gjykata Kushtetuese si një mjet ankimi efektiv në lidhje me mosekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë	128

KREU V

GJYKATA EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT DHE EKZEKUTIMI I VENDIMEVE GJYQËSORE

5.1	Ekzekutimi i vendimeve të GJEDNJ	136
5.2	Ekzekutimi i vendimeve të GJEDNJ në RSH	148
5.3	Jurisprudenca e GJEDNJ në lidhje me ekzekutimin e vendimeve	156

KREU VI

SITUATA E RESPEKTIMIT TË TË DREJTAVE TË NJERIUT NË SHQIPËRI NË KUADËR TË VENDIMEVE GJYQËSORE (RAPORTE DHE STATISTIKA)

6.1	Situata e respektimit të të drejtave të njeriut në Shqipëri në kuadër të vendimeve gjyqësore (Raporte dhe statistika)	164
6.1.1	Analiza të raporteve nga autoritete kombëtare lidhur me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore në RSH.	166
6.1.2	Analiza të raporteve nga autoritete ndërkombëtare lidhur me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore në RSH.	188

KREU VII

KONKLUSIONE DHE REKOMANDIME 201

7.1	Hyrje	201
7.2	Konkluzione dhe Rekomandime	201

BIBLIOGRAFIA 213

LISTA E GRAFIKËVE

- Grafiku 1. Çështjet e ekzekutuara dhe në ekzekutim
- Grafiku 2. Çështjet e regjistruara në vite
- Grafiku 3. Çështjet e regjistruara në vite sipas rretheve gjyqësore

LISTA E TABELAVE

- Tabela 1. Aplikimet dhe gjykimet e rasteve të Shqipërisë në GJEDNJ
- Tabela 2. Aplikimet e rasteve të Shqipërisë në GJEDNJ në pritje
- Tabela 3. Çështjet e ekzekutuara dhe në ekzekutim
- Tabela 4. Çështjet e regjistruara në vite
- Tabela 5. Çështjet e regjistruara në vite sipas rretheve gjyqësore
- Tabela 6. Renditja e 5 rretheve me më shumë çështje në RSH dhe përqindja e çështjeve në raport me popullsinë
- Tabela 7. Përmbledhja e çështjeve dhe kategorizimi i tyre (2014-2018)

LISTA E SHKURTIMEVE

GJEDNJ	Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut
KEDNJ	Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut
GJK	Gjykata Kushtetuese
GJL	Gjykata e Lartë
GJA	Gjykata e Apelit
RSH	Republika e Shqipërisë
KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
KE	Këshilli Evropës
KEDNJ	Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut
KLD	Këshilli i Lartë i Drejtësisë
KPC	Kodi i Procedurës Civile Republikës së Shqipërisë

I. HYRJE

Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore të formës së prerë është tashmë një element procedural, i cili trajtohet si pjesë integrale e të drejtës për një proces të rregullt ligjor. E drejtë kjo e njohur shprehimisht nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë si një e drejtë themelore e individit. Ky këndvështrim i jep trajtimit të saj, jo vetëm një rol të rëndësishëm për realizimin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut, por rrjedhimisht edhe një ndikim të fuqishëm në veprimtarinë gjyqësore në vendin tonë. Objekt i këtij punimi do të jetë pikërisht analiza e institutit juridik të ekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë, si pjesë e procesit të rregullt ligjor, kategori e të drejtave themelore të njeriut. Procesi i ekzekutimit të vendimeve të formës së prerë është i mirë përcaktuar në legjislacionin tonë. Por pas ndjekjes së hapave procedurale, shumë individë e gjejnë ende veten me një urdhër ekzekutimi i cili endet prej kohësh i pa ekzekutuar. Kjo përbën shkelje të procesit të rregullt ligjor. Në këtë punim do të analizohet rëndësia e të drejtës për ekzekutim të vendimeve të formës së prerë, rrugëtimi historik i kësaj të drejte në vendin tonë, procesi i ekzekutimit si procedurë në vija të përgjithshme dhe analiza e dimensionit kushtetues të tij, në raport me dispozitat kushtetuese, me përcaktimet e Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe më e rëndësishmja jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

Theksohet dimensionin kushtetues pasi procesi i rregullt është parimi thelbësor mbi bazën e të cilit duhet të udhëhiqet puna në të gjitha shkallët e gjyqësorit, administratës publike e të gjithë autoriteteve që përfaqësojnë shtetin. Zbatimi i këtij rregulli në pamje të parë thjesht procedural, përcakton fatin e rivendosjes së të drejtave të shkelura të çdo subjekti të së drejtës.

Ekzekutimi i vendimeve është një koncept shumë dimensional dhe multidisiplinor dhe si i tillë duhet analizuar dhe trajtuar jo vetëm nga doktrina, por në veçanti nga legjislatori dhe çdo hallkë e zinxhirit të pushtetit shtetëror. E drejta për ekzekutim të vendimeve, si një e drejtë themelore është trajtuar relativisht vonë në vendin tonë. Vitet e fundit në kuadër të Reformave në Drejtësi, në zbatim të rekomandimeve të dhëna nga Bashkimi Evropian, shteti ynë është angazhuar duke ndryshuar jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese e duke riparë në mënyrë të vazhdueshme legjislacionin procedural që e parashikon, por a ka sjellë efektivitet e gjithë kjo? Duke trajtuar në themel problematikat dhe zgjidhjet që janë dhënë, analizojmë dhe efektivitetin e tyre. Në konkluzion mund të themi se përpjekjet për garantimin e kësaj të drejte nga shteti ynë kanë qenë të vazhdueshme, më së shumti të nxitura nga strukturat ndërkombëtare. Por ende shfaqen probleme në praktikë, probleme të cilat do të reflektohen në të gjithë punimin me synimin për të sjellë sugjerime në kuadër të nevojave urgjente që ka vendi ynë për të përmirësuar sa do pak situatën lidhur me garantimin e të drejtës për të ekzekutuar vendimet gjyqësore të formës së prerë, në dritën e rrugëtimit të saj drejt integritit në Bashkimin Evropian.

II. PËRCAKTIMI I PROBLEMIT DHE QËLLIMI I STUDIMIT

Qëllimi im në këtë hulumtim përfshin identifikimin e mangësive të kuadrit rregullator lidhur me elementin procedural të ekzekutimit të vendimeve gjyqësore, si komponent thelbësor i të drejtës për një proces të rregullt ligjor. Në vijim të kësaj qëllimi im është rrjedhimisht pasqyrimi i problematikave të sistemit gjyqësor dhe administrativ që kanë përgjegjësi të mbikëqyrin dhe të garantojnë këtë proces. Risitë që kanë sjellë ndryshimet e fundit ligjore dhe analiza e efektivitetit të tyre duke identifikuar rezultatet në praktikë, përmbledhje e raporteve kombëtare dhe rajonale mbi situatën aktuale në këndvështrimin e kësaj të drejte themelore, si dhe të gjetjes së instrumenteve efikase, që reformojnë dhe përmirësojnë situatën. Këto rekomandime vijnë për krijimin e zgjidhjeve përmes identifikimit të gjetjeve të mia të cilat mund të ndihmojnë ligjvënësit të orientohet në punën e tij, për të investuar në fortësimin dhe garantimin efektiv të kësaj të drejte themelore.

Me qëllim kryerjen e trajtimit sa më të plotë, ekzekutimi i vendimeve gjyqësore të formës së prerë do të studiohet në disa plane të ndërthurura njëra me tjetrën për të sjellë një pasqyrë të qartë të fokusit studimor.

Së pari, do të kuptojmë dimensionin kushtetues të komponentit procedural që analizohet, rëndësinë dhe rrugëtimin e tij në retrospektivë, së dyti rregullimin ligjor material dhe procedural, problematikave që ekzistojnë në praktikë dhe aktorët kryesorë të përfshirë, organizimi dhe funksionimi i tyre, së treti jurisprudenca që e ka konsoliduar në lartësinë e të drejtave themelore, së katërti paraqitje e situatës aktuale të garantimit të kësaj të drejte, mbi bazën e të dhënave nga autoritetet kombëtare dhe ndërkombëtare dhe së fundi analiza e detajuar e risive në planin legjislativ të viteve të

fundit që synojnë krijimin e mjetit ligjor efektiv për mbrojtjen e kësaj të drejte dhe mangësitë që shfaqin këto dispozita.

III. HIPOTEZA

Bazuar mbi temën e studimit dhe objektivat e kërkimit, në vijim gjenden hipotezat:

H0: — Rezultatet e reformimit ligjor në garantimin e së drejtës për të kërkuar ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, efektive për realizimin e kësaj të drejte në kuadër të integritit të RSH në BE.

H1: — Rezultatet e reformimit ligjor në garantimin e së drejtës për të kërkuar ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, jo efektive për realizimin e kësaj të drejte në kuadër të integritit të RSH në BE.

IV. METODOLOGJIA

Sic e kam përmendur dhe më sipër, objektivat kryesorë të këtij punimi janë hulumtime lidhur me institutin juridik të ekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë, pasi janë shumë aktuale për mbarëvajtjen dhe funksionimin e shtetit të së drejtës. Ekzekutimi i vendimeve të formës së prerë është pjesë thelbësore e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, i cili garantohet nga Kushtetuta dhe Konventa Evropiane. Metodologjia e përdorur në punim imponohet nga vetë fusha e studimit, duke iu përshtatur karakterit të temës që kam zgjedhur dhe rezultateve që kërkoj të arrij. Konkretisht, ajo përbëhet nga një kombinim midis metodës përshkruese, analitike, krahasuese dhe kritike.

Metoda përshkruese, që do të përdoret në këtë punim, ka si qëllim identifikimin e situatës aktuale të marrëdhënies juridike procedurale të ekzekutimit të vendimeve gjyqësore përfundimtare. Përshkrimi me hollësi i hapave të cilat duhet të ndjekë ajo për tu realizuar, kjo na tregon mjaftueshëm për tipologjinë e kësaj marrëdhënieje dhe problemet me të cilat përballet.

Identifikimi i problematikave nxjerr në pah mangësitë specifike, që sjellin ngërçe gjatë ekzekutimit të vendimeve gjyqësore. Interpretimi dhe analiza e legjislacionit si një proces që ka në fokus identifikimin e paqartësive që sjellin normat e së drejtës që parashikojnë këtë institut.

Interpretimi i legjislacionit për objektin e studimit. Sistemi normave juridike përbëhet nga aktet normative si ligje organike, të thjeshta, akte nënligjore etj. Rregullimet ligjore kanë nevojë të interpretohen në mënyrë që për to të gjendet zbatim efektiv. Në këtë formë mund t'i japim dritë çdo vakumi dhe çdo paqartësie të tij.

Metoda krahasuese do të pasqyrohet në vijim të interpretimit të legjislacionit, ku do të vihen përballë normat rregulluese të mëparshme dhe ato të miratuara rishtazi, duke analizuar ndryshimet, risitë, përmirësimet dhe boshllëqet.

Hulumtimi i literaturës është një tjetër metodë që i ka ardhur në ndihmë realizimit të këtij punimi, përmes akumulimit dhe përpunimit të doktrinës që lidhet me objektin e studimit. Kjo fazë përfshin: përzgjedhjen, grumbullimin dhe përpunimin e literaturës, artikujve shkencorë, kumtesave të konferencave kombëtare dhe ndërkombëtare monografive, jurisprudencës dhe vetë aktet normative që përcaktojnë në dispozitat e tyre rregullime të fushës së studimit.

Identifikimi i bibliografisë mbështetëse që ndihmoi në këtë punim, është shtrirë mbi një numër të konsiderueshëm autorësh, vendas dhe të huaj dhe mbi një sërë çështjesh, të cilat janë gjykuar nga Gjykata jonë Kushtetuese dhe Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut.

Metodologjia e analizës që është përdorur, ka pasur si objektivë të zbërthejë kuadrin ligjor ekzistues, duke shqyrtuar ato komponent që i përgjigjen qëllimit dhe objektivave të temës.

Metoda e analizës së jurisprudencës gjyqësore është gjithashtu një metodë mjaft e rëndësishme, e cila shërben për të parë mënyrën e interpretimit dhe zbatimit praktik, që gjykatat shqiptare dhe ato të huaja i kanë bërë ekzekutimit të vendimeve. Përveç jurisprudencës kombëtare, janë analizuar edhe vendime të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Analiza e praktikës së këtyre gjykatave shërben për të kuptuar më mirë institutin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, si pjesë e së drejtës për proces të rregullt gjyqësor dhe karakterin kushtetues të tij si e drejtë themelore.

Metoda kritike lidhet ngushtë me atë analitike, pasi deduksionet që rrjedhin nga analiza e kampionit përballën me situatën reale dhe efektivitetin rregullimeve ligjore aktuale.

Metoda kritike nënkupton se analizës së kampionit do t'i bashkëngjitet edhe identifikimi i problematikave që sjell ajo zgjedhje që ka bërë legjislatori për këtë çështje.

Në përfundim, mund të themi se kombinimi i metodave kërkimore shkencore për një të drejtë apo koncept juridik është tejet i rëndësishëm, pasi studime të tilla i vlejné përmirësimit të situatës.

KREU I

KUPTIMI I EKZEKUTIMIT TË VENDIMEVE TË FORMËS SË PRERË NË KUADËR TË MBROJTJES SË TË DREJTAVE TË NJERIUT, RËNDËSIA DHE DIMENSIONI HISTORIK.

1.1. Zhvillimi historik i të drejtës për një proces të rregullt ligjor dhe i institutit të ekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë

1.1.1. Fazat kryesore historike nëpër të cilat ka kaluar parimi i procesit të rregullt ligjor

Për historinë e procesit të rregullt ligjor, duke qenë se kemi të bëjmë me një nga parimet themelore, të parashikuara në aktet më të rëndësishme në rang kombëtar e ndërkombëtar, do të na duhet të kthehemi pas, deri në gjurmët më të hershme të konceptit më të gjerë të të drejtave të njeriut.

Ide me shumë vlerë dhe nocione interesante kanë përpunuar filozofët e lashtësisë greke e romake si Platoni, Aristoteli, Ciceroni, etj., të ndjekur në shekuj nga filozofët e krishterë dhe teologët mesjetarë, si Shën Thoma Akuini dhe skolastikët e të tjerë.¹

Autorë të teorisë mbi të drejtat natyrore, të ndërthurur edhe me elemente të teorive racionaliste dhe iluministe, shfaqen personalitete të shquara të kohës si Altusius, Grocius, Pufendorf, Tomasius, Volf (Christian Wolff), Ruso, Hobs, Kant etj.²

¹ L. Ikonimi “Filozofia e së Drejtës”, LL.M. Ekspres, 2006. f.18.

² L. Ikonimi “Filozofia e së Drejtës”, LL.M. Ekspres, 2006. f.19.

Nëse do të flasim për të drejtën për një proces të rregullt ligjor, një pikënisje për rregullimin ligjor të disa garancive të procesit të rregullt është konsideruar *Magna Carta Libertatum (1215)*.

Në shekullin XVII në Angli u publikua *Petition of Rights* në vitin 1628 si dhe *Bill of Rights* në vitin 1689 të cilat sanksionuan ndër të tjera gjykimin me juri dhe veçanërisht i njohuri *Habeas Corpus Act* në vitin 1679, si bazë dhe frymëzim i të gjithë dokumenteve të ardhshëm të karakterit të tillë.

“*Deklarata e të drejtave të shtetit të Virxhinias*”, e 1976-s, Deklarata e të drejtave themelore që ishte një shtojcë e Kushtetutës së 1787-s SHBA-së në vitin 1791, në këtë kuptim, ishin shumë specifike. Deklarata e të drejtave e Virxhinias, e cila u bë model i të drejtave të bashkimit për shtetet e tjera, në nenin VII përmbante pikërisht kriteret e gjykimin të drejtë. Po kështu edhe amendamentet V dhe VI të Kushtetutës federale të SHBA-vë. Burim tjetër i rëndësishëm është “*Deklarata franceze e të drejtave të njeriut dhe të qytetarit*”, ku të drejtat e njeriut, të shprehura nga revolucioni i vitit 1789 me parullën “*liberté, égalité, fraternité*”, do të materializoheshin në akte ligjore.³

Kjo Deklaratë, miratuar më 26 gusht 1789 nga ana e Konventës revolucionare që u adoptua nga Asambleja Kushtetuese në vitin 1789 dhe u bë hyrja e Kushtetutës së 1791-së, krahasohet shumë pak me dispozitat amerikane. Në nenin 9 ajo shprehet: “*Të gjithë njerëzit prezumohen të pafajshëm deri sa të mos jenë deklaruar fajtorë*”.

Këto dokumente kanë qenë instrumentet kryesore për trupëzimin e të drejtave të njeriut në sistemin ligjor kombëtar dhe në zhvillimin e parimeve ligjore të së drejtës kombëtare që ka të bëjë me çështjet e të drejtave të njeriut, veçanërisht në fushën e të drejtave

³ A. Anastasi “Historia e Institucioneve”, Pegi, Tiranë 2006. f.354.

civile dhe politike, përfshirë këtu edhe procesin e rregullt ligjor. Po kështu, nuk mund të mohohet roli që kanë pasur këto dokumente drejtpërdrejtë, përmes adoptimit të tyre në legjislacionin e shteteve të tjera, ose në mënyrë të tërthortë, nëpërmjet dokumenteve ndërkombëtarë.

Shekulli XIX solli diskutime të mëdha lidhur me nocionin e të drejtave të njeriut. Turbullirat që shoqëronin atë periudhë Evropën, mundësuan lindjen, zgjerimin dhe domosdoshmërinë e mbrojtjes dhe garantimit të kërkesave themelore ekzistenciale dhe shoqërore për çdo individit.

Koncepti i të drejtave të njeriut pranohet në rang botëror vetëm pas Luftës së Dytë Botërore. Shteti i së drejtës do të dalë në pah në fushën e përvojave kushtetuese pikërisht në këtë periudhë si përgjigje ndaj fazave të absolutizmit shtetëror.

Genocidi i kryer nga regjimet diktatoriale dhe pasojat e rënda të luftës ndërgjegjësuar popullsitë të orientojë drejt qeverisjeve demokratike. Ngjarjet e përjetuara bënë njerëzit të ndërgjegjësoheshin se vetëm një qeverisje e kufizuar mund të zbuste dhe të ekuilibronte pasionet sociale dhe politike të grupeve të ndryshme shoqërore. Kjo periudhë nxiti zgjerimin e shtjellimit të konceptit të të drejtave të njeriut, i cili u përhap nga një grup i veçantë individësh, tek të gjitha qeniet njerëzore. Kjo do të realizohej nëpërmjet pasqyrimin të tyre në krijimin e *Kombeve të Bashkuara* dhe në firmosjen e *Kartës së Kombeve të Bashkuara*, në 20 qershor të vitit 1945. Karta e Kombeve të Bashkuara i emërton këto të drejta si “të drejta themelore dhe universale”. Këto të drejta u bënë objektet kryesore të veprimtarisë së saj.

Një moment i rëndësishëm ishte krijimi i Komisionit për të Drejtat e Njeriut, të cilit iu la si detyrë hartimi i një aktit themeltar që do t'i jepte kuptim dhe do shpallte të drejtat

dhe liritë themelore. Ky akt mori emrin “*Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut*”, dhe hyri në fuqi në 10 dhjetor 1948, si “*ideali i përbashkët që duhet të arrihet nga të gjithë popujt dhe kombet në respektimin e të drejtave të njeriut*”.⁴

Kjo ishte Deklarata që miratoi përkufizimin e saktë dhe përfundimtar të të drejtave të njeriut. Komisioni i të Drejtave të Njeriut i OKB-së, përgjegjës, ndër të tjera, me ndërtimin e kësaj deklaratë, e përfshin që në krye të drejtën për një proces të rregullt ligjor në diskutimet e tij. Kurorëzimi i njohjes dhe garantimi i të drejtave themelore realizohet përfundimisht me “*Konventën Evropiane për mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe të Lirive Themelore*” dhe konventën përkatëse amerikane “*Për të drejtat e njeriut*”. Janë pikërisht neni 6 i konventës evropiane dhe neni 8 i konventës amerikane që bëjnë fjalë për procesin e rregullt ligjor.

Në fund, duhet përmendur edhe *Karta Afrikane “Për të drejtat e njeriut*”, e cila u formulua brenda kuadrit të organizatës së Unitetit Afrikan në vitin 1981. Në këtë konventë, neni 7, paragrafi 1, bëjnë fjalë për gjykimin e drejtë.

Këto akte janë instrumente rajonale të të drejtave të njeriut dhe kanë rëndësi shumë të madhe në vendosjen e universalitetit të parimeve të gjyimit të drejtë.

Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore është ratifikuar nga Republika e Shqipërisë më datë 2 dhjetor 1996. Protokollin nr. 11 i Konventës, është miratuar më datë 1 nëntor 1998 dhe parashikon detyrimin e sistemit gjyqësor që të marrë në shqyrtim në mënyrë të drejtpërdrejtë kërkesat e paraqitura të çdo individi.

⁴ A. Anastasi “E drejta Kushtetuese”, Pegi, Tiranë 2004. f.27.

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, gjatë shqyrtimit të çështjeve të aplikuara nga shtetasit shqiptar, ka trajtuar gjerësisht, ndër të tjera, argumente shumë të rëndësishme të së drejtës shqiptare që lidhen me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, si element i procesit të rregullt ligjor dhe mjetet efektive për garantimin e kësaj të drejte.

Në vendimin për çështjen *Qufaj Co Sh.P.K. kundër Shqipërisë*, GJEDNJ ka trajtuar problematikën e moszekutimit të vendimeve gjyqësore në Shqipëri.⁵

Ky ishte i pari rast që investonte GJEDNJ-në për konstatimin e shkeljes së të drejtës për një proces të rregullt ligjor, si pasojë e mos ekzekutimit të vendimit të formës së prerë. Kjo gjykatë theksoi se: *“Vonesa në ekzekutimin e një vendimi nuk mund të justifikohet në rast se ajo është në dëm të thelbit të së drejtës së mbrojtur në kuptim të nenit 6/1 të Konventës. As vështirësitë financiare të organeve shtetërore nuk përbëjnë shkak për moszbatimin e vendimeve gjyqësore.”*⁶

Në pak kohë, në çështjen *Balliu kundër Shqipërisë*⁷, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut përpos pranimit të kërkesës, konstatimit të shkeljes, në këtë vendim theksoi se kërkesat e individëve me objekt cënimin e së të drejtës për një proces të rregullt ligjor, si pasojë e mos ekzekutimit të vendimit të formës së prerë, duhet të drejtohen pranë Gjykatës Kushtetuese, e cila konsiderohet si mjet ankimimi efektiv dhe në zbatim të nenit 35 të Konventës, ezaurimi i saj është i nevojshëm.

Ky moment përkon edhe me njohjen e garancive të vërteta kushtetuese procedurale në Shqipëri.

⁵ Qufaj Co Sh.P.K. kundër Shqipërisë 30.03.2005 GJEDNJ.

⁶ Po aty.

⁷ Balliu kundër Shqipërisë 30.11.2005 GJEDNJ.

Përpara viteve 90' pushteti konsiderohej *“i vetëm, unik që buron nga.... populli dhe prandaj dhe dhënia e drejtësisë nuk formonte një pushtet të veçantë...”*,⁸ parimet mbi të cilat bazohet sot procedimi civil as nuk mund të mendoheshin që të ishin pjesë e tij, nuk kishim ende të bënim me parimin e ndarjes së pushteteve. Pas viteve 90 situata ishte ende kritike, kemi kalimin nga forma e pushtetit të centralizuar, në një ekonomi të tregut të hapur, periudhë që shkaktoi probleme mjaft të rënda.

Ndryshimet që ndodhën në politikë dhe ekonomi kishin dhënë shpresa për përmirësim të situatës, por si pasojë e sistemit të brishtë të qeverisjes, në pak kohë organizata të ndryshme kriminale vendase dhe ndërkombëtare morën një fuqi të madhe.

Megjithatë si hap të rëndësishëm konsiderojmë ratifikimin e Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore si dhe miratimin e ligjit *“Për dispozitat kryesore kushtetuese”*. Në këto akte u parashikuan disa nga komponentët e së drejtës për një proces të rregullt. Ndër të cilat mund të përmendim se *“Parimi themelor i organizimit shtetëror është ndarja e pushtetit legjislativ, ekzekutiv dhe atij gjyqësor”*, *“barazinë përpara ligjit”* apo *“pavarësinë e gjykatave”*, njëkohësisht edhe miratimi i Kodit të Procedurës Civile në vitin 1996, vlen për t'u përmendur si ligji që parashikon në mënyrë të drejtpërdrejtë këto rregulla. Mbi bazën e parimit të shtetit të së drejtës, u miratua në vitin 1998, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, në të cilën një vend të rëndësishëm mbajnë disa garanci ku do të bazohet procesi civil.

⁸ Grup autorësh *“Historia e Shtetit dhe së drejtës në Shqipëri”*, Luarasi 2005. Fq. 239.

1.1.2. Fazat historike nëpër të cilat ka kaluar instituti juridik i ekzekutimit të vendimeve gjyqësore

1.1.2.1. Fillesat e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore në Shqipëri

Nëse do t'i referohemi konkretisht parashikimeve ligjore që lidhen me “Ekzekutimin e vendimeve gjyqësore”, mund të themi se ky ka qenë një hap tepër i vonshëm për Shqipërinë.

Deri para viteve 1912, kur u shpall pavarësia e shtetit shqiptar, nuk mund të flitej për praninë e një sistemi të mirëfilltë gjyqësor dhe aq më pak për garantim të të drejtës për ekzekutim të vendimeve gjyqësore.

Kjo pasi i gjithë territori shqiptar ka qenë i pushtuar nga perandoria osmane dhe për rrjedhojë implementohej regjimi dhe ligji i saj. E ndodhur në këto kushte, Shqipëria nuk pati mundësi të konsolidonte një shtet të pavarur dhe asnjë legjislacion të shkruar.

Por, krahas këtyre fakteve, mund të themi se në zonat rurale dhe në malësinë shqiptare ka vepruar kryesisht e drejta zakonore me normat e saj materiale dhe procedurale.

Veprimi i kësaj të drejte shfaqet si një qëndresë e popullit shqiptar ndaj të huajve dhe sundimit të tyre, me qëllim mos asimilimin e tyre⁹.

Normat rregulluese të asaj kohe emërtoheshin si kanune dhe si të tilla mund të përmendim: Kanuni i Lekë Dukagjinit, Kanuni i Skënderbeut, Kanuni i Labërisë. Sipas Kanunit të Lekë Dukagjinit, *Këshilli i Pleqve* ose *Pleqësia* njihej si autoritet

⁹ K. Nova, Zhvillimi i organizimit gjyqësor në Shqipëri, UT, 1982, fq.14.

gjyqësor, dhe kishte në përbërje drejtuesit e fiseve si dhe njerëz të ndershëm të asaj zone, ose krahinës.

Në Këshillin e pleqve merrnin pjesë vetëm burra në moshë madhore¹⁰, të cilët ishin njerëz të njohur për dije të thella mbi zakonet. Mbi bazën e funksionimit të saj, pasi merrej çështja në shqyrtim, i jepnin mundësi palëve të shprehnin pretendimet e tyre nëpërmjet përfaqësuesve të tyre dhe në përfundim, në varësi të rëndësisë që kishte mosmarrëveshja, jepej verdikti si zgjidhje përfundimtare.

Procedura që zbatohet nuk kishte karakter formal, por aplikoheshin rituale që i përkisnin zakoneve shumë vjeçare të ruajtura në kohë. Çdo hap që ndiqej ishte verbal, nuk materializohej në asnjë dokument dhe as vendimi përfundimtar nuk linte gjurmë. Mbi bazën e parimeve të Kanunit¹¹ vendimet e pleqësisë ishin të detyrueshme. Menjëherë pas shpalljes, vendimet bëheshin të ekzekutueshëm.

Nëse do të analizojmë një sërë institutesh origjinale si ai i Besës, shkelja e së cilës sillte pasoja të rënda, arrijmë në konkluzionin se në këtë periudhë e drejta zakonore e bazonte ekzekutimin më tepër tek vullneti i palëve¹².

Një karakteristikë e veçantë ishte se përpara se të niste procesi gjyqësor, palët dorëzonin objekte të një rëndësie shumë të madhe për nderin e shqiptarit si armët apo kutinë e duhanit¹³. Kjo tregonte bindjen e tyre ndaj çdo vendimi që merrte Pleqësia dhe ishin pikërisht ato që quajmë sot mjetet për ekzekutimin e vendimeve.

¹⁰ K. Nova, E drejta zakonore shqiptare, UT, 1989, fq. 5.

¹¹ Paragrafi 1002 të K.L.Dukagjinit.

¹² K. Nova, Zhvillimi i organizimit gjyqësor në Shqipëri, UT, 1982, fq. 17.

¹³ Paragrafi 1022 i K.L.Dukagjinit.

Në rast se pas dhënies së pengut, palët nuk e zbatonin vendimin, atëherë Këshilli mbledhej sërish për ta detyruar atë me lëçitje apo kseniti¹⁴ dhe në disa raste parashikohej edhe masa e dënimit me vdekje.

Në krahina të ndryshme, ndryshonin edhe organet që kishin për kompetencë realizimin e ekzekutimit të vendimeve, duke iu referuar rregullave të vendosura në Kanunet përkatëse.

Kanuni i Lekë Dukagjinit parashikonte se gjobtarët ishin ata që ekzekutonin vendimet dhe ndihmoheshin në realizimin e tyre nga anëtarët e fshatit. Gjobtarët kishin të drejtën e përdorimit të forcës për të marrë pasuritë e luajtshme të debitorit¹⁵, kjo, pasi pasuria e paluajtshme nuk mund të prekej duke qenë në bashkësi të fisit.

Këto norma juridike, ndonëse në pjesën dërrmuese të tyre të pashkruara, të vendosura nga pleqtë si pjesë e të drejtës zakonore janë trashëguar në shekuj.

1.1.2.2. Instituti i ekzekutimit të vendimeve gjyqësore në Shqipëri pas pavarësisë, deri në luftën e dytë botërore

Pasi shpallet pavarësia më 28.11.1912, e cila ishte ngjarja më madhore në historinë kombëtare, Shqipëria njeh një periudhë të rëndësishme, pasi kjo kohë përkon me formësimin e saj si shtet dhe njëherazi me konsolidimin e rendit të saj juridik.

Pjesë e këtij rendi është sigurisht edhe kuadri ligjor mbi ekzekutimin e vendimeve gjyqësore, mekanizmat e zbatimit të tyre si dhe strukturat përgjegjëse.

Rrethanat në të cilat u shpall pavarësia e shtetit Shqiptar ishin të vështira dhe në këtë kuadër qeveria e Ismail Qemalit me ligjin datë 10.05.1913 “Kanuni i zhurisë” (Kanuni

¹⁴ Koncept i përdorur në Labëri që nënkupton Dënim..

¹⁵ Paragrafi 1171 i K.L.Dukagjinit.

i Jurisë) dhe me akte të tjera qeveritare, hodhi themelet e organizimit gjyqësor në shtetin e pavarur shqiptar.

Gjykatat gjykonin brenda kompetencave të tyre çështje civile e penale dhe ushtronin veprimtari në çdo nënprefekturë (si gjykata të shkallës parë).¹⁶ Gjykatat vazhduan të ndiqnin rregullat e organizimit gjyqësor të Perandorisë Osmane dhe zbatonin ligjet materiale e procedurale turke.¹⁷

Të gjitha ligjet shqiptare që rregullonin sistemin gjyqësor në vitet 1914 - 1928 e lidhin përmbarimin me gjykatën.

Fillesat e shërbimit përmbarimor gjyqësor privat, si një veprimtari aktive në funksion të ekzekutimit të vendimeve përkon me vitin 1915, pas një periudhe tre vjeçare nga momenti i ndërtimit të shtetit. Vitin e parë, në zonat e uzurpuara nga Italia, gjykimet civile mbuloheshin nga gjykatat me karakter fetar. Ekzekutimi i vendimeve të këtyre gjykatave ishte përgjegjësi e kryetarit të gjykatës.

Është interesant fakti i rëndësisë që merrte ky profesion në atë kohë, ku kërkesa ligjore për autoritetin, i cili do duhej të lejohej të përmbarimojë akt-gjykimet përmbante shumë komponentë si: aftësitë morale, juridike, diplomë universiteti, ose vërtetim se “kandidati ka vepruar së paku 10 vjet si avokat”.¹⁸

Për më shumë se 10 vite, në periudhën 1915-1928, veprimtaria e shërbimit përmbarimor është materializuar në dokumente dhe shkresa të cilat gjenden edhe sot

¹⁶ I. Nocka, Gjyqtarët e Shqipërisë gjatë gjysmëshekullit Drejtësia Popullore, Nr 5, 1962.

¹⁷ N. Papuli, Organizimi i shtetit të parë shqiptar Drejtësia Popullore, Nr 5, 1962, fq. 32.

¹⁸ <http://www.nchb.al/historiku-2>

në arkivat e shtetit. Në atë kohë ky shërbim funksiononte në një zyrë të veçantë dhe drejtohej nga Ministria e Drejtësisë.¹⁹

Procesi i shkëputjes nga legjislacioni, tashmë i vjetërsuar otoman, vijoi duke u intensifikuar akoma edhe më shumë gjatë periudhës së Monarkisë. Një hap i rëndësishëm drejt kësaj rruge, ishte miratimi i Kodit Civil nga Ahmet Zogu, më datë 1 Prill 1929, që njihet edhe sot si Kodi Civil i Zogut.

Për të evituar mangësitë dhe aplikimin praktik që shfaqti me hyrjen në fuqi shtojca e parë, solli si produkt shtojcën e dytë të Kodit të procedurës civile, e miratuar në vitin 1929. Në këtë mënyrë vazhdon procesi i miratimit të ligjeve të tjera me këndvështrim perëndimor në fushën procedurale civile.

Kreu IX i Procedurës Civile rregullon procedurën e ekzekutimit për shlyerjen e një detyrimi në të holla. Mbi bazën e këtij kreu, ligji pajiste kreditorin, kur nëpërmjet dokumentacionit mund të vërtetonte detyrimin e debitorit, me të drejtën për të kërkuar vendosjen e sekuestros mbi pronat apo pasuri të tjera të debitorit për efekt të shlyerjes së kredisë. Vendimet e formës së prerë kishin fuqi ekzekutive nga ligji dhe nuk kërkohej një garanci kur kërkimi bazohej në një vendim të tillë.

Ligji u jepte fuqi ekzekutive vendimeve gjyqësore të formës së prerë, pasi parashikonte se garancia nuk kërkohej kur pretendimi i tij bazohej në një vendim të ekzekutueshëm.

Në ndryshimet që pësoi ligji procedural otoman, mund të përmendim nenin 274 i Shtojcës së Parë, i cili parashikonte sendet që nuk mund të sekuestroheshin. Në veçanti

¹⁹ <http://www.nchb.al/historiku-2>

ndalohej sekuestrimi i shtëpisë së banimit të debitorit dhe tokës së nevojshme për mbajtjen e familjes²⁰.

Mbi bazën e nenit 296 të Shtojcës së Parë, sekuestro mund të vendosej edhe tek sendi mbi të cilin ishte vendosur peng për garantimin e detyrimit. Kusht do të përbënte fakti që nga shitja e tij do të likuidohej së pari e gjithë kredia dhe më pas kreditorët e tjerë. Ndërsa në ndryshimet që solli Shtojca e dytë për procedurën civile mund të përmendim kreun XXI që parashikon “Çpronësimi i forcuem i pronave, shkallësimi dhe distribuimi i çmimit midis kreditorëve”, i cili fragmentoi rregullat për realizimin e procesit të ekzekutimit të detyrimeve në të holla.

Një risi të rëndësishme solli edhe miratimi i Statutit Themeltar të Mbretërisë Shqiptare, i cili përcaktonte se: “Vendimet e gjyqeve nuk mund të ndryshohen dhe ekzekutimi i tyre nuk mund të ndalohet ose të pezullohet prej asnjë pushteti tjetër, qoftë Legjislativ ose Përmbarues”²¹.

Lidhur me ligjin për shërbimin përmbarimor, gjatë mbretërisë së Zogut, u realizua një përmirësim në dekret ligjin mbretëror të datës 09.08.1937.²² Në nenin 4 të këtij Dekreti përcaktohet se përveç vendimeve gjyqësore, titujt përmbarimor, janë edhe aktet, të cilave ligji i njej karakterin ekzekutiv si dhe akt marrëveshjet /aktet kontraktuale të hartuara prej një noteri ose nëpunësi tjetër kompetent nga pikëpamja ligjore për hartimin e tyre.

Gjatë kohës së luftës, mbeti në fuqi e njëjta procedurë civile si në kohën e Zogut në të gjitha zonat e pushtuara.

²⁰ Neni 271-296 Shtojca e Parë e Procedurës Civile.

²¹ Neni 118 i Statusit Themeltar të Mbretërisë Shqiptare.

²² Dekret ligjin mbretëror të datës 09.08.1937 “Mbi Përmirësimin e disa dispozitave të Procedurave dhe Ligjës së Përmbarimit në Fuqitë”.

Ndërsa në zonat e çliruara, vepronin Këshillat Nacional Çlirimtare. Drejtësia penale ishte kompetencë e gjyqeve partizane, ndërsa ajo civile mbeti kompetencë e pandarë e këtyre këshillave.²³ Sipas urdhrit të Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Nacional Çlirimtare të Shqipërisë, në lidhje me ekzekutimin e vendimeve të këshillave, përcaktohej se, mosmarrëveshjet civile janë në kompetencë të këshillave nacionale-çlirimtarë. Komanda e qarkut dhe e rrethit janë të detyruara të ekzekutojnë vendimet e tyre.²⁴

Organet e shërbimit përbarimor në vitet 1944-1951, ishin nënstrukturat e sistemit të drejtësisë, të krijuara nga rregulloret e autoriteteve të reja të pushtetit popullor. Këto struktura, nuk kryenin veprimtari të mirëfilltë përbarimore, por zgjidhnin vetëm problemin e rivendosjes në posedim²⁵.

1.1.2.3. Instituti i ekzekutimit të vendimit gjyqësor pas çlirimit të Shqipërisë

Pas çlirimit, ligjet e mëparshme e humbën fuqinë detyruese dhe mund të shërbenin vetëm si bazë për dhënien e drejtësisë për atë që nuk i kundërviheshin frymës së re demokratike²⁶.

Kodi i Procedurës Civile i vitit 1958 hodhi një hap të rëndësishëm në qartësimin e procesit të ekzekutimit të vendimeve gjyqësore. Përpos karakterit idealo-politik që kishte ky akt, prodhim i asaj periudhe, në përmbajtje ishte mjaft i plotë dhe cilësor

²³ Ma. I. Barjamaj, Ekzekutimi i detyrueshëm i vendimeve gjyqësore dhe problematika e praktikës gjyqësore, Disertacion, Tiranë 2016, fq. 21.

²⁴ K. Nova, "Zhvillimi i organizimit gjyqësor në Shqipëri", Botim i UT Fakulteti i shkencave politike e juridike, 1982, faqe 104.

²⁵ <http://www.nchb.al/historiku-2/>

²⁶ Ligji nr.61 date 17.05.1945, gazeta zyrtare nr.12 date 22.05.1945.

lidhur me çështjen e ekzekutimit të vendimeve. Madje në disa aspekte Kodi i vitit 1958 paraqitet më i qartë në formulim dhe në përmbajtje.

Nga ana tjetër, neni 27 i ligjit Nr.4406 datë 24.06.1968 “Mbi organizimin gjyqësor”, përcaktonte statusin e përmbauesit gjyqësor. Ai ushtronte detyrat e tij pranë gjykatës së rrethit, nën kontrollin e kryetarit të gjykatës, duke eliminuar kështu tërësisht pavarësinë të një përmbauesi gjyqësor.

Në vitin 1981, u miratua Kodi i Procedurës Civile. Ky ishte Kodi i dytë për periudhën së socializmit. Ky akt shtjellonte në mënyrë të detajuar punën e gjykatës dhe i atribuonte asaj një rol tepër aktiv gjatë hetimit gjyqësor.

Lidhur me aspekte mbi ekzekutimin e detyrueshëm të vendimeve, ai parashikon se kush janë titujt ekzekutiv. Gjithsesi ky Kod nuk pati lartësinë e Kodit të Procedurës Civile të vitit 1958, i cili ishte tepër i ngjashëm me atë që është aktualisht në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

1.1.2.4. Instituti i ekzekutimit të vendimit gjyqësor pas viteve 90’

Fillimi i viteve 90, shënoi ndryshimin e regjimit nga ai totalitar, në sistem demokratik dhe argumenti i pavarësisë së pushteteve mori një dimension të gjerë dhe me baza të vërteta.

Të pranoje parimin e ndarjes së pushteteve, nënkuptonte dorëheqjen nga epërsia e pushtetit në duart e një njeriu të vetëm. Ky ndryshim thelbësor, i hapi rrugën pavarësisë reale të pushtetit gjyqësor.²⁷

²⁷ <https://www.nchb.al/historiku-2/2/>

Në lidhje me funksionimin e shërbimit përbarimor, ai në vitet 1991-2001 qëndroi si strukturë administrative, i atashuar dhe në varësi direkte të gjykatave të rretheve.

Në datë 18.01.2001 hyn në fuqi ligji “Për organizimin dhe funksionimin e shërbimit të përbarimit gjyqësor”. Ishte ligji i parë i miratuar me shumicë të cilësuar, i cili parashikonte organizimin dhe funksionimin e shërbimit përbarimor gjyqësor shtetëror në vendin tonë.

Ky ligj trajtoi në mënyrë të veçantë këtë shërbim, i cili funksionon edhe sot si i tillë, autonom dhe i pavarur nga hallkat e sistemit gjyqësor, por në varësi direkte hierarkike dhe të centralizuar nga Ministria e Drejtësisë.²⁸

Pra, për herë të parë kemi shpëputjen zyrtare të shërbimit përbarimor nga strukturat e gjyqësorit, duke kaluar si autoritet administrativ, nën epërsinë e Ministrisë së Drejtësisë.

Në 13 Korrik 1995, Shqipëria iu bashkua Këshillit të Evropës. Nga ky moment, në mënyrë të vazhdueshme në një nga pjesët e tyre, Raport Progreset ndërkombëtare ngulmonin ekzekutimin e vendimeve gjyqësore apo titujve ekzekutiv. Zbatimi i rekomandimeve të parashikuara tek ato raporte, rrisin ndjeshëm edhe sot mundësinë e anëtarësimit të vendit tonë në Bashkimin e Evropian.

Në vitin 2004, u krijua dhe u miratua Plani Kombëtar i Veprimit mbi Rregullimin e Sistemit të Drejtësisë, në të cilin u planifikua se në vitet 2005-2007 do të merreshin të gjitha masat që legjislacioni mbi shërbimin e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore të përafrohej me rregullat dhe standardet ndërkombëtare dhe ato të BE, me ndërtimin e

²⁸ <https://www.nchb.al/historiku-2/2/>

një strukturë të bazuar në shërbimin e dyfishtë: shërbimit përmbartimor publik dhe atij privat.

Nga ai moment shumë ekspertë të kualifikuar vendas dhe të huaj punuan për vite me radhë. Këto përpjekje u finalizuan në vitin 2008, me dërgimin në Parlament të Ligjit nr.10031 “Për Shërbimin Përmbartimor Gjyqësor Privat”.

Në vitin 2010, përfituan licencën 62 përmbartues, përmbartuesit e parë gjyqësorë privat. Ata iu nënshtruan një procesi konkurrimi, i cili u drejtua dhe u kontrollua nga Ministria e Drejtësisë. Puna e këtij shërbimi nisi tre vjet më pas, ku u bënë më të prekshme avantazhet e funksionimit të tij.

Në tetor të vitin 2010, kur morën jetë licencat e para, vetë përmbartuesit privat themeluan Dhomën Kombëtare të Përmbartuesve Gjyqësorë Private. Për funksionimin e saj ata hartuan dhe miratuan një Statut si dhe organizuan zgjedhje për ngritjen e strukturave të brendshme të Dhomës dhe drejtuesit e saj.

Sot numri i licencave përmbartimore arrin në 150 përmbartues gjyqësor privat. Këta përmbartues realizojnë veprimtarinë e tyre në të gjithë territorin e vendit dhe organizohen si shoqëri tregtare për ofrimin e shërbimit përmbartimor ose si persona fizikë.²⁹

Dhoma Kombëtare e Përmbartuesve Gjyqësorë Privatë e Shqipërisë, është anëtarësuar në “Organizatën Botërore të Përmbartuesve Gjyqësorë” (UIHJ) që nga viti 2012, me të gjitha të drejtat.

²⁹ <http://www.nchb.al/historiku-2/3/>

1.2. Rëndësia e studimit të institutit të ekzekutimit të vendimeve të formës së prerë

Instituti juridik i ekzekutimit të vendimeve të formës së prerë merr vlerë juridike jo vetëm nga legjislacioni procedural, por edhe nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, e cila është akti themelor, që qëndron në vendin e parë të hierarkisë të së drejtës tonë, si edhe nga Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut.

Ky institut nuk është i parashikuar shprehimisht në këto akte, por fillimisht jurisprudenca e Gjykatës Evropiane e të Drejtave të Njeriut dhe më pas edhe ajo e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, e kanë konsideruar ekzekutimin e vendimeve të formës së prerë si pjesë të rregullave të procesit të rregullt ligjor.

Procesi i rregullt ligjor është një koncept kushtetues i cili është trajtuar gjerësisht nga jurisprudenca e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe vitet e fundit edhe nga jurisprudenca e Gjykatës tonë Kushtetuese. Ato kanë pranuar se rregullat që e përbëjnë të drejtën për një proces të rregullt duhet të zbatohet jo vetëm brenda një procesi gjyqësor por edhe në procedurat administrative.

Procesi i rregullt plotësohet me fjalën “ligjor” në fund për t’i dhënë kuptim më të gjerë fushës së veprimtarive që garanton. Nga këtu del edhe fakti se faza e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore përbën pjesë integrale të konceptit të procesit të rregullt.

Në vendimin nr.17, datë 12.11.2004 të Gjykatës Kushtetuese pavarësia e gjyqtarit, paanësia e tij gjatë gjykimit, e drejta për t’u dëgjuar, mbrojtur etj, janë konceptuar si komponentë thelbësorë të parimit të procesit të rregullt ligjor.³⁰ Mosrespektimi i

³⁰ Vendim Nr.17, datë 12.11.2004 GJK.

procedurës për realizimin e këtyre standardeve në një proces gjyqësor është konsideruar si cenim i vet thelbit të tij dhe rrjedhimisht i një prej të drejtave themelore të njeriut.

KEDNJ, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, jurisprudenca e GJEDNJ dhe ajo e Gjykatës Kushtetuese njëzëri kanë pranuar se e drejta për një proces të rregullt ligjor përbën një nga të drejtat e pakufizueshme të individit.

Ajo është një e drejtë nëpërmjet së cilës individëve u garantohet realizimi i procedurave të rregullta, të paanshme dhe të ndershme ligjore. E drejta për një proces të rregullt ligjor përcaktohet si një garanci për individët kundër parregullsive të veprimeve të organeve publike, si dhe një detyrim për ata që të mos shkelin të drejtat dhe liritë e individit pa u siguruar procesi i rregullt ligjor.

Jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese në çështjet kundër Shqipërisë, në veçanti pas viteve 2000 ka analizuar elementë të ndryshëm të parimit për një proces të rregullt. Kjo gjykatë ka theksuar vazhdimisht se respektimi i këtyre elementëve garanton të drejtën kushtetuese të cilitdo për një proces të rregullt ligjor, si një e drejtë themelore. Dhe cënimi i të tilla parimeve do të konsiderohet në çdo rast si shkelje të Kushtetutës”.³¹

Mbi bazën e rregullave procedurale të Republikës së Shqipërisë që parashikojnë rastet e procedimit disiplinor ndaj gjyqtarëve, si dhe nocioneve kushtetuese të së drejtës së qytetarëve për të gëzuar një proces të rregullt ligjor, në kuptim të disa neneve të Kushtetutës, si dhe të nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut vërehet se kemi të bëjmë me rregulla të një rëndësie të madhe dhe shumë dimensionale.

³¹ Vendim nr 75, datë 19.4.2002 i GJK.

Parashikimi i së drejtës për një proces të rregullt ligjor në këto akte, i jep asaj jo vetëm një rëndësi të madhe, por e fut atë në kategorinë e të drejtave të njeriut. Përgjegjësia për mbrojtjen e të drejtave të njeriut bie mbi shtetin dhe kjo përgjegjësi reflektohet në detyrimin e tij që t'u japin të drejtave të njeriut një ndërtim të qartë, qëndrueshmëri, të kuptuarit, garantimin dhe respektimin e tyre duke investuar në përmirësimin e kuadrit ligjor, institucioneve dhe mekanizmave të ndryshme. Për këto arsye të drejtat e njeriut përbëjnë një temë me rëndësi të madhe në këtë kohë të globalizimit në të cilën ndodhemi. Asnjë koncept i kohëve të fundit në historinë njerëzore nuk ka qenë më i rëndësishëm për të mbartur synimin dhe përgjegjësinë e së ardhmes njerëzore sesa “*Të Drejtat e Njeriut*”.

Respektimi dhe garantimi i të drejtave të njeriut është prej çështjeve themelore kushtetuese që qëndron në fokusin kryesor të ndërtimit të shtetit të së drejtës në Republikën e Shqipërisë.

Nëse do të analizojmë konceptin e Shtetit të së Drejtës, në kuptimin material, ai do të nënkuptojë kërkesat për të garantuar përmbajtjen e ligjeve të caktuara, mes të cilave vend të veçantë zënë aktet mbi të drejtat dhe liritë themelore.³²

Shteti i së drejtës ende sot, mund të shihet si utopi dhe mbetet një prej sfidave kryesore të çdo shteti demokratik të realizojë ndërtimin dhe garantimin e tij. Padyshim e gjithë

³² B. P., Staatsrecht, Mynih, 1996, fq. 266; dhe D.Biba & Xh. Zaganjori, Rule of Law and Albanian Institutional Reality, në Political Thought, 2010 Fq. 32.

kjo kërkon një angazhim tepër serioz nga shteti, institucionet shtetërore si dhe nga ana e vetë qytetarëve.

Nuk mund të themi se është i shkurtër dhe i parëndësishëm rrugëtimi i deritanishëm i konsolidimit të Shtetit të së Drejtës në Republikën e Shqipërisë, por ky rrugëtim vazhdon edhe sot dhe mbetet ende një ndër kushtet për integrimin e saj në familjen Evropiane. E theksoj këtë për të reflektuar rëndësinë që ka trajtimi i elementëve të tij dhe kontributi në rekomandime që shkojnë në ndihmë të nevojës për përmirësime.

Në këto kushte, implementimi i kriterëve të veçanta në organizimin dhe funksionimin e vetë shtetit, kanë një ndikim dhe një rëndësi të madhe dhe të drejtpërdrejtë në avancimin ose jo, të procesit të integritit në familjen evropiane.³³

Vështirësi të konsiderueshme, pa dyshim që lindnin gjatë zbatimit të kërkesave të posaçme të çdo elementi në përditshmëri.³⁴ Pikërisht për këtë arsye, me të drejtë theksohet se zbatimi në praktikë i elementeve apo standardeve të parimit të shtetit të së drejtës, përbën një nga sfidat kryesore me të cilat përballet sot edhe shteti dhe shoqëria shqiptare.³⁵ Pra ndahen dy faza të rëndësishme lidhur me njohjen dhe respektimin e të drejtës për një proces të rregullt ligjor. Fillimisht është integrimi i të tilla garancive në kuadrin tonë ligjor dhe më pas garantimi efektiv i tyre.

³³ Prof. Dr. Xh. Zaganjori, Prof. Dr. A. Anastasi, Dr. E. Methasani, Shteti i së drejtës në Kushtetutën e RSH, Aled Print, Tiranë, 2011, fq. 7.

³⁴ Prof. Dr. Xh. Zaganjori, Prof. Dr. A. Anastasi, Dr. E. Methasani, Shteti i së drejtës në Kushtetutën e RSH, Aled Print, Tiranë, 2011, fq. 19.

³⁵ D.Biba, Xh.Zaganjori, Implementing the rule of law in Albania, në "Political Thought", Shkup, 2010. Fq. 32.

Nëse do të spostojmë fokusin tek objekti konkret i këtij punimi, mund të themi se çdo angazhim, iniciativë apo reformë e ndërmarrë në ndihmë të garantimit të ekzekutimit të vendimeve të formës së prerë, i shërben konsolidimit të të drejtave themelore të njeriut si dhe forcimit të shtetit të së drejtës në tërësi.

Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore është një detyrë e shtetit, jo vetëm në përcaktimin e anës formale por edhe në garantimin e kësaj të drejtë. Pengesat që dalin për të ekzekutuar një të drejtë të fituar gjyqësisht sjellin mungesë të besimit dhe sigurisë juridike të qytetarëve ndaj sistemit gjyqësor.

Faktet tregojnë se ende sot kemi plot raste të moszekutimit të vendimeve gjyqësore, të pezullimit të tyre në formë jo ligjore si dhe vazhdim të kërkesave drejtuar Gjykatës Kushtetuese dhe GJEDNJ-së me këtë objekt. Këto rrethana i japin një rëndësi të veçantë trajtimit të ekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë si pjesë integrale e rregullave për një proces të rregullt ligjor dhe katalogut të të drejtave të njeriut.

1.3. Ekzekutimi i vendimeve të formës së prerë në këndvështrimin kushtetues

Objekti i këtij punimi është një institut i së drejtës me karakter procedural, “Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore që kanë marrë formë të prerë”, por këndvështrimi i studimit do të lidhet ngushtësisht me dimensionin kushtetues të tij.

Parimi bazë kushtetues nga i cili udhëhiqet e gjithë procedura civile, penale dhe ajo administrative është parimi i procesit të rregullt ligjor, kategorizuar si e drejtë themelore e njeriut. Nga zbërthimi që i bën jurisprudenca parimit të procesit të rregullt ligjor, dalin dhe rregullat apo të drejtat të cilat formojnë bazën e tij. Një prej të drejtave, që konsiderohet pjesë përbërëse e procesit të rregullt ligjor është “Ekzekutimi i vendimeve të formës së prerë”.

Nga ana tjetër, garantimi i ekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë është detyrë e çdo shteti dhe në këtë kuadër, cënimi i kësaj garancie lëkund besimin e individëve jo vetëm ndaj pushtetit gjyqësor dhe njëkohësisht ndaj shtetit ligjor në tërësi. Si e drejta për një proces të rregullt ligjor, ashtu edhe parimi i shtetit të së drejtës janë ndër konceptet themelore kushtetuese.

1.3.1. Kuptimi i “Shtetit të së drejtës” dhe lidhja e tij e ngushtë me “Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut”

Shteti i së drejtës është një nga parimet kryesore dhe “gurthemel” i demokracisë si formë e qeverisjes. Në shtetin e së drejtës ligjet dhe e drejta në përgjithësi hartohen dhe zbatohen në kuadrin e pluralizmit politik. Zbatimi i shtetit të së drejtës në përditshmëri

realizohet nëpërmjet trupëzimit të tij në nenet e Kushtetutës dhe akteve të tjera normative.³⁶

Parimi i shtetit të së drejtës vjen nga anglishtja “The rule of law” dhe i referohet traditës së shquar anglo-saksone. Ai përkufizohet si një sistem ku të gjithë nënshtrohen dhe përgjigjen përpara ligjit, i cili duhet të zbatohet drejt, ku pushteti shtetëror kufizohet nëpërmjet tij, me qëllim që të mbrohen shtetasit nga ushtrimi arbitrar i këtij pushteti, të garantohen liritë e tyre civile dhe t’i mbrojnë ato në gjykata të pavarura.

Në RSH parimi i shtetit të së drejtës parashikohet në mënyrë të shprehur në Kushtetutë, konkretisht në Preambul, në nenin 3, në nenin 4 dhe në dispozita të tjera të saj, të cilat në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, përcaktojnë rregulla, me zbatimin e të cilave, shteti implementon rrjedhimisht parimin e shtetit të së drejtës.

Mbështetur në këto norma, kanë hyrë në fuqi një sërë aktesh të tjera ligjore e nënligjore të cilat janë hartuar mbi bazën e ekspertizave ndërkombëtare, ku më i rëndësishmi mund të përmendet Këshilli i Evropës. Në tërësi këto akte normative përbëjnë një kuadër të plotë ligjor që synon implementimin dhe garantimin e rregullave të veçanta të këtij parimi në vendit tonë.³⁷

³⁶ Prof. Dr. Xh. Zaganjori, Prof. Dr. A. Anastasi, Dr. E. Methasani, Shteti i së drejtës në Kushtetutën e RSH, Aled Print, Tiranë, 2011, fq. 17.

³⁷ European Commission, Analytical Report, SEC (2010), 9.11.2010.

Përpos plotësimin të një kuadri ligjor të qëndrueshëm për njohjen dhe zbatimin e parimit të shtetit të së drejtës, duhet të ekzistojnë edhe mekanizmat për garantimin e tij. Aktualisht në vendit tonë, garanci reale është Konventa dhe Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Këshilli i Evropës, OSBE/ODIHR, si dhe konventa e traktate të tjera ndërkombëtare.

Nga sa më sipër konkludojmë se, në një shtet të caktuar, respektimi sa më i mirë i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut vjen si shkak pasojë e zbatimit të parimit të shtetit të së drejtës. E parë në këtë këndvështrim mund të thuhet se garantimi i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut bashkekziston me shtetin e së drejtës.

Në Konferencën Botërore për të Drejtat e Njeriut në Vjenë, në vitin 1993, u riafirmua lidhja e pandashme mes parimit të shtetit të së drejtës dhe garantimit të të drejtave të njeriut. Gjatë konferencës u theksua se shkelja e parimit të sundimit të ligjit është një nga pengesat më të mëdha për garantimin e të drejtave të njeriut.

Në këtë kuadër, ky punim synon të nxjerr në pah rëndësinë e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë, si pjesë e të drejtave të njeriut, si dhe të kontribuojë sado pak zërthimin e dimensionit kushtetues tij.

Nëse do të flasim për *Shtet të së Drejtës* ku mbizotëron *Sundimi i Ligjit*, nuk kemi të bëjmë vetëm ekzistencën e ligjit dhe njohjen e tij nga populli, por me efektivitetin dhe zbatueshmërinë e tij në praktikë. Prandaj, shteti duhet të krijojë institucione e

mekanizma efektive që e mbikëqyrin zbatimin e sistemit ligjor, duke përfshirë organet administrative, gjykatat, prokurorinë, policinë si dhe institucione të ekzekutimit të drejtësisë.

Sa më sipër, mund të themi se ekzekutimi i vendimeve përfundimtare të gjykatës përbën një komponent kryesor për përmbushjen e misionit të shtetit të së drejtës, si element thelbësor i të drejtës për një proces të rregullt ligjor, e drejtë kjo themelore e njeriut.

Asnjë organ publik nuk ka të drejtë të rishqyrtojë drejtësinë e vendimeve gjyqësore që kanë marrë formë të prerë. Çdo autoritet publik detyrohet të marrë masat përkatëse të nevojshme për zbatimin e tyre.

1.4. Parimi i procesit të rregullt ligjor dhe përmbajtja e tij

Parimi i procesit të rregullt ligjor është një element themelor kushtetues i sanksionuar në Kushtetutën e vitit 1998 si një e drejtë themelore.

Ky parim përpos parashikimeve të neneve të Kushtetutës tonë, ngrihet në nivel evropian duke u sanksionuar në Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut, në nenin 6 të saj. Procesi i rregullt është i mirë përcaktuar nga aktet normative të Bashkimit Evropian dhe është konsoliduar prej vitesh nga jurisprudenca e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. E drejta për një proces të rregullt merr një vlerë shumë të madhe pikërisht nga interpretimi që i ka bërë GJEDNJ.³⁸

Përcaktimi i kësaj të drejtë në KEDNJ duhet sqaruar, pasi procesi i rregullt ligjor është një koncept më i gjerë se procesi i rregullt gjyqësor. Ky i fundit lidhet vetëm me organe kryesisht gjyqësore dhe quasi-gjyqësore. Termi ‘ligjor’ përfshin të gjithë procesin e përfitimit të të drejtave të shkelura nga gjykata, përfshi këtu edhe autoritet e tjera që lidhen me ekzekutimin e vendimeve, për të arritur kështu realizimin dhe riparimin e plotë të çdo dëmi të pësuar.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, ligji më i lartë dhe themelor i vendit e parashikon të drejtën për një proces të rregullt ligjor në nene specifike të saj, por nuk na ofron një përkufizim të plotë.

³⁸Greer S, *The ECHR: Achievements, Problems and Prospects*, Cambridge University Press, Cambridge, 2006.

Megjithatë përkufizimin dhe shtjellimin e konceptit të procesit të rregullt ligjor e jep literatura juridike. Gjithashtu një peshë të rëndësishme lidhur me këtë të drejtë ka jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese, sepse është kjo e fundit që bën interpretimin e kushtetutës. “Kushtetuta është ajo që thotë gjykata e saj për të.” Neni 42 i kushtetutës parashikon:

- 1. Liria, prona dhe të drejtat e njohura me kushtetutë dhe me ligj nuk mund të çënohen pa një proces të rregullt ligjor.*
- 2. Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetues dhe ligjore, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj.*

Neni 43 i saj parashikon se kushdo ka të drejtë të ankohet kundër një vendimi gjyqësor në një gjykatë më të lartë, përveçse kur në kushtetutë është parashikuar ndryshe.³⁹ Ndërsa neni 131/f parashikon se Gjykata Kushtetuese vendos për gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve për shkeljen e të drejtave të tyre kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e këtyre të drejtave.⁴⁰

Nga këto nene të Kushtetutës sonë, del qartë se e drejta për një proces të rregullt lidhet me procedimet gjyqësore. Pra gjykata kushtetuese mund të investohet për ankimimin ndaj gjykimeve nga gjykatat më të ulëta, për të cilat palët pretendojnë se është shkelur parimi i procesit të rregullt ligjor.

³⁹ Neni 43 i Kushtetutës së RSH

⁴⁰ Prof. Dr. Xh. Zaganjori, Prof. Dr. A. Anastasi, Dr. E. Methasani, Shteti i së drejtës në Kushtetutën e RSH, Aled Print, Tiranë, 2011, fq. 163.

Por e drejta për një proces të rregullt ligjor shtrihet përtej proceseve gjyqësore. Edhe nocioni i përdorur në kushtetutë “*ligjor*” ka pasur si qëllim të japë idenë se e drejta për procesin e rregullt nuk do të kufizohet vetëm brenda organeve gjyqësore, por është e detyrueshme edhe ndaj aparateve të tjera shtetërore.

Gjykata kushtetuese në disa vendime të saj, me qenë se kushtetuta nuk ka një nen specifik për të përkufizuar parimin e procesit të rregullt ligjor, merr përsipër të japë kuptimin e këtij parimi. Kjo gjykatë e ka shtrirë detyrimin për një proces të rregullt ligjor jo vetëm, në proceset gjyqësore por edhe në ato administrative.

Elemente të së drejtës kushtetuese që lidhen me procesin e rregullt ligjor janë të shumta. Ato janë zhvilluar rast pas rasti duke reflektuar mbi kërkesat e paraqitura nga individët. Në katalogun e të drejtave që mbulon përfshihen: aksesin në gjykatë, gjykim nga një gjykatë e caktuar me ligj, e pavarur, e paanshme, brenda një afati të arsyeshëm, e drejta e ankimit, e drejta për të marrë vetë pjesë në gjykim, barazia e armëve, ekzekutimi i vendimit, arsyetimi i vendimit etj.

Më poshtë trajtohen në mënyrë të përmbledhur rregullat kryesore që përbëjnë Parimin e procesit të rregullt.

1.4.1. Aksesin në gjykatë

E drejta për një proces të rregullt ligjor është i parashikuar në kreun e të drejtave dhe lirive themelore në Kushtetutën e RSH. Brenda konceptit së të drejtës për një proces të

rregullt ligjor, përfshihet edhe e drejta për t'iu drejtuar gjykatës (aksesi në gjykatë) e cila konsiderohet si një e drejtë thelbësore që duhet t'i sigurohet çdo individ pa të cilën të drejtat e tjera nuk do kishin vlerë.

Procesi i rregullt ligjor konsiderohet si e vetmja e drejtë kushtetuese, shkelja e së cilës përbën shkak ligjor që individët të kenë akses në Gjykatën Kushtetuese, pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e këtyre të drejtave.⁴¹

Aksesi në gjykatë është konsideruar si element thelbësor dhe pjesë integrale e të drejtës për një proces të rregullt ligjor. Nuk mund të mendohet funksionimi efektiv i shtetit të së drejtës, nëse nuk i njihet individëve e drejta dhe mundësia për t'iu drejtuar gjykatës.⁴²

Pavarësisht se nuk shprehet tekstualisht, në nenin 42 të Kushtetutës parashikohet e garancia e gjithsecilit që për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave të tij kushtetuese dhe ligjore, t'i mundësohet një gjykim i drejtë dhe publik, brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj.⁴³

⁴¹ Shih nenin 131/f të Kushtetutës.

⁴² Prof. Dr. Xh. Zaganjori, Prof. Dr. A. Anastasi, Dr. E. Methasani, Shteti i së drejtës në Kushtetutën e RSH, Aled Print, Tiranë, 2011, fq. 90.

⁴³ Neni 43 i Kushtetutës së RSH

Në të njëjtën kohë edhe Kodi i Procedurës Civile në nenin 1 të tij.⁴⁴ Kjo e drejtë është e lidhur ngushtë gjithashtu edhe me nenin 6⁴⁵ të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

Nëse do të përkufizojmë aksesin në gjykatë, së pari kjo e drejtë nënkupton të drejtën e kujtudo për të ngritur padi në gjykatë, po ashtu nënkupton edhe detyrimin e organeve shtetërore që t'ia garantojë atij këtë mundësi, pra detyrimin e organit të gjykatës për të marrë parasysh kërkesat e individit, të dëgjojë të gjitha pretendimet dhe t'i japë përgjigje secilit prej tyre. Gjykatat nuk duhet të mohojnë dhënien e drejtësisë.

Mohimi i kësaj të drejte konsiderohet si shkelje e nenit 6 të KEDNJ dhe nenit 42 të Kushtetutës tonë, si pasojë e cënimit të parimit për një proces të rregullt.

Në çështjen *Golder kundër Mbretërisë së Bashkuar* një të burgosuri i kishin mohuar të drejtën për të kontaktuar me avokatin e tij, si dhe për të ngritur padi civile kundër një oficeri burgu. Gjykata u shpreh se: *“E drejta për akses në gjykatë nuk duhet vetëm të ekzistojë, por duhet të jetë gjithashtu efektive.”*⁴⁶ Dhe se *“Pamundësia e një të burgosuri për të pasur konsultime konfidenciale përveç seancës gjyqësore me një avokat e privonte atë nga e drejta për akses në gjykatë.”*⁴⁷

Në disa çështje aksesin në gjykatë mohohet për arsye të vetë natyrës së ndërthurjes së palëve në proces.

⁴⁴ Neni 1 KPC: Gjykata nuk mund të refuzojë të shqyrtojë dhe të japë vendime për çështje që i paraqiten për shqyrtim me arsyetimin se ligji mungon, nuk është i plotë, ka kundërthënie ose është i paqartë.

⁴⁵ Neni 6: E drejta për një proces të rregullt: Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme. Çdo person i akuzuar për një veprë penale prezumohet i pafajshëm, derisa fajësia të provohet ligjërisht. Çdo person ka të drejtë të ndihmohet nga një avokat i cili paguhet nga shteti nëse është i varfër.

⁴⁶ Campbell dhe Fell kundër Mbretërisë së Bashkuar, 28.06.1984, para.111-113. GJEDNJ.

⁴⁷ Po aty.

Në çështjen e *Canea Catholic Church kundër Greqisë*⁴⁸ një gjykatë vendosi që Kisha aplikuese nuk kishte personalitet ligjor në të drejtën greke. Ky fakt solli pezullimin e çështjes në shqyrtim, për të bërë vlerësimin e të drejtës së tij mbi pronën. Gjykata Evropiane megjithatë deklaroi se kjo e kishte dëmtuar thelbin e të drejtës për akses në gjykatë dhe se kishte konstatuar shkelje të Nenit 6.

1.4.2. Mirë administrimi i drejtësisë

Një administrim i mirë i drejtësisë, në zbatim të procesit të rregullt dhe të drejtë ligjor, është një temë me një rëndësi të veçantë dhe që është trajtuar gjerësisht, kryesisht nga jurisprudenca.

Tërësia e rregullave që përbëjnë nocionin e procesit të rregullt dhe garancia e zbatimit të tyre përbëjnë detyrim dhe objektiv kryesor të gjykatave tona. Përcaktimi në 6 të KEDNJ “...çdo person ka të drejtën që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht” i jep formë këtij detyrimi.”

Ky koncept është e lidhur ngushtësisht dhe me parimet e tjera, mbi të cilat bazohet funksionimi i procesit civil, që shërbejnë si gurë themeli për dhënien e drejtësisë, nga ana e sistemit tonë të drejtësisë.

Një vlerë të shtuar zbatimit dhe garantimit të këtij parimi i jep edhe neni 131, f i cili shpreh se: “Gjykata Kushtetuese vendos për gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve për shkeljen e të drejtave të tyre kushtetuese për një proces të rregullt ligjor”.

⁴⁸ Canea Catholic Church kundër Greqisë, 16 Dhjetor 1997. GJEDNJ.

Kompetenca e Gjykatës Kushtetuese për gjykimin e çështjeve që lidhen me shkeljen e procesit të rregullt, i jep kësaj të drejte një dimension qartazi kushtetues, duke e renditur në kategorinë e të drejtave të njeriut.

Një administrim i mirë i drejtësisë përmban në vetvete këto rregulla:

1. Detyrimi për gjykim të drejtë;
2. Detyrimi për gjykim publik;
3. Detyrimi për gjykim në një afat të arsyeshëm;
4. Nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme;
5. E caktuar me ligj.

Gjykimi i drejtë përmban detyrimin e të gjithë shteteve të miratojnë ligje të brendshme që gjyqtarët të marrin në shqyrtim të gjitha faktet, argumentet, parashtrimet, informacionet, provat dhe të dhëna të tjera pa pasur paragjytime në rilevancën që kanë ato në çështjen në fjalë. Këto detyrime drejtohen jo vetëm në miratimin e ligjeve organike siç është Kodi i Procedurës Civile, por edhe ligje të tjera që lidhen me aktivitetin e gjyqtarëve që ato të veprojnë në këtë mënyrë.

Gjykimi publik i çështjeve ka një peshë shumë të rëndësishme. Zhvillimi i procesit me dyer të hapura, rrit sensibilitetin e shtetasve në raport me të drejtën. Ai paraqet një garanci në raport me proces të rregullta dhe vendimmarrje të drejtë dhe të paanshme të gjykatës, mbi bazën e përcaktimeve kushtetuese dhe ligjeve në fuqi.

Gjykimi i çështjes brenda një afati të arsyeshëm, është një detyrim i sistemit gjyqësor dhe jo vetëm, për tu respektuar si një garanci kushtetuese e çdo individi, që lind

drejtpërdrejtë nga Kushtetuta. Koncretisht në nenin 42 të Kushtetutës përcaktohet se *“Kushdo, ka të drejtën e një gjykimi brenda një afati të arsyeshëm, ...”*.

Në bazë të parimit të lashtë *“drejtësi e vonuar, drejtësi e mohuar”* nëse procedimet gjyqësore do të sjellin vonesa, rrjedhimisht ato do t'i mohojnë te drejtë individëve.

Një dispozitë të ngjashme e gjejmë në nenin 28 Kodit të Procedurës Civile ku parashikohet se *“Gjykata duhet të shprehet brenda një afati të arsyeshëm”*.

Konceptet e parashikuara nga legjislacioni ynë shkojnë në përputhje të plotë me parashikimet e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, e cila në nenin 6 të saj përmban: *“Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet brenda një afati të arsyeshëm”*.

Këto përcaktime kanë bërë të mundur prishjen e shumë vendimeve gjyqësore, të cilat sipas GJEDNJ ishin dhënë në shkelje të këtij rregulli. Çështja e gjykimeve brenda një afati të caktuar është ende sot një ndër problemet më të mëdha të sistemit gjyqësor. Me sistemimet e herë pas hershme të bëra në legjislacion tashmë individët janë më të pritur t'i drejtohen gjykatës për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, kjo ka bërë që gjykatave t'i shtohet fluksi, por nga ana tjetër nuk është bërë asnjë përmirësim në modalitetet e procedimeve penale dhe në shtimin e gjyqtarëve. Kjo passjell rrjedhimisht vonesa dhe zvarritje. Parlamenti shqiptar në kuadër të reformave në drejtësi ka shtuar dispozita ligjore në Kodin e Procedurës Civile, për të cilat do flitet gjerësisht më poshtë, por ende nuk kemi ndonjë ndryshim të dukshëm.

Në këto kushte mund të themi se, përtej përpjekjeve për rregullimin e kuadrit ligjor, nevojiten mekanizma më efektive që individëve t'i garantohet kjo e drejtë kushtetuese.

Gjykimi nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme është një garanci e cila buron drejtpërdrejtë nga Kushtetuta e RSH, që siguron procedim të drejtë, si dhe duke i garantuar palëve shqyrtimin e çështjes me paanshmëri nga gjyqtari i cili si arbitër dhe duke respektuar vetëm ligjin vendos pa u lidhur dhe u ndikuar nga ato.

Pozicioni i gjyqtarit të pavarur dhe të paanshëm është një nga komponentët themelor të funksionimit të shtetit të së drejtës.

Gjykimi nga një gjykatë e caktuar me ligj është një parim që lidhet kryesisht me kompetencat e gjyqtarëve në gjykatat përkatëse. Në rastet kur gjykatat tejkalojnë kompetencat e veta këtu mund të ankojmë faktin se gjykata nuk është caktuar me ligj. Qëllimi i kësaj kërkesë, ka si qëllim të sigurojë pavarësinë e gjykatës nga pushtetet e tjera. Gjykata e Strasburgut shprehet në çështjen *Zand kundër Austrisë* se është objekti dhe qëllimi i klauzolës së Nenit 6 (1) që të kërkojnë që gjykatat të “*krijohen me ligj*” dhe që organizimi gjyqësor në një shoqëri demokratike të mos ketë varësi nga pushtetet e tjera apo nga politika, por të rregullohet me ligj i cili del nga Parlamenti.

Çështje të rëndësishme që Gjykata Evropiane ka trajtuar në zbatim të parimeve të administrimit të mirë të drejtësisë kanë qenë të shumta dhe pikërisht kjo gjykatë thekson rëndësinë që kanë këto parime si dhe detyrimin për shtetet t’i zbatojnë ato.

Disa nga çështjet që ndërtojnë një jurisprudencë në lidhje me zbatimin e këtyre parimeve janë:

Çështja “*Bonisch kundër Austrisë*” dhe çështja “*Feldrugje kundër Holandës*” në të cilin Gjykata është shprehur se çdo pale duhet t’i lejohet të paraqesë vërejtje për argumentet e palës tjetër.

Duke aplikuar këtë parim në çështjen “*Borgers kundër Belgjikës*”, Gjykata Evropiane deklaroi se mungesa e vendosjes në mënyrë të barabartë palët përbënte shkelje të nenit 6 (1) të Konventës.

Një tjetër çështje e shqyrtuar nga GJEDNJ e njohur si “*Dauti kundër Shqipërisë*” do të ndryshojë qëndrimet e gjykatës sonë kushtetuese lidhur me të drejtën për t’u ankuar dhe tejkalimin e kompetencave nga një organ administrativ duke përbërë një shkelje të nenit 6 të konventës lidhur me procesin e rregullt ligjor. Komisioni i Ankimeve nuk është një gjykatë e pavarur dhe e paanshme.

Ky organ mund të shpall një vendim por që qëndron shumë larg vendimit të gjykatës. Në rast se janë shteruar rrugët administrative duhet ankimuar në gjykatë. Do të jenë këto dy vendime të rëndësishme të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut që do të sjellin qëndrime të reja të gjykatës sonë kushtetuese gjatë interpretimit të kushtetutës, për procesin e rregullt ligjor. Shumë nga precedentët mbi gjykimin brenda një afati të arsyeshëm kanë lidhje me situata ku organe shtetërore apo dhe vet kërkuesit ndikojnë në kohëzgjatjen e procesit.

1.4.3. Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore

Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore të formës së prerë sikurse u theksua më sipër, është një element procedural i cili trajtohet si pjesë integrale e të drejtës për një proces të

rregullt ligjor⁴⁹ (neni 42), e drejtë kjo e fundit, e njohur shprehimisht nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, si një e drejtë themelore e individit por edhe në kuptim të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (neni 6/1).

Në ditët e sotme jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese të RSH ka konsoliduar rregullin se ekzekutimi i vendimeve të formës së prerë është pjesë integrale e procesit të rregullt ligjor. Në një numër të madh vendimesh të saj ajo mbron këtë qëndrim.⁵⁰

Në këtë kuadër mund të themi se çdo individ që ka përshkuar një proces gjyqësor dhe tashmë disponon vendimin e gjykatës në formë të prerë, ka të drejtën të përfitojë zbatimin e këtij vendimi që vjen në favor të tij në mënyrë të menjëhershme nga organet kompetente për këtë zbatim.

Këndvështrim ky, i cili e vesh këtë të drejtë, jo vetëm një rol të rëndësishëm për garancinë e mbrojtjes së të drejtave të njeriut, por rrjedhimisht shton edhe një ndikim të fuqishëm në funksionimin e organeve gjyqësore në Republikën e Shqipërisë. Parim themelor në një shoqëri demokratike është detyrimi i autoriteteve publike për të vënë në zbatim vendimet gjyqësore të formës së prerë.

⁴⁹ Hornsby kundër Greqisë, 19 03.1997, Schollos kundër Italisë, 8.8.1995, Qufaj shpk kundër Shqipërisë 30.03.2005, GJEDNJ.

⁵⁰ Prof. Dr. Xh. Zaganjori, Prof. Dr. A. Anastasi, Dr. E. Methasani, Shteti i së drejtës në Kushtetutën e RSH, Aled Print, Tiranë, 2011, fq. 102.

Objekt i këtij punimi do të jetë pikërisht analiza e institutit juridik të ekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë, si pjesë e procesit të rregullt ligjor, kategorizuar si e drejtë themelore e njeriut.

Kujtdo duhet t'i garantohet e drejta për një proces të rregullt ligjor, si një e drejtë themelore e individit. Kushdo që në mbrojtje të interesave të tij, i drejtohet gjykatës, si organi shtetëror më i përshtatshëm dhe efektiv për të realizuar këtë mbrojtje nëpërmjet vendimeve të veta, duhet të përfitojë nga kjo e drejtë dhe ta realizojë atë.

Marrëdhëniet juridike nuk do të kishin qëndrueshmëri në një shoqëri të civilizuar, nëse nuk do ekzistonte garancia e mbrojtjes së tyre nëpërmjet sistemit gjyqësor dhe nëpërmjet autoriteteve që kanë për kompetencë të ekzekutojnë vendimet gjyqësore.

Detyra kryesore e pushtetit gjyqësor është mbrojtja e të drejtave dhe interesave të ligjshme të subjekteve të së drejtës. Kjo mbrojtje garanton njëherazi edhe sigurinë e rendit shoqëror demokratik në vendin tonë.

Për një rregullim të mirë të organizimit të tërësisë së këtij procesi, me qëllim që drejtësia dhe çdo pretendim i ligjshëm i një subjekti të caktuar të përmyllet me sukses, autoritetet shtetërore kanë detyrimin orientuar të miratojnë ligje si dhe të krijojnë një praktikë përmbartimore që të garantojë ekzekutimin e vendimeve.

Ekzekutimi i vendimit të formës së prerë të gjykatës konsiderohet si faza përfundimtare e realizimit të një të drejte të fituar gjyqësisht, vetëm pas realizimit të kësaj faze mund të konsiderohet se individi e ka vendosur plotësisht në vend të drejtën e tij të fituar.⁵¹

“Gjykimi nuk duhet konceptuar ngushtë vetëm me sigurimin e një vendimi gjyqësor, por me përfundimin e gjithë këtij procesi, sepse një e drejtë e fituar, nëse ajo nuk realizohet nëpërmjet ekzekutimit të vendimit, mbetet pa asnjë vlerë.”⁵²

Në realitetin e gjykatave në vendin tonë vlerësojmë se janë të shumta rastet kur vendimet nuk marrin jetë dhe kjo krijon një situatë ç’ekuilibruese dhe një mungesë të theksuar të besimit së subjekteve të së drejtës ndaj organeve të drejtësisë.

Gjykata Kushtetuese është konsideruar nga GJEDNJ si një mjet ankimi efektiv për kërkesën me objekt mosekzekutimin e vendimeve gjyqësore, përpara se kreditori t’i drejtohet GJEDNJ.

Nga analiza që i bëhet institutit juridik të ekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë, në brendësi të këtij punimi, mund të themi se ky element procedural me karakter kushtetues është njohur dhe implementuar mjaft vonë në vendin tonë, por ende nuk mund të flasim për garantimin e plotë të tij. Kjo për shkak se akoma sot, pas ndjekjes së hapave procedurale, shumë individë e gjejnë ende veten me një urdhër ekzekutimi i cili endet prej kohësh i pa ekzekutuar.

⁵¹ Ma. I. Bajramaj, Ekzekutimi i detyrueshëm i vendimeve gjyqësore dhe problematika e praktikës gjyqësore, Disertacion, Tiranë 2016, fq. x.

⁵² Vendim nr.6, datë 31.03.2006 GJK

Të gjitha burimet e së drejtës sonë të brendshme që lidhet me procesin e rregullt qartësojnë detyrimin e shtetit shqiptar për të ekzekutuar vendimet e gjykatave që kanë marrë formë të prerë, por kjo nuk ka qenë e mjaftueshme për respektimin e plotë të kësaj të drejte. Në këto kushte situata mbetet ende pa zgjidhje, por është pikërisht ky momenti në të cilin shteti shqiptar nuk mund të humbas më kohë, por duhet të ndërmarrë hapa konkret për realizimin e të drejtave të fituara gjyqësisht nga qytetarët. Ky punim synon pikërisht të kontribuojë sado pak në paraqitjen e situatës aktuale të realizimit të kësaj të drejte themelore të njeriut si dhe në përpjekjen e dhënies së disa rekomandimeve që mund të ndikojnë në përmirësimin e saj.

Duke e parë ekzekutimin e vendimeve të formës së prerë si një e drejtë themelore, duke investuar në doktrinë, në jurisprudencë dhe mbi të gjitha në kuadrin ligjor, do ta bënte këtë të drejtë më të realizueshme dhe të prekshme nga ana e individëve.

KREU II

KORNIZA LIGJORE E EKZEKUTIMIT TË VENDIMEVE GJYQËSORE TË FORMËS SË PRERË NË PROCESIN CIVIL DHE ADMINISTRATIV

Proceset gjyqësore civile, administrative dhe penale nuk përmbyllin misionin e tyre me shpalljen e një vendimi gjyqësor, por e finalizojnë atë pasi vendimi të ketë marrë jetë nëpërmjet procesit të vënies në ekzekutim. Një vendim gjyqësor i formës së prerë do të përbënte një shkresë të thjeshtë deklarative nëse nuk do vihej në zbatim.

Garantimi i vënies në zbatim të vendimeve gjyqësore duhet të sigurohet nga forca shtrënguese e shtetit, i cili me mekanizmat, strukturat dhe kuadrin ligjor ka detyrimin të ndihmojë në realizimin e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore përfundimtare të secilës fushë, qoftë civile, administrative apo penale.

E parë në këtë këndvështrim, dalim në përfundimin se ekzekutimi i vendimeve gjyqësore është pjesë përbërëse e procesit gjyqësor. Forma e ekzekutimit të vendimeve ndryshon kur vendimi është penal, civil apo administrativ, sipas edhe legjislacionit përkatës që i parashikon.

Ky punim ka në objektin e tij të studimit, ekzekutimin e vendimeve gjyqësore civile dhe administrative, të trajtuara në këndvështrimin e të drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor.

2.1. Procesi i ekzekutimit të vendimeve gjyqësore civile të formës së prerë

2.1.1. Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore civile dhe titujve ekzekutiv

Funksioni i gjykimit, i cili në bazë të nenit 42 të Kushtetutës, është mbrojtja e të drejtave, lirive dhe interesave kushtetuese dhe ligjore të individëve, nuk përmbushet vetëm me njohjen dhe deklarimin e tyre nëpërmjet procesit gjyqësor civil. Përveç vërtetimit dhe deklarimit të tyre nëpërmjet procesit gjyqësor civil është e domosdoshme të merren masa që të drejtat, liritë dhe interesat kushtetuese dhe ligjore të individëve të realizohen efektivisht.⁵³

Kjo do të thotë që veç hartimit të normave juridike konkrete që rregullojnë një situatë të caktuar, nevojitet që të merren masa për ta zbatuar atë, domethënë për ta kthyer në fakte reale, duke ndryshuar situatën faktike ekzistuese, në mënyre që ajo të bëhet në përputhje me atë që duhet të jetë: p.sh që të arrihet efektivisht që A-së t'i jepen shuma e të hollave që i detyrohet, ose sendi i luajtshëm ose i paluajtshëm që duhet t'i dorëzohet e kështu me radhë.

Kjo formë e dytë e mbrojtjes juridike të së drejtës realizohet nëpërmjet procesit të ekzekutimit të detyrueshëm që i kundërvihet dhe që i bashkohet procesit të gjykimit, për të krijuar së bashku kuadrin e veprimtarive themelore nëpërmjet të cilave realizohet funksioni i gjykimit dhe mbrohen të drejtat, liritë dhe interesat kushtetuese dhe ligjore të individëve.⁵⁴

⁵³ A. Brati, Procedura Civile, Botimet Dudaj, 2008, fq.525

⁵⁴ A. Brati, Procedura Civile, Botimet Dudaj, 2008, fq. 525.

Kodi i Procedurës Civile⁵⁵ është ligji organik i cili parashikon rregullat e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore civile të formës së prerë. Në Kodin e Procedurës Civile nuk jepet përkufizimi për kuptimin e ekzekutimit të detyrueshëm. Arqiviadh Lamani i cili ka trajtuar gjerësisht të drejtën e procedurës civile, në literaturën e tij është shprehur se, kuptimi i ekzekutimit të detyrueshëm pa pretenduar në një përkufizim të plotë të tij, ai është ekzekutim i akteve që përmbajnë njohjen ose rivendosjen e të drejtave.

Alban Brati në botimin e tij, i cili komenton Kodin e Procedurës Civile e përkufizon në këtë formë: *“Me ekzekutim të detyrueshëm do të kuptojmë veprimtarinë e organeve administrative (përmbaruesit gjyqësore), si dhe organeve gjyqësore (gjykatave të pushtetit gjyqësor), me anë të të cilave përmbushet ose ekzekutohet forcërisht një detyrim (për shembull nëpërmjet vendimit të gjykatës kërkohet të merret një provë, realizohet sekuestrimi i dhënë nga vendimi i gjykatës, ose fshihet hipoteka si pasojë e vendimit gjyqësor).”*

Në mënyrë të përmbledhur mund të thuhet që ekzekutimi i detyrueshëm është veprimtaria me anë të së cilës organet administrative dhe gjyqësore synojnë të realizojnë në mënyrë të detyrueshme një rezultat praktik, të barasvlershëm më atë që duhet të kishte prodhuar një subjekt tjetër në përmbushje të një detyrimi juridik.

Ndërsa në literatura të huaja janë dhënë kuptime dhe përkufizime më të plota, thelbin e të cilave mund ta përmbledhim pak a shumë në një: *“Është një proces i ekzekutimit*

⁵⁵ Ligj Nr.8116, datë 29.3.1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar).

të detyrueshëm të vendimit të formës së prerë ose të një akti tjetër që përbën titull ekzekutiv, me të cilin është vendosur në dobi të një subjekti e drejta për të kryer diçka (p.sh. për të paguar një shumë të hollash, për të dorëzuar e ndrequr një send etj), dhe detyrimi i subjektit tjetër për të përmbushur këtë detyrim”.

Ekzekutimi i vendimeve të formës së prerë për vetë karakterin e tij juridiko-civil, ka për qëllim rivendosjen e rendit juridik të cënuar në fushën e të drejtave subjektive. Prandaj, pavarësisht nga mënyra e organizimit dhe vartësia administrative e përmbartimit si organ i ekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë dhe titujve të tjerë ekzekutivë, në literaturën tonë është pranuar se gjykimi ose procedimi civil kalon nëpër dy faza⁵⁶:

Faza e parë përmban gjykimin në themel të çështjes, e cila ka për mision deklarin e shkeljes apo cënimit të së drejtës, njohjen dhe rivendosjen e të drejtës me një vendim përfundimtar.⁵⁷ Më pas, ky vendim duhet të marrë formë të prerë që procesi të kalojë në fazën e dytë.

Rastet kur një vendim gjyqësor civil merr formë të prerë përcaktohen në nenin 451 të Kodit të Procedurës Civile: “...Kur ndaj vendimit nuk mund të bëhet ankim; Kur ndaj vendimit nuk është bërë ankim brenda afatit ligjor, ose ankesa është tërhequr; Kur ankesa e paraqitur nuk është pranuar si dhe kur vendimi i gjykatës është lënë në fuqi, ndryshuar ose është pushuar gjykimi në shkallë të dytë.”

⁵⁶ A. Lamani, E drejta procedurale civile në Republikën popullore të Shqipërisë, 1962, Fq. 262.

⁵⁷ Neni 126 i Kodit të Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë

Pasi vendimi i gjykatës merr formën e prerë duhet të marrë jetë dhe kështu transferohet pra në fazën e dytë, atë të ekzekutimit të detyrueshëm ose në fazën përmbartimore. Në fakt, jo të gjitha vendimet e gjykatës mund të vihen në ekzekutim të detyrueshëm, por vetëm një pjesë e tyre, vetëm ato vendime që përmbajnë një detyrim të njëjës palë në favor të palës tjetër. Prej kësaj, del përfundimi se nuk mund të vihen në ekzekutim të detyrueshëm vendimet e njohjes ose vërtetimit.

Vendimi i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, Nr. 1, datë 17.01.2011, ka zbrërthyer kuptimin e ekzekutimit të detyrueshëm. Në këtë vendim theksohet se: *“Ekzekutimi i detyrueshëm është pikërisht zbatimi i pasojave të vendosura nga ligji për llojin e paligjshmërisë të krijuar nga ana e organeve të administratës shtetërore. Ekzekutimi i detyrueshëm bëhet me qëllim që të rivendoset sundimi i ligjit dhe që me anë të përmbushjes së detyrueshme të rivendoset e drejta objektive që i është cënuar kërkuarit.”*

Në këtë fazë zbatohen vendimet gjyqësore të formës së prerë dhe titujt e tjerë ekzekutivë që me ligj i janë ngarkuar për ekzekutim përmbartuesit gjyqësor.⁵⁸ Të dyja fazat së bashku përbëjnë atë që quhet procesi gjyqësor civil.⁵⁹

2.1.2. Vendimet civile të formës së prerë si tituj ekzekutiv

Ekzekutimi i detyrueshëm i vendimeve civile të formës së prerë të gjykatës, lidhet ngushtësisht me lindjen e titullit ekzekutiv, pasi ai merr jetë vetëm në bazë të një titulli ekzekutiv.⁶⁰

⁵⁸ Neni 510 i Kodit të Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë

⁵⁹ A. Lamani, E drejta procedurale civile në Republikën popullore të Shqipërisë, 1962, Fq. 262.

⁶⁰ Neni 510 i Kodit të Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë

Titujt ekzekutiv nga përmbajtja e tyre janë akte të detyrueshme që reflektojnë forcën shtrënguese të ligjit në mbrojtje të interesave të çdo individi që ka përfituar statusin e gjyqfituesit në një proces gjyqësor.

Praktika e Gjykatës së Lartë e ka përkufizuar: *“Titull ekzekutiv është akti zyrtar përfundimtar, që përmban njohjen e detyrimit të plotë, të saktë dhe të përcaktuar të një personi apo subjekti kundrejt një tjetri sipas parashikimeve të ligjit. Nëpërmjet titullit ekzekutiv buron edhe e drejta e kreditorit për të nisur procedurat e ekzekutimit të detyrueshëm. E drejtë, apo legjitimitet i cili buron nga fakti që, ai që ka titullin ekzekutiv ose në favor të të cilit është lëshuar titulli ekzekutiv, ka dhe të drejtën e përfshirë në të”*.⁶¹

Neni 510 i Kodit të Procedurës Civile rendit aktet që përbëjnë tituj ekzekutiv. Në pikën (a) të tij parashikohet se vendimet civile të formës së prerë të gjykatës të cilat përmbajnë një detyrim, vendimet për sigurimin e padisë, si dhe për ekzekutimin e përkohshëm.

Më tej në pikat b, c, ç, d, dh dhe e, ky nen rendit si tituj ekzekutiv:

- b) Vendimet penale të formës së prerë në pjesën që bëjnë fjalë për të drejta pasurore;
- c) Vendimet e gjykatave e të arbitrazheve të shteteve të huaja që u është dhënë fuqi sipas dispozitave përkatëse të këtij Kodi;
- ç) Vendimet e një gjykate arbitrazhi në Republikën e Shqipërisë;
- d) Aktet noteriale që përmbajnë detyrim në të holla, si dhe aktet për dhënien e kredive bankare ose aktet për dhënien e kredive nga institucionet financiare jobankare;
- dh) Kambialet, çeçet e letrat me urdhër që barazohen me ato;

⁶¹ Vendimi nr. 297, datë 01.10.2009 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

e) Aktet e tjera që sipas ligjeve të veçanta quhen tituj ekzekutivë dhe ngarkohet zyra e përmbarimit për ekzekutimin e tyre.

Me vënien në ekzekutim të titullit ekzekutiv, gjyqfituesi ose kreditori, përmes procedurës së ekzekutimit, ka të drejtë të vë dorë mbi pasuritë e debitorit.

Organi i ngarkuar me ekzekutimin e detyrueshëm (përmbaruesi gjyqësor), nuk merr në shqyrtim bazueshmërinë e pretendimeve të subjekteve pjesëmarrës në ekzekutim për drejtësinë e vendimit të gjykatës ose të titullit tjetër ekzekutiv. Detyra e tij është ekzekutimi i plotë dhe i saktë i vendimit që i është lënë në kompetencë për ekzekutim.

Procesi i ekzekutimit të detyrueshëm nis kur kreditori pajiset me urdhrin e ekzekutimi, në rastet e gjykimeve civile. Urdhri i ekzekutimit është akti nëpërmjet të cilit merr jetë titulli ekzekutiv. Vendimi gjyqësor pasi merr formë të prerë, bëhet menjëherë i ekzekutueshëm nga organet përmbarimore, pa qenë nevoja e ndonjë kërkesë të palës.

Urdhri i ekzekutimit për vendimeve civile që përmban një detyrim, vendimet për sigurimin e padisë, si dhe vendimet për ekzekutimin e përkohshëm, është pjesë e vendimit gjyqësor dhe përcaktohet në dispozitivin e tij.⁶² Ai merr vlerë ligjore kur vendimi merr formë të prerë.

Paragrafi dy i nenit 511 parashikon shprehimisht se *“Nuk lëshohet urdhër ekzekutimi për vendimin e sigurimit të padisë dhe për gjobat e dhëna nga gjykata, vendimet për marrjen e detyrueshme të provës, vendimin në pjesën që urdhëron shpenzimet gjyqësore, si dhe vendimet civile të gjykatës, të dhëna për ekzekutim të përkohshëm, të*

⁶² Neni 511, pika a, e Kodit të Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë

cilat ekzekutohen drejtpërdrejt nga shërbimi përmbarimor, pas njoftimit të vendimit.”⁶³

Procedura për lëshimin e urdhrave të ekzekutimit ka qenë objekt ndryshimesh ligjore në mënyrë të vazhdueshme.

Para vitit 2013 urdhri i ekzekutimit dilte nga Gjykata që kish dhënë vendimin vetëm me kërkesën e kreditorit ose prokurorit për ato çështje që ai ka ngritur padi. Individët ishin të detyruar që, pas daljes së vendimit në formë të prerë, të ndiqnin edhe katër hapa të tjera për të marrë urdhrin e ekzekutimit dhe kjo kërkonte akoma më tepër kohë nëpër shkallet e gjykatave. Gjyqfituesi nuk mbaronte historitë me gjykatat, atij i duhej t'i drejtohej sërish gjykatës, duke paraqitur kërkesën për daljen e urdhrin të ekzekutimit, më pas duhet të priste për rezultatet e shortit, një ditë për seancën gjyqësore dhe një ditë tjetër për të marrë vendimin e zbardhur.

Me miratimet e ndryshimeve në Kodin e Procedurës Civile me Ligjin nr. 122 të vitit 2013, u shua detyrimi për t'iu drejtuar gjykatës me kërkesë, por urdhri i ekzekutimit përbënte ende një akt të veçantë i cili tërhiqej pranë gjykatës që kishte dhënë vendimin, pasi ky vendim të merrte formë të prerë. Ky ndryshim solli lehtësi dhe reduktim të burokracive, por sërish i detyronte gjyqfituesit të kishin një sorollatje pasi nëse vendimi i gjykatës së apelit linte në fuqi vendimin e shkallës së parë, pala e interesuar duhet të paraqitej për të tërhequr urdhrin e ekzekutimit në Gjykatën e Shkallës së Parë. Në rastin kur vendimi i Gjykatës së Apelit do ta ndryshonte vendimin e shkallës së parë, urdhri i ekzekutimit do të lëshohej nga kjo gjykatë dhe sërish lindte nevoja për orvatje dhe humbje kohe.

⁶³ Neni 511, paragrafi 2 i Kodit të Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë

Me ndryshimet e fundit të Kodit me Ligjin nr. 38/2017, datë 30.3.2017 vendimet gjyqësore civile të formës së prerë përbëjnë *Ipsa Iure* urdhër ekzekutimi.

Skema e re ka sjellë realisht një sërë avantazhesh në mbarëvajtjen e këtij procesi duke ndihmuar realizimin e të drejtave të qytetarëve. I ka falur atyre kohë dhe shmangie të një sërë procedurash burokratike që prej vitesh ka shkaktuar lodhje dhe shpenzime të mëdha për to.

Ndryshimi në ligj ka eliminuar një ngarkesë të jashtëzakonshme për qytetarët dhe gjyqtarët gjithashtu. Ai ka sjellë efikasitet të sistemit të drejtësisë, pasi ka ulur ndjeshëm zvarritjet e proceseve gjyqësore.

Kjo në fakt, është pjesë shumë e rëndësishme e procesit të ekzekutimit të vendimeve të formës së prerë. Mendoj se nisma për të ndryshuar ligjin në këtë aspekt ka qenë një nevojë e lindur prej kohësh dhe një ndër problematikat më kryesore që kërkonte zgjidhje.

Gjithsesi nuk mundemi të themi se çdo gjë është zgjidhur dhe shkon shumë mirë. Të dhënat tregojnë se mbetet ende një numër i madh i vendimeve të formës së prerë të cilat nuk ekzekutohen. Zvarritjet vazhdojnë, burokracitë ekzistojnë ende duke penguar kështu përfitimin e të drejtave të fituara në mënyrë gjyqësore.

Ajo pjesë e ligjit që ka pësuar ndryshime është vetëm një nga fazat e procesit të ekzekutimit të vendimeve, ndërkohë që, rrugëtimi për të marrë në dorë të drejtën e shkelur, duhet të vijojë më hapa të tjera.

Pala kreditore ose përfaqësuesi i saj i pajisur me prokurë tashmë ka në duart e tij vërtetimin apo dokumentin zyrtar me anë të të cilit ai realizon të drejtën e tij, por derisa ta realizojë *de facto*, ai duhet të ndjekë një rrugëtim të ri. Sipas nenit 515 kreditori duhet të paraqesë kërkesë për vënien në ekzekutim pranë shërbimit përmbartimor gjyqësor shtetëror ose privat, ky është pikërisht autoriteti që do të realizojë ekzekutimin e vendimit.⁶⁴

2.1.3. Vënia në ekzekutim i vendimeve gjyqësore civile të formës së prerë

Në procesin e ekzekutimit të titullit ekzekutiv lindin marrëdhënie juridike procedurale të caktuara ndërmjet subjekteve të ndryshme, që janë marrëdhënie juridike procedurale ekzekutive.

Subjekte në marrëdhënien juridike procedurale të ekzekutimit janë: gjykata, përmbartuesi gjyqësor, shtetëror ose privat, të cilit ligji e ka ngarkuar me detyrën e ekzekutimit të titullit të ekzekutimit, pala kreditore dhe pala debitore, si dhe palë të tjera kur është rasti, psh. kreditori i siguruar me hipotekë ose peng. Këto janë dhe aktorët kryesor të sistemit gjyqësor dhe administrativ që bashkëveprojnë për riparimin e të drejtave të cënuara si pasojë e shkeljes së ligjit.

Edhe në procedurën e ekzekutimit të detyrueshëm janë dy palë: pala kreditore që kërkon ekzekutimin dhe pala debitore, kundër së cilës realizohet procedura e ekzekutimit, si dhe trashëgimtarët e tyre. Kusht për qenë palë pjesëmarrëse në këtë marrëdhënie është si zotësia juridike dhe zotësia procedurale për të vepruar.

⁶⁴ Neni 515 i Kodit të Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë

Objekt i marrëdhënies juridike procedurale të ekzekutimit është vendimi gjyqësor i formës së prerë, që do të vihet në ekzekutim. Objekti i kësaj marrëdhënie është edhe vetë qëllimi që kërkohet të arrihet, synimi për rifitimin e të drejtave të shkelura.

Përmbajtja e marrëdhënies përbëhet nga të drejtat dhe detyrimet e palëve pjesëmarrëse në procesin ekzekutiv, të cilat parashikohen në Kodin e Procedurës Civile.

Sikurse u përmend edhe më sipër kreditori duhet të paraqesë kërkesë për vënien në ekzekutim pranë shërbimit përmbarrimor gjyqësor shtetëror ose privat. Pas depozitimit të kërkesës nga individ, përmbarruesi vihet në lëvizje brenda 15 ditëve nga data e dorëzimit të kërkesës së kreditorit dhe ka detyrimin të ndjek të gjitha procedurat e nevojshme për ekzekutimin e titullit ekzekutiv.⁶⁵

Përmbarruesi gjyqësor për të vënë në ekzekutim titullin ekzekutiv në bazë të urdhrin të ekzekutimit, duhet para së gjithash ta ketë në kompetencë tokësore. Për të siguruar zbatimin e përpiktë të kërkesave të Kodit të Procedurës Civile për kompetencën, në nenin 516 është përcaktuar se kompetent për vënien në ekzekutim të titullit ekzekutiv është përmbarruesi gjyqësor i vendit:

- a) ku ndodhen sendet e luajtshme ose të paluajtshme ose paratë, ndaj të cilave drejtohet ekzekutimi;
- b) ku ndodhet banimi i personit të tretë të detyruar kur ekzekutimi drejtohet kundër kredisë që ka për të marrë debitori nga ky person;

⁶⁵ Neni 515 i Kodit të Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë

- c) ku ndodhet vendi i ekzekutimit të detyrimit për kryerjen ose mokryerjen e një veprimi të caktuar.⁶⁶

Përmbaruesi e fillon ekzekutimin e detyrueshëm me dërgimin debitorit të një lajmërimi për ekzekutuar vullnetarisht detyrimin që përmban urdhri i ekzekutimit, duke caktuar për këtë një afat prej pesë ditësh kur objekti i tij është pagë ose detyrim për ushqim, dhe prej dhjetë ditësh në të gjitha rastet e tjera.

Lajmërimi për ekzekutimin vullnetar duhet të përmbajë një shkurtim të urdhrit të ekzekutimit, adresën dhe paralajmërimin për debitorin se do të fillojë ekzekutimi i detyrueshëm, në qoftë se detyrimi nuk ekzekutohet vullnetarisht.⁶⁷

Sipas nenit 517, në raste të veçanta, me kërkesë të debitorit gjykata e shkallës së parë të vendit të ekzekutimit, duke marrë parasysh gjendjen pasurore të debitorit ose rrethana të tjera të çështjes dhe pasi të dëgjojë kreditorin, mundet të shtyjë afatin e ekzekutimit të detyrimit në të holla ose të ndajë këtë detyrim në këste, përveç rasteve kur ky detyrim rrjedh nga një akt për dhënien e kredisë bankare.⁶⁸

Ekzekutimi i detyrueshëm nuk mund të fillojë pa u respektuar afatet e ekzekutimit vullnetar, përveç kur ka rrezik se me kalimin e afatit, ekzekutimi do të bëhet i pamundshëm. Në këtë rast, përmbaruesi gjyqësor mund të fillojë menjëherë nga ekzekutimi i detyrueshëm.⁶⁹

⁶⁶ Neni 516 i Kodit të Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë

⁶⁷ Neni 517 i Kodit të Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë

⁶⁸ Po aty.

⁶⁹ Neni 519 i Kodit të Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë

Neni 519 që përcakton këtë moment procedural, ka sjell jo pak herë probleme në praktikë. Së pari nuk përcaktohet qartë se kush përbën rrezik dhe si mund të provohet ai.

Ky moment procedural përbën një fazë të rëndësishme, në të cilin duhet të arrihet përfitimi të drejtave të shkelura të kreditorit, por në të njëjtën kohë të mos abuzohet me pozitat e debitorit. Përmbaruesi duhet të jetë i vëmendshëm dhe të arrijë të finalizojë me sukses punën e tij pa cënuar asnjërën nga palët. Në harkun kohor ndërmjet njoftimit të ekzekutimit vullnetar dhe atij të detyrueshëm debitori mund të procedoj me fshehjen e pasurisë për t'iu shmangur detyrimit. Nga ana tjetër Përmbaruesi ose kreditori duhet të marrin dijeni të këtij fakti, por derisa të kalojë afati 5/10 ditor ata mbeten në pamundësi për të vepruar.

Një problematikë të tillë nuk e ka zgjidhur ende ligji dhe shpesh kjo bëhet shkak i mosrealizimit të ekzekutimit të vendimit apo titullit ekzekutiv përkatës.

Kur një person i tretë ka vendosur si barrë një send të tij, në favor të debitorit, urdhri i ekzekutimit do të zbatohet kundër tij, nëse kreditori do ta kërkojë një gjë të tillë.⁷⁰

Përmbaruesi gjyqësor ka detyrimin të mbajë një procesverbal për çdo veprim që kryen gjatë ekzekutimit të vendimeve. Ky procesverbal përmban ditën dhe vendin e kryerjes së veprimeve, kërkesat dhe deklaratimet e bëra nga palët, sendet e marra, shuma e nxjerrë dhe shpenzimet e bëra për ekzekutimin.⁷¹

Sipas KPC shpenzimet e ekzekutimit do të përballohen fillimisht nga kreditori dhe pas ekzekutimit ato i mbahen debitorit, duke ia kthyer kreditorit⁷².

⁷⁰ Neni 521 i Kodit të Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë

⁷¹ Neni 524 i Kodit të Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë

⁷² Neni 525 i Kodit të Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë

2.1.4. Ekzekutimi i vendime penale të formës së prerë si tituj ekzekutiv

Vendimet penale të formës së prerë do të konsiderohen tituj ekzekutiv vetëm për atë pjesë ku disponohet për të drejta pasurore.⁷³

Rast tipik i ekzekutimit të vendimeve penale që disponojnë kërkesa civile është rasti i detyrimit për pagimin e gjobave të vendosura nga një gjykatë penale. Kur i dënuari nuk ka të ardhura ose pasuri të sekuestrueshme, gjykata ngarkon atë që përgjigjet civilisht për detyrimet e të pandehurit që të paguajë një shumë të barabartë me gjobën.⁷⁴ Në rast se kemi vendim dënimi me gjobë për të miturin ekzekutimi bëhet nga organi përmbarrimor mbi bazën e urdhrin të ekzekutimit të prokurorit.⁷⁵

Të drejta pasurore në vendimet penale, kemi rastin e një vendimi penal i cili ka si dënim plotësues konfiskimin e mjeteve të kryerjes së veprës penale.⁷⁶

Rast tjetër është kur në vendimin penal të formës së prerë për njohjen e vendimeve penale të huaja, me kërkesën e të interesuarit në të njëjtin vendim, mund të deklarohen të vlefshme edhe disponimet civile me detyrimin për kthimin e pasurisë ose shpërblimin e dëmit.⁷⁷

Së fundi, ekzekutohet nga zyra e përmbarrimit detyrimet për shpenzimet procedurale penale.⁷⁸

⁷³ Neni 510, pika b, i Kodit të Procedurës Civile.

⁷⁴ Neni 467 dhe 392 i i Kodit të Procedurës Penale.

⁷⁵ Neni 60 i Kodit të Procedurës Penale.

⁷⁶ Neni 273 i Kodit të Procedurës Penale, si dhe neni 17 i Ligjit Nr. 9284, datë 30.09.2004, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar”.

⁷⁷ Neni 513 i Kodit të Procedurës Penale.

⁷⁸ Neni 486 i Kodit të Procedurës Penale.

2.1.5. Vendimet e gjykatave dhe arbitrazheve të shteteve të huaja, si tituj ekzekutiv

Si tituj ekzekutiv Kodi i Procedurës Civile njih edhe vendimet e gjykatave të shteteve të huaja dhe të arbitrazhit të shteteve të huaja.⁷⁹

Vendimet e shteteve të huaja dhe ato të arbitrazhit do të ekzekutohen vetëm nëse njihen paraprakisht nga Gjykata Shqiptare, e cila lëshon vendimin e njohjes bashkë me urdhrin e ekzekutimit në dispozitivin e tij.⁸⁰

Ky vendim i jep fuqi juridike vendimeve të gjykatave të shteteve të huaja dhe të arbitrazhit të shteteve të huaja brenda Republikës së Shqipërisë dhe siguron mundësinë që ato të zbatohet. Nëse për këtë argument shteti shqiptar ka një marrëveshje të posaçme me shtetin e huaj, atëherë ai do të ekzekutohet sipas rregullave që janë përcaktuar në marrëveshje.⁸¹

Gjykata kompetente për lëshimin e vendimit për njohjen dhe zbatimin e këtyre vendimeve është Gjykata e Apelit.⁸² Kjo e fundit lëshon vendimin për njohjen e vendimit të huaj pasi është dorëzuar një sërë dokumentesh të parashikuara nga neni 396 i Kodit të Procedurës civile. Ekzekutimi i vendimeve do të realizohet duke u bazuar në procedurën e ekzekutimit të titujve ekzekutiv sipas legjislacionit shqiptar.

⁷⁹ Neni 510,c i Kodit të Procedurës Civile.

⁸⁰ Neni 511,b i Kodit të Procedurës Civile.

⁸¹ Neni 393 i Kodit të Procedurës Civile.

⁸² Neni 398 dhe 399 i Kodit të Procedurës Civile.

Gjykata e apelit do të njohë vendimin e gjykatave apo arbitrazheve të huaja vetëm nëse ato janë të formës së prerë dhe nuk vërtetojnë pengesat e parashikuara në nenin 394, pra kjo gjykatë nuk e shqyrton çështjen në themel.⁸³

Ne konkluzion mund të themi se për njohjen e vendimeve të gjykatave të huaja dhe atyre të arbitrazhit të huaj, individët nëse nuk ekziston një marrëveshje ndërmjet shteteve, do t'i duhet të ndjekin një procedurë relativisht të gjatë, fillimisht të rinisin një proces gjyqësor për njohjen e tij dhe më pas të ndjekin hapat e procedurave të ekzekutimit. Mendoj që kjo vështirëson disi pozitat e kreditorit dhe zvarrit procedurat e ekzekutimit të një vendimi i cili në shtetin e huaj ka marrë formë të prerë.

2.1.6. Mjetet e mbrojtjes kundër ekzekutimit të detyrueshëm

Në fazën e ekzekutimit të detyrueshëm ligji njih edhe mjetet e goditjes së titullit ekzekutiv dhe të veprimeve të përmbaruesit gjyqësor nga palët dhe nga persona të tretë.

Në këtë kuadër legjislatori i ka ofruar debitorit një mjet ligjor, më anë të të cilit ky i fundit të kërkojë deklarin e pavlefshmërisë relative ose absolute pjesërisht ose plotësisht të titullit të ekzekutimit.⁸⁴

Në rastet kur titulli ekzekutiv është një vendim gjyqësor i formës së prerë ose një vendim arbitrazhi, debitori ka të drejtë të kundërshtojë ekzekutimin e titullit, vetëm

⁸³ Neni 397 i Kodit të Procedurës Civile.

⁸⁴ Neni 609 i Kodit të Procedurës Civile.

për rrethana e fakte të ndodhura pasi janë shpallur këto vendime.⁸⁵ Këtu gjykata mund të vendosë pezullimin e vendimit me ose pa garanci.⁸⁶

Një padi tjetër e parashikuar në Kodin e Procedurës Civile është ‘kundërshtimi i veprimeve të përmbaruesit gjyqësor’.⁸⁷ Ky është një mjet ligjor në duart e debitorit dhe/ose kreditorit të cilët mund të kundërshtojnë veprimet e përmbaruesit gjyqësor që janë kryer në kundërshtim me procedurat e parashikuara nga ligji. Këto shkelje mund të konsistojnë në veprime të kundraligjshme të tij, por edhe në refuzim të veprimeve që nevojiten për realizimin detyrave të tij.

Gjykata kompetente është gjykata që ka lëshuar urdhrin e ekzekutimit. Si rregull ky ankim nuk pezullon ekzekutimin, përveç kur gjykata vendos ndryshe.⁸⁸

Një mjet tjetër që lidhet me mbrojtjen nga parregullsitë e veprimeve të ekzekutimit është ‘kërkimi i sendit nga personi i tretë’⁸⁹.

Kjo padi i jep të drejtën çdo personi të tretë që pretendon se është pronar i sendit mbi të cilin bëhet ekzekutimi, për të ushtruar të drejtën e tij dhe kur është rasti për të përjashtuar sendin nga sekuestrimi dhe shitja.⁹⁰

Padia ngrihet kundër kreditorit dhe debitorit dhe kompetente është gjykata e vendit të ekzekutimit të vendimit. Kjo gjykatë kur e sheh të arsyeshme mund të vendosë pezullimin e ekzekutimit me ose pa garanci, si një masë e përkohshme.⁹¹

⁸⁵ Neni 609, para.2 i Kodit të Procedurës Civile.

⁸⁶ Neni 609, para.2 i Kodit të Procedurës Civile.

⁸⁷ Neni 610 i Kodit të Procedurës Civile.

⁸⁸ Neni 610 i Kodit të Procedurës Civile.

⁸⁹ Neni 612 dhe 613 i Kodit të Procedurës Civile.

⁹⁰ Neni 612 i Kodit të Procedurës Civile.

⁹¹ Neni 612 i Kodit të Procedurës Civile.

2.1.7. Pezullimi e pushimi i ekzekutimit

2.1.7.1. Pezullimi i ekzekutimit

Me nisjen e procesit të ekzekutimit të një vendimi të formës së prerë prezumohet se të drejtat e fituara gjyqësisht do të realizohen, por ligji ka parashikuar raste në të cilat ky proces mund të pezullohet. Ky pezullim do të vijojë deri në zhdukjen e shkaqeve ose rrethanave që e kanë pezulluar atë.

Ekzekutimi i titullit ekzekutiv mund të pezullohet në rastet e parashikuara shprehimisht në Kodit të Procedurës Civile. Sipas nenit 615 ekzekutimi pezullohet:

- a) me vendim të gjykatës në rastet e parashikuara nga ligji;
- b) me kërkesë të kreditorit;
- c) me rastet e parashikuara nga shkronjat “c” dhe “ç” të nenit 297 të Kodi të Procedurës Civile, me përjashtim të shitjes në ankand të një sendi të paluajtshëm, për të cilin është shpallur lajmërimi;
- ç) në raste të tjera të parashikuara nga ligji;
- d) kur përmbaruesi gjyqësor, vetë ose me kujdesin e kreditorit, nuk gjen pasuri të debitorit, brenda 6 muajve nga fillimi i ekzekutimit;
- dh) kur kreditori nuk paraqitet, pa shkaqe të arsyeshme, brenda 3 muajve nga njoftimi i dytë shkresor, bërë nga përmbaruesi gjyqësor.⁹²

Ekzekutimi pezullohet me vendim të gjykatës kur ajo çmon të nevojshme pezullimin e veprimeve të ekzekutimit për një kohë të caktuar, zakonisht deri në zgjidhjen e çështjes me vendim përfundimtar. P.sh. gjykata vendos pezullimin e ekzekutimit deri

⁹² Neni 615 i Kodit të Procedurës Civile.

në përfundim të gjyqimit të padisë së ngritur për pavlefshmërinë e titullit ekzekutiv⁹³ etj.

Në pikën “a” të nenit 615, të Kodit të Procedurës Civile, ligjvënësi ka parashikuar si mënyrë mbrojtje kundër ekzekutimit të titullit ekzekutiv, pezullimin përmes një vendimi pezullimi, që në këtë rast vendimi është marrë bazuar në nenin 479/a të Kodit të Procedurës Civile, ky i fundit është një vendim i dhënë nga Gjykata e Lartë. Në një rast të tillë, përmbaruesi ndërpret çdo veprim që lidhet me ekzekutimin e titullit ekzekutiv, derisa të mbyllet me vendim përfundimtar çështja nga Gjykata e Lartë.⁹⁴

Në bazë të së drejtës së disponibilitetit, vetë kreditori i cili ka nisur më kërkesë ekzekutimin mund të bëjë kërkesë më shkrim për pezullimin e tij. Edhe përmbaruesit i lind e drejta të marrin vendim për pezullim të ekzekutimit, kur për 6 muaj nga momenti i fillimit të veprimeve përmbarimore nuk ka gjetur pasuri të debitorit.

Një rast tjetër është kur kreditori neglizhon pa shkaqe të arsyeshme nuk paraqitet, brenda tre muajve nga njoftimi i dytë shkresor që i është bërë nga përmbaruesi gjyqësor.

Sipas nenit 615 të Kodit të Procedurës Civile përveç rasteve të përcaktuara shprehimisht, mund të ketë edhe raste të tjera të përcaktuara në ligj që pezullojnë ekzekutimin e titujve ekzekutiv. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë në vendimin e tij nr.157, datë 19.03.2015 pohon se: “Instituti i masës së sigurimit të padisë është i ndryshëm nga ai i pezullimit të ekzekutimit të titullit ekzekutiv.

⁹³ Neni 609 i Kodit të Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë

⁹⁴ Vendimi i Gjykatës së Apelit Tiranë nr.2999, datë 19.12.2012

Sigurimi i padisë është një mjet ligjor i parashikuar në nenet 202-212 të Kodit të Procedurës Civile, ndërsa pezullimi i ekzekutimit të titullit ekzekutiv është një masë paraprake që merret nga gjykata në procesin e ekzekutimit të detyrueshëm dhe parashikohet në disa dispozita të veçanta të Pjesa e Katërt “Ekzekutimi i detyrueshëm” i po këtij Kodi. Sipas neneve 609, 610, 612 është parashikuar shprehimisht se gjykata që shqyrton çështjen, mbi kërkesën e palës, mund të vendosë pezullimin e vendimit, pra të titullit ekzekutiv, me ose pa garanci”.⁹⁵

Rastet e pezullimit të ekzekutimit të titullit ekzekutiv janë të parashikuara shprehimisht në nenin 615 të Kodit të Procedurës Civile dhe asnjë prej tyre nuk parashikon që ekzekutimi të pezullohet për shkak se vendimi që po ekzekutohet është ankimuar në gjykatë më të lartë. Por Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë është shprehur se: *“ushtrimi i ankimit nga V B kundër vendimit gjyqësor të sipërcituar dhe kalimi i dosjes gjyqësore gjykatës së apelit përbën pengesë ligjore për zhvillimin e mëtejshëm të veprimeve përmbare dhe njëkohësisht, shkak ligjor për pezullimin e tyre”*.⁹⁶

Pasi bie masa e pezullimit dhe shuhen rrethanat për të cilat ekzekutimi është pezulluar, përmbareuesi gjyqësor vijon nga veprimi procedural i mbetur në çastin e pezullimit.

2.1.7.2. Pushimi i ekzekutimit

Edhe rastet dhe kushtet e pushimit të ekzekutimit të detyrueshëm janë parashikuar shprehimisht në nenin 616 të Kodit të Procedurës Civile, sipas kësaj dispozite, ekzekutimi pushon:

⁹⁵ Vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr.157, datë 19.03.2015

⁹⁶ Vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr.495, datë 09.10.2014.

- a) kur debitori i paraqet përmbaruesit gjyqësor dëftesën me nënshkrimin e kreditorit, të vërtetuar rregullisht, se ka paguar shumën që shënohet në urdhrin e ekzekutimit, ose kuitancë të zyrës postare ose shkresë të bankës me të cilat vërtetohet se shuma që shënohet në urdhrin e ekzekutimit është derdhur në dobi të kreditorit;
- b) kur kreditori heq dorë me shkresë nga ekzekutimi;
- c) kur gjykata deklaron, me një vendim gjyqësor të formës së prerë, sipas nenit 609 të këtij Kodi, se titulli ekzekutiv është i pavlefshëm, ose se detyrimi nuk ekziston, ose ekziston në një masë më të vogël, ose është shuar më pas;
- ç) kur me vendim të gjykatës që ka marrë formën e prerë, është pranuar padia e debitorit sipas nenit 610 , ose e personit të tretë sipas nenit 613.⁹⁷

Në rastin kur vendimi për pushimin e ekzekutimit të titullit ekzekutiv merr formë të prerë, hiqen sekuestrot e vëna mbi sendet e luajtshme ose të paluajtshme nga ana e përmbaruesit. Ai ka të drejtë të vendosë për heqjen e sekuestrove, kur kreditori dorëhiqet me shkresë nga ekzekutimi.

Në momentin kur përmbaruesi heq sekuestrot, ai ka detyrimin t'i kthejë urdhrin e ekzekutimit kreditorit. Këtij të fundit i lind e drejta të paraqesë kërkesë të re për ekzekutim brenda afateve të parashkrimit. Në këtë rast, parashkrimi i ri fillon nga dita që vendimi për pushimin e ekzekutimit ka marrë formën e prerë⁹⁸.

⁹⁷ Neni 616 i Kodit të Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë.

⁹⁸ Neni 617 i Kodit të Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë.

Pushimi i ekzekutimit shënon përfundimin e procesit përbarimor. Në këtë mënyrë përbaruesi gjyqësor me vendim të argumentuar vendos pushimin e ekzekutimit të urdhrin të ekzekutimit pasi vendimi është ekzekutuar tërësisht.

Ashtu si në rastin e pezullimit, ekzekutimi mund të pushohet me iniciativë të vetë kreditorit, i cili paraqitet me kërkesë me shkrim përpara përbaruesit duke u dorëhequr. Pushohet ekzekutimi i një titulli ekzekutiv kur shkaqet e pezullimit të tij kanë pasuar me prishjen apo ndryshimin e vendimit të formës së prerë të vendosur në ekzekutim.

Përbaruesi gjyqësor duhet të njoftojë palët, si atë kreditore ashtu edhe atë debitore në lidhje me vendimin e pushimit. Lidhur me këtë vendim palët kanë të drejtë të ankohen sipas rregullave të nenin 610 të Kodit të Procedurës Civile.

Të analizosh këtë proces ka rëndësi thelbësore për të bërë më pas edhe një raportim të fazave në të cilat hasen më shumë problematika. Ky është një hap i rëndësishëm edhe për të nxjerr konkluzione mbi veprimtarinë dhe angazhimin shtetëror të organeve përkatëse.

2.1.8. Ndryshimet e fundit ligjore lidhur me mjetin e ankimit për konstatimin e shkeljes së “afatit të arsyeshëm” dhe “shpërblimit të dëmit”

Nga sa më sipër, ky është një interpretim i Kodit të Procedurës Civile, i cili përpiqet të parashikojë të gjithë procesin e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Ndonëse ky Kod i dedikon procesit të ekzekutimit disa kapituj të tij, ky moment procedural gjithmonë sjell të panjohura dhe problematika.

Problemet më të mëdha që lindin në këtë proces lidhen me tejzgjatjen në kohë, të mos realizimit të procesit të ekzekutimit të vendimeve të formës së prerë ose titujve të tjerë ekzekutiv.

Njihet tashmë gjerësisht se ekzekutimi i vendimeve të formës së prerë brenda një 'afati të arsyeshëm' është një e drejtë kushtetuese dhe komponent thelbësor i procesit të rregullt ligjor. Pengesat që lindin në përmbushjen e kësaj të drejte sjellin jo vetëm pakënaqësi tek palët e dëmtuara, por gjithashtu edhe shtim të kërkesave në Gjykatën Kushtetuese dhe në atë të Strasburgut për shkelje të procesit të rregullt ligjor.

Ishte pikërisht GJEDNJ që për vite me radhë deklaroi, nxiti dhe rekomandoi që shteti ynë në bazë të Kushtetutës dhe KEDNJ-së, të shtonte mjetet efektive ligjore kombëtare në lidhje më këtë ankim dhe të rishikonte kuadrin ligjor për përcaktimin e rregullave të ekzekutimit të titujve ekzekutiv.

Gjatë kësaj kohe janë bërë përpjekje për të sistemuar dispozitat procedurale të fazës ekzekutuese dhe që prej vitit 2006 Gjykata Kushtetuese nisi të pranonte gjykime lidhur me këtë shkelje duke i konstatuar ato.

Por problemi konsistonte, as rregullimet ligjore dhe as pranimi i ankimeve në GJK nuk e uli fluksin e ankimeve të individëve në GJEDNJ lidhur me këtë çështje.

Kjo për shkak se GJK edhe në rastin kur pranonte shkeljen, kishte kompetencë vetëm ta konstatonte atë dhe jo t'i ofronte palës së dëmtuar një shpërblim të drejtë.

Me direktivat e vazhdueshme të GJEDNJ, por edhe në kuadër të Reformës në Drejtësi për të finalizuar ekzekutimin e vendimeve të cilat kanë kaluar tej çdo afati për ekzekutimin e tyre, në Nëntor të vitit 2017 Parlamenti ynë miratoi ligjin nr.38/2017 “Për disa ndryshime në Kodin e Procedurës Civile”.

Në këtë ligj është shtuar një kre i dedikuar (Kreu X “Mbi gjykimin e kërkesave për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm, përshpejtimin e procedurave dhe shpërblimin e dëmit”). Ky kre parashikon ‘afatin e arsyeshëm’ të proceseve gjyqësore penale, civile dhe administrative. Përcakton gjithashtu edhe mjetet ligjore për të kërkuar përshpejtim të procedurave dhe shpërblim të drejtë kur konstatohet kohëzgjatje e paarsyeshme, në përputhje me përkufizimin e nenit 6, paragrafi 1 i KEDNJ-së.⁹⁹

Afat i arsyeshëm për procedurat e ekzekutimit apo fazën përmbarimore sipas nenit 399/1, ç konsiderohet afati njëvjeçar dhe fillon nga dita e paraqitjes së kërkesës për vënie në ekzekutim, me përjashtim të detyrimeve periodike ose të përcaktuara në kohë.

Neni 399/1 parashikon në detaje afatet që gjykatat të vendosin për çështje në nivele të ndryshme në llojet e ndryshme të procedurave. Në pamje të parë, afatet e përcaktuara për gjykimet dhe fazën përmbarimore duken të arsyeshme. Por nuk dihet sa efektive do të jenë, pasi mbetet ende shqetësuese fakti se ekziston një numër i pamjaftueshëm i gjyqtarëve dhe i stafit gjyqësor në përgjithësi dhe kjo mund të krijojë fluks të

⁹⁹ Neni 399/1 dhe 399/2 i Kodit të Procedurës Civile

mundshëm të padive me mjetin e ri gjyqësor, veçanërisht për çështjet administrative, ku ka raste që kanë më shumë se 2 vjet në pritje të gjykimit në Gjykatën e Apelit Administrativ. Pra, nuk dihet ende nëse do të japë rezultate duke pasur parasysh gjatësinë mesatare aktuale të proceseve në nivele të ndryshme të gjykimit dhe mbingarkesën e gjykatave.

Në praktikë, do të ishte e rëndësishme që gjykatat të aplikojnë këtë dispozitë me fleksibilitet dhe të verifikojnë nëse masat e marra për të përshpejtuar procedurat, në të vërtetë kishin një efekt real të shkurtimit të tyre.

"Shpërblim i drejtë" për shkeljen e standardit "afat i arsyeshëm" konsiderohet njohja e cënimit, çdo masë e marrë për të përshpejtuar procedurat e hetimit, gjykimit të çështjes dhe të ekzekutimit të vendimit, dhe/ose shpërblimin e demit.¹⁰⁰

Po si do të funksionojë përdorimi i këtij mjete ligjor?

Kreditori i cili pretendon se i është cënuar e drejta për të ekzekutuar vendimin e formës së prerë brenda një afati të arsyeshëm, pasi ka përmbushur kriterin e tejkalimit të afatit sipas nenit 399/1, i drejtohet sërish gjykatës së shkallës së parë kompetente për ekzekutimin.¹⁰¹ Ai bën kërkesë për konstatimin e shkeljes dhe përshpejtimin e procedurave të ekzekutimit. Kjo gjykatë duhet të shprehet me vendim brenda 45 ditëve, nga paraqitja e kërkesës.¹⁰²

¹⁰⁰ Neni 399/3 i Kodit të Procedurës Civile

¹⁰¹ Neni 399/6, 1 ç i Kodit të Procedurës Civile

¹⁰² Neni 399/7, 2 i Kodit të Procedurës Civile

Nëse është ezauruar kjo fazë dhe Gjykata e shkallës së parë ka dal me vendim për pranimin e kërkesës, konstatimin e shkeljes dhe urdhërimin e ndërmarrjes brenda afateve të veprimeve të caktuara procedurale gjatë ekzekutimit¹⁰³, vendimi i gjykatës nuk është ekzekutuar nga organi që ka kryer shkeljen¹⁰⁴ dhe vendimi i gjykatës që konstaton shkeljen merr formë të prerë¹⁰⁵, atëherë kreditorit i lind e drejta t'i drejtohet gjykatës civile të shkallës së parë, ku ka qendrën organi ndaj të cilit është konstatuar shkelja, me kërkesëpadi për shpërblim dëmi.

Të paditur në gjykim thirren Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Financave, ose shërbimi përmbarimor privat përgjegjës.¹⁰⁶ Kjo padi parashkruhet brenda 6 muajve nga konstatimi i shkeljes me vendim të formës së prerë.¹⁰⁷ Gjykimi i kërkesëpadiisë për shpërblim dëmi bëhet sipas rregullave të zakonshme të gjykimit brenda një afati 3 mujor nga depozitimi i kërkesëpadiisë.¹⁰⁸ Pas shqyrtimit të kërkesëpadiisë, gjykata vendos shpërblimin e dëmit nga 50 000 lekë deri në 100 000 lekë, për çdo vit, ose muaj në raport me vitin, përtej afatit të arsyeshëm.¹⁰⁹

Një aplikant që dëshiron të përdorë këtë instrument ligjor, së pari do të duhet të kërkojë që gjykata të vendosi nëse e drejta e tij për gjykim brenda një afati të arsyeshëm është shkelur dhe vetëm nëse ajo vendos pranimin e kësaj kërkesë, kreditori mund të fillojë procedura të veçanta për shpërblim dëmi. Kjo zgjidhje edhe pse në pamje të parë nuk

¹⁰³ Neni 399/8, 1a i Kodit të Procedurës Civile

¹⁰⁴ Neni 399/4, 2 i Kodit të Procedurës Civile

¹⁰⁵ Neni 399/6, 2 i Kodit të Procedurës Civile

¹⁰⁶ Neni 399/4, 2 i Kodit të Procedurës Civile

¹⁰⁷ Neni 399/6, 3 i Kodit të Procedurës Civile

¹⁰⁸ Neni 399/7 1 Kodit të Procedurës Civile

¹⁰⁹ Neni 399/10 i Kodit të Procedurës Civile

është shumë e zakonshme dhe e komplikuar për kërkuuesin, ekziston në Poloni dhe Gjermani, ku në parim mjetet juridike konsiderohen të jenë efektive.¹¹⁰

Sidoqoftë, kjo skemë që ka zgjedhur legjislacioni ynë mund të krijojë probleme në varësi të mënyrës së zbatimit të saj në praktikë. Nëse zbatohet me përpikmëri, kjo mund të shpejtojë ndjeshëm procedurat e gjata.

Një tjetër aspekt që duhet theksuar është se vendimi i gjykatës lidhur me konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm nuk mund të ankimohet dhe është i formës së prerë.¹¹¹

Në rast se kërkesa refuzohet nga gjykata (ligji nuk specifikon kur ose arsyet për të cilat gjykata mund të refuzojë çështjen), ajo nuk mund të paraqitet përsëri për të njëjtat fakte.

Afati i parashkrimit të kërkesëpadsisë për shpërblim dëmi është 6 muaj, nga dita kur është konstatuar shkelja me vendim gjyqësor të formës së prerë. Gjykimi për shpërblim të drejtë (për shkelje të parimit 'afat i arsyeshëm') parashikohet të zhvillohet sipas procedurave të zakonshme të gjykimit, brenda 3 muajve nga data e plotësimit të padsisë.¹¹² Kështu, në mënyrë ideale dy procedurat e ndara duhet të zgjasin rreth 5 muaj, kohë e cila është në përputhje me standardet e GJEDNJ-së.

¹¹⁰ Analysis of legislation introduced to deal with protracted domestic proceedings in Albania, Council of Europa, November 2017, fq. 15.

¹¹¹ Neni 399/8, 3 i Kodit të Procedurës Civile

¹¹² Neni 399/7, 1 i Kodit të Procedurës Civile

Sidoqoftë, kjo mbetet për t'u parë në praktikë, veçanërisht duke marrë parasysh shqetësimet e përsëritura të ngritura nga autoritetet në lidhje me numrin e pamjaftueshëm të gjyqtarëve dhe gjykatave tashmë të mbingarkuara.¹¹³

Gjykata vendos për shkeljen bazuar në kompleksitetin e çështjes, objektin e padisë, sjelljen e palëve, sjelljen e gjykatës, sjelljen e përmbauesit dhe sjelljen e çdo personi tjetër që lidhet me çështjen¹¹⁴. Kjo dispozitë merr parasysh disa nga kriteret e përdorura nga GJEDNJ. Do të jetë e rëndësishme që gjykata t'i zbatojë këto kriteret në frymën e saj dhe jo t'i përdorë në dëm të palëve, duke pretenduar se nuk është as gjykata dhe as pala përgjegjëse për kohëzgjatjen e procesit, por përgjegjësia është për shembull e një eksperti apo dikujt tjetër, duke u shmangur kështu nga detyrimi i tyre.

Sipas nenit 399/10 shuma e kompensimit nuk mund të tejkalojë vlerën e objektit të ekzekutimit. Dispozita që vlera e “shpërblimit të drejtë” nuk mund të tejkalojë vlerën e kërkesës, duket se është kufizuese. Për më tepër, në rastet që kërkojnë kujdes të veçantë ose në rastet kur ka vonesa shumë serioze, shumat e kompensimit mund dhe duhet të jenë më të larta. Kjo mund të zgjidhet duke shtuar një dispozitë, sipas së cilës nëse shuma e parashikuar në ligj nuk është e drejtë për shkak të rrethanave të çështjes, gjykata mund të lejojë një shumë më të lartë ose më të ulët.

Nga praktika vihet re se ky mjet ligjor edhe pse ka rreth tre vite që është në fuqi nuk

¹¹³ Analysis of legislation introduced to deal with protracted domestic proceedings in Albania, Council of Europa, November 2017, fq. 17.

¹¹⁴ Neni 399/9 i Kodit të Procedurës Civile

aplikohet thuajse fare, ky është tregues që subjektet nuk e shohin si mjet efektiv për realizimin e të drejtave të tyre të fituara gjyqësisht.

Konstatohet gjithashtu se ka mungesë të kriterëve ligjore për llogaritjen e shpërblimit të drejtë kur gjykata vendos shkelje të afatit të arsyeshëm. Shpërblimi i dëmit përbën një koncept juridik të mirë përcaktuar nga legjislacioni dhe jurisprudenca prej vitesh. Shpërblimi i dëmit në thelb duhet përkthyer si një përlllogaritje e dëmit të pësuar dhe fitimit të munguar. Por, në rastin e shpërblimit që ka vendosur ligjvënësi ynë në këtë kre duket që nuk kemi të bëjmë me shpërblim të drejtë.

Të gjitha këto konkluzione na çojnë në përfundimin se, me gjithë përpjekjet për fortësimin e legjislacionit procedural, por edhe atë të shërbimit përmbartimor dhe kushtetues, të cilat do ti studiojmë në vijim, nuk kanë sjellë ende një mjet efektiv në duart e subjekteve që kanë pësuar dëme nga mosekzekutimi i vendimeve gjyqësore të formës së prerë të cilët vijojnë të vuajnë zvarritjen e këtij procesi.

2.2. Vendimet gjyqësore administrative dhe ekzekutimi i tyre

Nga gjykata kushtetuese, deri vonë, ekzekutimi i vendimeve të gjykatës nuk shihej si i lidhur me nenin 42 të Kushtetutës, nen ky që parashikonte shtyllat themelore për një proces të rregullt ligjor. Por aplikimi i legjislacionit të Bashkimit Evropian, direktivat e tij të vazhdueshme ndaj Shqipërisë dhe në veçanti jurisprudencat e GJK dhe GJEDNJ i dhanë kësaj të drejte kuptimin dhe rëndësinë që ka sot.

Vonesat në ekzekutime të vendimeve në vendin tonë siç edhe shihen nga rastet e aplikuara në GJK dhe GJEDNJ janë më së shumti kundër organeve publike.

Me miratimin e ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” u përmirësua situata lidhur me menaxhimin e ngarkesës që kishte Gjykata Civile në kuadër të ankimimeve ndaj administratës publike, duke e kornizuar atë më vete.

Sipas këtij ligji nga momenti që vendimi gjyqësor administrativ ka marrë formë të prerë, ai përbën titull ekzekutiv dhe çdo akt i nxjerrë apo veprim i kryer nga organi publik i paditur që vjen në kundërshtim me vendimin gjyqësor do të jetë absolutisht i pavlefshëm dhe nuk pengon ekzekutimin tij.¹¹⁵

Ky parashikim ngurtëson hapësirat për abuzime nga ana e organeve publike debitore dhe lehtëson rivendosjen e të drejtave të shkelura. Ishte pikërisht ligji “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve

¹¹⁵ Neni 65, pika 2 i Ligjin Nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”

administrative” i cili parashikoi për herë të parë që vendimi gjyqësor do të jetë njëherazi titull ekzekutiv dhe urdhër ekzekutimi.

Procesi i ekzekutimit do të nis me kërkesën e kreditorin¹¹⁶ pranë shërbimit përbarimor gjyqësor publik ose privat. Këta të fundit janë të detyruar të ekzekutojnë vendimet e Gjykatës Administrative, sipas rregullave të këtij ligji. Një risi që ka sjellë ligji për Gjykatat Administrative është roli i gjyqtarit në procesin e ekzekutimit të vendimeve, pra gjyqtari që ka dhënë vendimin vazhdon ndjek edhe fazën e ekzekutimit të tij. Sipas nenit 66/1 me kërkesë të palëve ose të përbaruesit gjyqësor, gjyqtari apo kryetari i trupit gjykues, që ka dhënë vendimin, mund të urdhërojë kryerjen e veprimeve të caktuara apo të marrë masa të nevojshme mbi bazën e një afati apo forme të caktuar.

Përbaruesi gjyqësor, në përfundim të afatit të ekzekutimit të detyrueshëm njofton me shkrim gjyqtarin për veprimet e kryera nga organi publik debitor.¹¹⁷ Gjyqtari që ka dhënë vendimin, në rast se konstaton moskryerje me faj të detyrimeve dhe pa shkaqe të përligjura, sipas vendimit apo urdhrave të gjykatës, ka të drejtë të vendos gjobë¹¹⁸ ndaj titullarit të organit publik debitor, mund të kërkojë marrjen e masave

¹¹⁶ Neni 65 i Ligjin Nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”

¹¹⁷ Neni 68/1 i Ligjin Nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

¹¹⁸ Neni 68/2 i Ligjin Nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”

disiplinore dhe, kur është rasti, të paraqesë edhe kallëzim penal ndaj personave përgjegjës.¹¹⁹

Ky përcaktim i jep të drejtave të fituara gjyqësisht në gjykatat administrative një prioritet të veçantë dhe personalisht e vlerësoj si dispozitë lehtësuese për çdo subjekt që i janë cënuar të drejtat nga organet publike. Roli i gjyqtarit në ndjekjen e ekzekutimit të vendimeve që ka lëshuar vetë është shumë efektive për realizimin e kësaj të drejte. Vlen të theksohet edhe fakti që nga praktika, për shkak të mbingakesës dhe mungesës së gjyqtarëve kjo nuk zbatohet në të gjitha rastet.

Përcaktime të tilla përbëjnë edhe ndryshimet kryesore që ligjit për Gjykatat Administrative me Kodin e Procedurës Civile. Gjykoj se kontrolli i procedurave përmbare nga gjyqtari që ka dhënë vendimin do të ishte tepër efektiv edhe për proceset civile. Kjo pasi edhe mjetet ligjore për të kundërshtuar veprimet përmbare apo për kërkuar një shpërblim të drejtë për tejzgjatje të afateve, duke qenë se gjykohen nga një gjyqtar i ndryshëm nga ai që ka dhënë vendimin, mund krijojnë përplasje në arsyetimin e tyre dhe në fund gjyqfituesi të vijojë zvarritjet duke mos përfituar nga e drejta që i takon.

Përpos vendimeve të formës së prerë të gjykatës administrative në fazën përmbare shkojnë edhe tituj ekzekutiv të cilët nuk janë dhënë nga gjykata, por janë lëshuar nga

¹¹⁹ Neni 68/3 i Ligjin Nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”

organet administrative, sipas përcaktimeve të nenin 510/e të Kodit të Procedurës Civile të tilla akte janë për shembull vendimet e Komisionit të Shërbimit Civil. Në vitin 2007 Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë me vendimin numër 3, arsyetojnë se : *“Komisionit të Shërbimit Civil është organi që ka juridiksionin fillestar të zgjidhjes së mosmarrëveshjes nëpërmjet dhënies së një vendimi në përfundim të këtij procesi. Vendimet e KSHC ngjasojnë me vendimin e dhënë nga gjykata e shkallës së parë nisur nga tiparet dhe nga fuqia detyruese që ligjvënësi u ka dhënë në rast se ato nuk ankimohen”*.

Në ndryshim nga procedura e Kodit të Procedurës Civile, tarifat për shpenzimet përbarimore konsiderohen pjesë e shpenzimeve gjyqësore dhe nuk parapaguhet nga kreditori. Ato llogariten nga përbaruesi gjyqësor dhe paguhen nga debitori.¹²⁰

Në rastet kur detyrimi i paraqitur në vendimin gjyqësor që lidhet me nxjerrjen ose ndryshimin e një akti administrativ, nuk është përmbushur nga organi publik, pas kalimit të afatit për ekzekutim vullnetar, pavarësisht masave të marra, gjykata, nëse gjatë shqyrtimit gjyqësor ka konstatuar se janë vërtetuar të gjitha faktet e nevojshme për nxjerrjen e aktit, merr një vendim, që zëvendëson aktin administrativ, i cili prodhon të gjitha pasojat e nevojshme juridike.¹²¹

¹²⁰ Neni 66/2 i Ligjin Nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”

¹²¹ Neni 67/1 i Ligjin Nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”

Nëse vendimi i gjykatës për detyrimin e organit publik për të kryer një veprim administrativ apo për të ndaluar kryerjen e një veprimi tjetër administrativ, nuk është përmbushur brenda afatit për ekzekutim vullnetar, me kërkesë të paditësit e pavarësisht masave të marra, sipas këtij ligji, gjykata urdhëron përmbaruesin gjyqësor, në përputhje me dispozitivin e vendimit të saj, të kryejë apo të ndalojë veprimin.¹²² Për zbatimin e urdhrave të dhëna nga gjykata, përmbaruesi gjyqësor, kur është e nevojshme, mbështetet nga Policia e Shtetit.

Përpos faktit që këto janë norma të parashikuara në ligjin për organizimin e gjykatave administrative, në praktikë nuk është gjithmonë e lehtë të respektohen. Përmbaruesit hasin vështirësi të mëdha në përballjen me institucione shtetërore apo me autoritete të posaçme, kjo për shkak se organet shtetërore kanë një lloj epërsie në marrëdhëniet që krijojnë me subjekte të tjera dhe as policia në shumicën e rasteve nuk jep kontributin e saj në këtë bashkëpunim. Këtu duhet të kemi një ndërhyrje më të fortë të institucioneve kushtetuese, që kanë si përgjegjësi monitorimin dhe garantimin e të drejtave të individit.

Mjet ligjor ankimi për veprimet përmbarimore në kundërshtim me masat apo urdhrat e gjykatës, është padia për kundërshtime të veprimeve përmbarimore sipas nenit 610 të Kodit të Procedurës Civile.¹²³

¹²² Neni 67/2 i Ligjin Nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

¹²³ Neni 69 i Ligjin Nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

KREU III

SHËRBIMI PËRMBARIMOR NË SHQIPËRI

3.1. Kuptimi i shërbimit përmbarimor

Në Shqipëri, Shërbimi përmbarimor është një institucion i cili ka si detyrë të realizojë ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë dhe titujve të tjerë ekzekutivë të lëshuara nga gjykatat civile, administrative dhe një pjesë të atyre penale.

Shqipëria në kuadër të marrëveshjeve të Stabilizim - Asocimit është orientuar, në veçanti që të përmirësojë funksionimin e kësaj zyre.

Duhet që vendimet e gjykatave dhe jo vetëm, të marrin vlerë ligjore nëpërmjet veprimeve përmbarimore. Në këtë mënyrë do të rritet ndjeshëm besimi kundrejt sistemit të drejtësisë. Në Kodin e Procedurës Civile nuk parashikohet forma e organizimit të shërbimit përmbarimor, për këtë arsye është miratuar nga Parlamenti shqiptar ligji "Për Organizimin dhe Funksionimin e Shërbimit të Përmbarimit Gjyqësor". Ky ligj ka hyrë fuqi në Janar të vitit 2001.

Ligji "Për Organizimin dhe Funksionimin e Shërbimit të Përmbarimit Gjyqësor" përcakton në formë specifike rregullat e organizimit dhe funksionimit të Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor, strukturën e brendshme të tij, statusin e punonjësve dhe kriteret për t'u punësuar në këto institucione etj.

Aktualisht shërbimi Përmbartimor funksionon në mënyrë autonome nga hallkat e sistemit gjyqësor, ky shërbim ka varësi direkte, nga Ministri i Drejtësisë.¹²⁴

Bazuar në standardet ndërkombëtare dhe ato të vendosura nga BE, u realizua një përshtatje e legjislacionit mbi shërbimin e ekzekutimit të titujve ekzekutivë, duke ndërtuar kështu një shërbim të dyfishtë (shërbimi përmbartimor shtetëror dhe ai privat). Kjo ka qenë një sfidë për ekspertët tonë të cilët e bënë të mundur këtë mision edhe me ndihmën e profesionistëve të huaj. Ky bashkëpunim i ashtuquajtur ‘Misioni Euralius’, u konkretizua në vitin 2008, nëpërmjet hartimit dhe miratimit të ligjit Nr.10031 “Për Shërbimin Përmbartimor Gjyqësor Privat”.

Në kuadër të reformës për drejtësi, në vazhden e përmbushjes së kriterëve dhe kushteve të vendosura nga ndërkombëtarët për integrimin e Republikës e Shqipërisë në Bashkimin Evropian më datë 8.5.2019, Parlamenti ynë miratoi paketën e re dhe të plotë të projektligjeve për këtë reformë.

Gjatë vitit 2019 Parlamenti miratoi 2 ligjet e mbetura të paketës së dytë të ligjeve të reformës në sistemin e drejtësisë¹²⁵ si dhe një vendim¹²⁶ duke finalizuar në këtë mënyrë një nga reformat më të rëndësishme të ndërmarra nga Kuvendi, nëpërmjet Komisionit të Posaçëm të Reformës në Sistemin e Drejtësisë dhe Komisionit të Përhershëm Parlamentar për Çështjet Ligjore Administratën Publike dhe të Drejtat e

¹²⁴ Neni 6, para 1, i Ligjit Nr.8730, datë 18.1.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit të Përmbartimit Gjyqësor”.

¹²⁵ Ligji nr. 25/2019, datë 25.04.2019 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”; Ligji nr.26/2019, datë 08.05.2019 “Për shërbimin përmbartimor gjyqësor privat”. Ndryshimet e Kodit të Procedurës Civile dhe ndryshimet Kushtetuese.

¹²⁶ Vendimi nr. 47/2019, datë 18.04.2019 “Për miratimin e Strategjisë së Edukimit Ligjor të Publikut 2019-2023”.

Njeriut. Parlamenti ka miratuar gjithsej 22 ligje dhe 1 vendim si pjesë e paketës së dytë të ligjeve të reformës në drejtësi, që së bashku me ndryshimet kushtetuese dhe 7 ligjet e paketës prioritare e çojnë në 30 numrin e përgjithshëm të ligjeve të miratuara si pjesë e reformës në drejtësi.¹²⁷

Shërbimi Përmbarimor është fizikisht e atashuar pranë Gjykatave të Shkallës së Parë. Si rrjedhojë, perceptohet gabimisht si pjesë e gjyqësorit.¹²⁸ Gjithsesi, ligji e shpreh qartë se Shërbimi përmbarimor është strukturë e Ministrisë së Drejtësisë.

Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore dhe titujve të tjerë ekzekutivë nga Shërbimi përmbarimor realizohet nëpërmjet pagesës së tarifave e përcaktuara nga një akt normativ të Ministrisë së Drejtësisë dhe i Financave si dhe tarifës së suksesit me marrëveshje midis kreditorit dhe Përmbaruesit.¹²⁹

Jurisprudenca kombëtare dhe ndërkombëtare, e detyrueshme për t'u zbatuar në Republikën e Shqipërisë, ka theksuar se: “Faza e ekzekutimit të detyrueshëm të vendimit të gjykatës është pjesë përbërëse e procesit të rregullt ligjor, si e tillë i nënshtrohet fushëveprimit të nenit 6 të KEDNJ, për sa kohë kjo është faza përmbyllëse e tij”¹³⁰.

¹²⁷Projektplani kombëtar për integrimin evropian 2020 – 2022, RSH, fq.21.

¹²⁸ <http://www.gjykata.gov.al/sistemi-idrejt%C3%ABsis%C3%AB/sistemigjyq%C3%ABsorit/ekzekutimi-i-vendimeve/>

¹²⁹Udhëzim i përbashkët MD dhe MF nr. 385/7, datë 28.06.2017 “Për caktimin e tarifave për shërbimet e ofruara nga shërbimi përmbarimor gjyqësor privat”, Udhëzim i përbashkët MD dhe MF nr. 385/6, datë 26.06.2017 “Për përcaktimin e nivelit minimal dhe maksimal të zbatimit të vlerës së tarifës së suksesit për veprimet përmbarimore të ofruara nga shërbimi përmbarimor gjyqësor privat.” Udhëzim i përbashkët MD dhe MF nr. 1276/5, datë 27.7.2017 “Për caktimin e tarifave për shërbimet e ofruara nga shërbimi përmbarimor gjyqësor shtetëror” dhe Udhëzim i përbashkët MD dhe MF nr. 1276/6, datë 27.7.2017 “Për përcaktimin e nivelit minimal dhe maksimal të zbatimit të vlerës së tarifës së suksesit për veprimet përmbarimore të ofruara nga shërbimi përmbarimor gjyqësor shtetëror”.

¹³⁰Vendimet nr.23/2009, nr.7/2009 dhe nr.31/2005 dhe nr.16/2012 të Gjykatës Kushtetuese.

Ky shërbim përbëhet nga persona fizikë të licencuar për këtë qëllim, të cilët respektojnë të njëjtat rregulla procedurale të përcaktuara në Kodin e Procedurës Civile. Përmbauesit privat ushtrojnë veprimtarinë e tyre në të gjithë territorin e Shqipërisë dhe organizohen në brendësi të Dhomës Kombëtare të Përmbauesve Gjyqësor Privatë, nga ana tjetër shërbimi shtetëror ushtron kompetenca vendore sipas njësive administrative dhe janë në varësi direkte nga Ministria e Drejtësisë (Drejtoria e Përgjithshme e Përmbaimit).

Liberalizimi i këtij Shërbimi u shoqërua me krijimin e disa avantazheve, siç është rritja e cilësisë së shërbimit përmbaimit, duke reduktuar kështu kohën për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë dhe titujt e tjerë ekzekutiv, nxitja e konkurrencës së lirë midis operatorëve, që do të merren me ekzekutimin e titujve ekzekutiv dhe uljen e fenomeneve korruptive në shërbimin përmbaimit.

Shërbimi i përmbaimit gjyqësor privat, i cili funksionon si i tillë që prej vitit 2010, ka në përbërje të tij një trup prej 150 përmbaues.¹³¹

Shërbimi përmbaimit gjyqësor është një shërbim i rëndësishëm për funksionimin e sistemit të drejtësisë, i pajisur me një strukturë të posaçme. Ky institucion mban barrën e një përgjegjësie jo të vogël, pasi mos funksionimi i tij pas sjell një destabilitet në ekuilibrat e këtij sistemi, duke tronditur besimin e individëve dhe sigurinë juridike ndaj vetë shtetit. E rëndësishme është të aplikohet drejtë ai sistem, që përdoret më tepër se sa të zgjidhet njëri prej tyre.¹³²

¹³¹http://www.drejtesia.gov.al/files/userfiles/Dokumenta/REGJISTRI_I_PERMBARUESVE_GJYQESOR_PRIVATE_AKTIVE_08.03.2016.pdf

¹³²Ma. I. Barjamaj, Ekzekutimi i detyrueshëm i vendimeve gjyqësore dhe problematika e praktikës gjyqësore, Disertacion, Tiranë 2016, fq. 56.

3.2. Shërbimi përbarimor shtetëror

Shërbimi përbarimor gjyqësor ka si objekt të veprimtarisë së tij¹³³ ekzekutimin e detyrueshëm të titujve në rastet e parashikuara nga Kodi i Procedurës Civile dhe ushtron funksionet e tij nëpërmjet përbaruesve gjyqësor.

Shërbimi përbarimor përbën fazën e dytë të procesit të vënies në vend të drejtësisë dhe pikërisht atë realizimit të të drejtave të fituara gjyqësisht, e cila qëndron më afër dhe në kontakt të drejtpërdrejtë me palën kreditore dhe me palët e një procesi civil në përgjithësi.¹³⁴

Shërbimi i përbarimit gjyqësor shtetëror organizohet në nivel qendror dhe vendor, në varësi të Ministrisë së Drejtësisë.¹³⁵ Shërbimit përbarimor gjyqësor shtetëror organizohet dhe funksionon sipas ligjin nr. 8730, datë 18.01.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e shërbimit të përbarimit gjyqësor” dhe konkretisht e ushtron veprimtarinë në:

- a) nivel qendror (Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Përbarimor Gjyqësor)
- b) dhe në nivel vendor, për të cilën janë 22 zyra përbarimore, të organizuar brenda juridiksionit të çdo rrethi gjyqësor të shkallës së parë, dhe varen administrativisht nga Drejtoria e Përgjithshme.¹³⁶

¹³³ Ligji Nr. 8730 datë 18.1.2001 "Për organizimin dhe funksionimin e shërbimit përbarimor gjyqësor" Fletore Zyrtare nr.1, fq.20, neni 2.

¹³⁴ <http://dpp.gov.al/historiku/>

¹³⁵ Neni 6, para 1, i Ligjit Nr.8730, datë 18.1.2001 “Për organizimin dhe Funksionimin e Shërbimit të Përbarimit Gjyqësor”.

¹³⁶ <http://dpp.gov.al/struktura/>

Shërbimet përbarimore shtetërore janë persona juridikë dhe funksionojnë pranë çdo gjykate rrethi. Ato kanë një strukturë e cila përbëhet nga kryetari i zyrës, përbaruesit gjyqësor dhe personeli administrativ. Çdo zyrë përbarimore merr masat e nevojshme procedurale për ekzekutimin efektiv të titujve ekzekutiv.

Shërbimi i Përbarimit Gjyqësor ka autonomi financiare me një buxhet të vetin, si pjesë të veçantë brenda buxhetit të Ministrisë së Drejtësisë.¹³⁷ Numri i përbaruesve gjyqësorë shtetëror përcaktohet me urdhër të Kryeministrit në bazë të propozimit të Ministrit të Drejtësisë.¹³⁸ Çdo veprim përbarimor kryhet kundrejt pagesës, e cila është përcaktuar me akt normativ.

Këshilli i Përbarimit është autoriteti i cili zhvillon konkurs për emërimin e përbaruesve gjyqësorë dhe shqyrton shkeljet disiplinore të kryera prej tyre.¹³⁹

Ka funksion këshillimor, dhe mendimet e tij ia paraqet ministrit të Drejtësisë, i cili duhet të shprehet brenda 30 ditëve nga kjo paraqitje.¹⁴⁰

¹³⁷ Neni 11/2 Ligji Nr. 8730 datë 18.1 2001 "Per organizimin dhe funksionimin e shërbimit përbarimor gjyqësor".

¹³⁸ Neni 10 Ligji Nr. 8730 datë 18.1 2001 "Per organizimin dhe funksionimin e shërbimit përbarimor gjyqësor".

¹³⁹ Neni 14/1 i Ligjit Nr. 8730, datë 18.1.2001 "Për organizimin dhe Funksionimin e Shërbimit te Përbarimit Gjyqësor".

¹⁴⁰ Neni 14/3 i Ligjit Nr. 8730, datë 18.1.2001 "Për organizimin dhe Funksionimin e Shërbimit te Përbarimit Gjyqësor".

3.3. Shërbimi përbarimor privat

Një problematikë që konstatohet për vite me radhë në Progres Raportet e BE-së ka qenë mosfunksionimi i mirë i strukturave përbarimore në detyrën e tyre për të rivendosur në vend të drejtat e shkelura dhe të njohura gjyqësisht. Nga këtu nisi dhe investimi i shtetit shqiptar në këtë drejtim, ku ndër risitë më të rëndësishme që sollën zhvillime pozitive ishte ai i krijimit të shërbimit përbarimor privat.

Ligji për shërbimin përbarimor gjyqësor privat u miratua në vitin 2008 për herë të parë. Në kuadër të vazhimit të reformimit të sistemit të drejtësisë, aktualisht ligji është rishikuar thelbësisht dhe ky shërbim funksionon me ligjin e ri 26/2019 "Për shërbimin përbarimor gjyqësor privat", i cili parashikon: "Kushtet dhe kriteret që duhet të përmbushin shtetasit për të ushtruar detyrën e përbaruesit gjyqësor privat, statusin e tyre, detyrat, përgjegjësitë, rregullat për caktimin e tarifave, masat disiplinore, si dhe marrëdhëniet me institucionet shtetërore dhe me subjektet e tjera publike dhe private."¹⁴¹

Përbaruesi gjyqësor privat, ose shoqëritë përbarimore private ushtrojnë funksionin me karakter publik në mënyrë të pavarur, në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.¹⁴² Është i legjitimuar të ushtrojë këtë funksion çdo individ i regjistruar në një nga format e parashikuara në legjislacionin në fuqi për tregtarët ose si shoqëri tregtare, pra si përbarues gjyqësor privat dhe si shoqëri përbarimore private.

¹⁴¹ Neni 1 i Ligjit Nr. 26/2019 "Për shërbimin përbarimor gjyqësor privat".

¹⁴² Neni 8 i Ligjit Nr. 26/2019 "Për shërbimin përbarimor gjyqësor privat".

Përmbaruesi gjyqësor privat, e ka për detyrë ligjore të përmbushë interesat ligjore të kreditorit, por në njëjtën kohë duhet të garantojë të drejtat themelore të debitorit, përgjatë kryerjes së veprimeve detyruese dhe ekzekutuese të procesit përmbarimor. Këto janë edhe arsyet për të cilat ligjvënësi ka përcaktuar edhe formën se si do të paguhet ky autoritet, nëpërmjet tarifave tavan dhe dysheme.

Të drejtat dhe detyrimet e përmbaruesit gjyqësor privat sipas Ligjit Nr. 26/2019 “Për shërbimin përmbarimor gjyqësor privat”, përcaktohen në nenet 36 dhe 37 të tij. Përveç këtij rregullimi ligjor, është parashikuar një rregullim më i posaçëm në kontratën e shërbimit. Kontrata e shërbimit është marrëveshje dypalëshe ku me vullnetin e tyre të lirë, ato vendosin një bashkëpunim për të realizuar ekzekutimin e një titulli ekzekutiv. Kjo kontratë është kusht për përmbaruesin privat që të nisë detyrën e tij.

Për shërbimin përmbarimor privat, veprimtaria e kryer është një marrëdhënie shërbimi në këmbim të të cilit marrin një tarifë të përcaktuar. Në nenin 525 të Kodit të Procedurës Civile, është përcaktuar se: “Tarifat fikse të përcaktuara për ekzekutimin e urdhrin ekzekutiv paguhen, fillimisht, nga kreditori dhe, pas përfundimit të procedurës së ekzekutimit, i ngarkohen debitorit. Shpenzimet e tjera, gjatë procedurës së ekzekutimit, paguhen nga pala që i ka shkaktuar ato. Masa e tarifës së suksesit, me përjashtim të rasteve kur nuk është e aplikueshme, përcaktohet me marrëveshje midis kreditorit dhe përmbaruesit gjyqësor, sipas legjislacionit që rregullon shërbimin përmbarimor gjyqësor.”

Të njëjtin qëndrim¹⁴³ mban edhe Kodi Global mbi Ekzekutimin e Detyrueshëm, i cili po ratifikohet nga të gjitha shtetet dhe anëtarësitë e Organizatës Botërore e Funkionarëve Gjyqësor, anëtare e së cilës është edhe Shqipëria.

Përmbauesi gjyqësor privat ose shoqëritë përmbaimore private ushtrojnë funksionet e tyre procedurale në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.¹⁴⁴ Përmbauesit gjyqësor privatë organizohen në rang Republike duke u përfaqësuar nga Dhoma Kombëtare e Përmbauesve Gjyqësor Privatë. Dhoma është person juridik, me status të krijuar me ligj të veçantë dhe që ushtron veprimtarinë e saj në mënyrë të pavarur nga shteti. Ajo fiton personalitet juridik për shkak të ligjit.¹⁴⁵

Dhoma Kombëtare e Përmbauesve Gjyqësor Privatë përgjigjet për organizimin, funksionimin dhe mbikëqyrjen e ushtrimit të profesionit të përmbauesit gjyqësor privat në Republikën e Shqipërisë.¹⁴⁶

3.3.1. Shërbimi përmbaimator privat, risitë ligjore në kuadër të Reformës në Drejtësi

Sistemi i drejtësisë ka qenë shpesh objekt i reformave të ndryshme, herë të imponuara nga faktorët e brendshëm si ndryshimi i regjimit politik dhe herë të imponuar nga faktorët e jashtëm në kuadër të arritjes së standardeve evropiane.

¹⁴³ Neni 5 i Kodit Global mbi Ekzekutimin e Detyrueshëm.

¹⁴⁴ Neni 9 i Ligjit Nr. 26/2019 “Për shërbimin përmbaimator gjyqësor privat”.

¹⁴⁵ Neni 29/3 i Ligjit Nr. 26/2019 “Për shërbimin përmbaimator gjyqësor privat”.

¹⁴⁶ Neni 29/2 i Ligjit Nr. 26/2019 “Për shërbimin përmbaimator gjyqësor privat”.

Aktualisht shteti ynë po kalon një kalvar të gjatë dhe të mundimshëm, në rrugën e përmirësimit dhe krijimit të mekanizmave ligjorë efektivë, si pjesë e Reformës në Drejtësi. Fokusi kryesor ka qenë tek komponentët më të rëndësishëm që e përbëjnë sistemin e drejtësisë, qofshin këto organe shtetërore, por edhe profesionet e lira të cilat mbulojnë një përgjegjësi jo të vogël.

Këto profesione ofrojnë mjetet dhe shërbimet e nevojshme për ushtrimin e të drejtave të tyre si dhe garantimin dhe rivendosjen në vend të tyre, kur ato janë cënuar. Këto janë sfida për të arritur një zhvillim dhe konsolidim të demokracisë dhe shtetit të së drejtës.

Shërbimi përbarimor është pjesë e rëndësishme e sistemit të së drejtës dhe mbulon një detyrë me shumë përgjegjësi, jo vetëm kundrejt individëve kreditorë por edhe kundrejt shtetit. Mos funksionimi i këtij shërbimi rëndon një sistem të tërë të drejtash dhe në veçanti të drejtat themelore të njeriut, siç është ai për një proces të rregullt ligjor.

Shërbimi i përbarimit gjyqësor privat, që nga momenti i krijimit me anë të ligjit të vitit 2008, ashtu siç u përmend dhe më lart, ka pësuar ndryshime të vazhdueshme. Ligji i ri i “Për shërbimin përbarimor gjyqësor privat”, i miratuar në vitin 2019 solli disa risi të rëndësishme. Fusha e zbatimit të këtij ligji ka përfshirë dhe veprimtaritë të tjera që mund të kryejë përbaruesi si gjatë punës së tij si: kryerjen e njoftimeve të akteve gjyqësore e dokumenteve zyrtare, kryerjen e njoftimeve për mbledhjen e detyrimeve financiare me mirëkuptim, me kërkesë të të interesuarve, kryerjen e konstatimeve të fakteve, sendeve dhe dukurive lehtësisht të verifikueshme, që nuk

kërkojnë njohuri specifike teknike sipas legjislacionit në fuqi, me kërkesë të të interesuarve, kryerjen e shitjes së sendeve në ankand publik me kërkesë të të interesuarve.¹⁴⁷

Duke i dhënë një rëndësi të veçantë dhe për të mos pasur paqartësi në interpretim janë dhënë përkufizimet e termave kryesore të ligjit.¹⁴⁸ Organizimi i përmbaruesve gjyqësorë është detajuar nga ligji duke i dhënë mundësinë e organizimit në zyra përmbarimore ku administratorët, ortakët apo aksionarë të zyrave të përmbarimit privat mund të jenë vetëm individët e licencuar si përmbarues gjyqësorë privatë, të cilët mund të jenë të atashuar vetëm pranë një zyre të përmbarimit privat.¹⁴⁹

Në mënyrën e organizimit të zyrave të përmbaruesve privatë është parë e rëndësishme nga ligji që të përcaktohet numri i përmbaruesve gjyqësorë privatë. Kështu nisur dhe nga të dhënat zyrtare të cencusit të popullsisë është përcaktuar në raportin e fundit që për 20.000 mijë banorë mund të ketë 1 përmbarues, kjo është e lidhur dhe me vëllimin minimal të punës së veprimtarisë përmbarimore, zhvillimin ekonomik rajonal apo veçoritë e territorit dhe mjetet e komunikimit dhe të transportit.¹⁵⁰

Papajtueshmëria e përmbaruesit plotësohet me disa pika, ku përfshihet mos ushtrimi i një veprimtarie tjetër politike, shtetërore ose profesionale që realizohet kundrejt pagesës, me përjashtim të veprimtarisë akademike ose shkencore, mos përdorimi i të

¹⁴⁷ Neni 2 i Ligjit Nr. 26/2019 “Për shërbimin përmbarimor gjyqësor privat”.

¹⁴⁸ Neni 3 i Ligjit Nr. 26/2019 “Për shërbimin përmbarimor gjyqësor privat”.

¹⁴⁹ Neni 6 i Ligjit Nr. 26/2019 “Për shërbimin përmbarimor gjyqësor privat”.

¹⁵⁰ Neni 9 i Ligjit Nr. 26/2019 “Për shërbimin përmbarimor gjyqësor privat”.

njëjtës hapësirë një zyre me atë të një avokati, studio avokatie, noter ose ndonjë person tjetër fizik ose juridik, gjithashtu mos angazhimi në veprimtari përmbarimore, e cila mund të cenojë paanshmërinë e tij.¹⁵¹

Nëse do të analizojmë ndryshimet që ka pësuar ligji për shërbimin përmbarimor, në vitin 2019, do të vërejmë një përditësim të nenit që përcakton kompetencat e Ministrit, tek i cili janë shtuar 3 pika të reja¹⁵²:

- miraton modelin e kontratës që lidhet midis përmbaruesit gjyqësor privat dhe palës së interesuar për kryerjen e konstatimeve të fakteve, sendeve dhe dukurive lehtësisht të verifikueshme, që nuk kërkojnë njohuri specifike teknike, sipas legjislacionit në fuqi;

- miraton modelin e kontratës që lidhet midis përmbaruesit gjyqësor privat dhe palës së interesuar për shitjen e sendeve në ankand publik;

- miraton rregulla të hollësishme për krijimin, mbajtjen dhe administrimin e arkivave, bazuar në legjislacionin në fuqi, pasi merret mendimi i Dhomës.

Sipas ligjit të ri¹⁵³, personit të interesuar për tu certifikuar si përmbarues gjyqësor civil, i janë shtuar kriteret e pranimit. Në ndryshim nga ligji i vitit 2008 individi që kërkon të licenohet si i tillë duhet:

- të ketë përfunduar programin e ciklit të dytë të studimeve universitare për drejtësi brenda vendit, ose diplomë të njësuar me të, apo të ketë përfunduar studimet

¹⁵¹ Neni 12 i Ligjit Nr. 26/2019 “Për shërbimin përmbarimor gjyqësor privat”.

¹⁵² Neni 14 i Ligjit Nr. 26/2019 “Për shërbimin përmbarimor gjyqësor privat”.

¹⁵³ Neni 16 i Ligjit Nr. 26/2019 “Për shërbimin përmbarimor gjyqësor privat”.

universitare për drejtësi jashtë vendit, të njohur dhe njësuar, sipas legjislacionit në fuqi për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë;

- të ketë përfunduar me sukses programin e detyrueshëm 1-vjeçar të trajnimit fillestar pranë Qendrës së Trajnimit;

- të jetë në marrëdhënie pune me kohë të plotë me një përmbarues gjyqësor privat ose zyrë të përmbarimit privat, si ndihmës përmbarues për një periudhë jo më të vogël se 2 vjet, pas kryerjes së trajnimit të detyrueshëm fillestar;

- të mos jetë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë:

i) për një veprë penale të kryer me dashje, për të cilën nuk është rehabilituar;

ii) për një veprë penale të kryer me pakujdesi, për të cilën nuk është rehabilituar dhe që cenon figurën dhe integritetin e profesionit të përmbaruesit gjyqësor privat;

iii) për një veprë penale të kryer me dashje, për të cilën është rehabilituar, kur vepra penale cenon figurën dhe integritetin e profesionit të përmbaruesit gjyqësor privat;- të mos jetë shkarkuar nga ushtrimi i detyrës ose funksionit publik, me vendim të organit kompetent, që ka marrë formë të prerë.

Risi tjetër, e trajtuar dhe si nen¹⁵⁴ më vete është Qendra Kombëtare e Trajnimit të Përmbaruesve. Kjo qendër ngrihet pranë Dhomës dhe është institucioni përgjegjës për trajnimin fillestar dhe vazhdues të përmbaruesve gjyqësorë privatë. Qendra e Trajnimit financohet dhe administrohet nga Dhoma. Ajo ofron programet e trajnimit fillestar për kandidatët për përmbarues gjyqësor privat, si dhe programet e trajnimit vazhdues për përmbaruesit gjyqësorë privatë. Qendra e Trajnimit mund të ofrojë edhe kurse trajnimi për juristët që synojnë njohuri profesionale, teorike dhe praktike në fushën e ekzekutimit të detyruar përmbarimor. Tarifat miratohen nga Dhoma.

¹⁵⁴ Neni 17 i Ligjit Nr. 26/2019 “Për shërbimin përmbarimor gjyqësor privat”.

Kandidatët për përmbarues gjyqësor privat, që përmbushin kriteret e parashikuara, të cituara në nenin 16, të këtij ligji, kanë të drejtë të marrin pjesë në provimin e pranimit në trajnimin fillestar, ai që kalon me sukses provimin e pranimit në programin e trajnimit fillestar pranohet për të ndjekur programin e detyrueshëm 1-vjeçar për trajnimin fillestar pranë Qendrës së Trajnimit.¹⁵⁵

Ndihmëspërmbarues¹⁵⁶ regjistrohet pranë ministrisë, kandidati që ka kaluar me sukses trajnimin fillestar dhe përmbush kriteret e nenit 16 të këtij ligji. Ndihmëspërmbaruesi kryhen veprimtarinë duke u punësuar pranë një përmbaruesi gjyqësor privat të licencuar ose një zyre të përmbarimit privat, që ushtron veprimtarinë në mënyrë aktive. Ndihmëspërmbaruesi nuk mund të jetë bashkëshort ose i afërt deri në shkallë të dytë të përmbaruesit gjyqësor pranë të cilit punësohet.

Përmbaruesit gjyqësorë privatë kanë të drejtë të pranojnë jo më shumë se një ndihmëspërmbarues, ndërsa zyrat e përmbarimit privat mund të pranojnë jo më shumë se një ndihmëspërmbarues për çdo përmbarues gjyqësor privat që vepron pranë zyrës. Ndihmëspërmbaruesi, me kërkesë të përmbaruesit gjyqësor privat, mbështet dhe asiston me aktivitetet administrative të veprimtarisë përmbarimore, por nuk mund të kryejë procedura që lidhen me ekzekutimin.

¹⁵⁵ Neni 18 i Ligjit Nr. 26/2019 “Për shërbimin përmbarimor gjyqësor privat”.

¹⁵⁶ Neni 19 i Ligjit Nr. 26/2019 “Për shërbimin përmbarimor gjyqësor privat”.

Provimi i kualifikimit¹⁵⁷ për përmbaues gjyqësor privat planifikohet për zhvillim bazuar mbi kërkesat dhe nevojat publike për numrin e tyre, sipas parashikimeve të nenit 9, me urdhër të ministrit. Gjithashtu për provimin e kualifikimit janë shtuar pikat në lidhje me përbërjen e komisionit, mënyrën e organizimit të testit dhe minimumi i rezultateve për tu shpallur fitues.

Tjetër risi e ligjit është Programi i Detyrueshëm i Trajnimit Vazhdues¹⁵⁸, të cilin e ndjekin përmbauesit dhe ndihmëspërmbauesit, pranë Qendrës së Trajnimit. Neni 23, plotësohet përveç parashikimit në ligjin e mëparshëm për Regjistrin e përmbauesve gjyqësorë privatë dhe me Regjistrin Unik i të dhënave për zyrat përmbaimore dhe përmbauesit gjyqësorë privatë.¹⁵⁹

Në zhvillim çdo ditë e më shumë të teknologjisë ligji i 2019 është plotësuar me nenin e Sistemit të menaxhimit elektronik të çështjeve të përmbaimit gjyqësor.¹⁶⁰

Pezullimi i veprimtarisë së përmbauesit gjyqësor në ndryshim nga ligji i vjetër, në ligjin e 2019 mund të kryhet me kërkesën e tij dhe ta kalojë në statusin pasiv për arsyt e mëposhtme:

a) për shkaqe shëndetësore, të provuara nga vërtetimi i gjendjes shëndetësore, sipas legjislacionit në fuqi;

¹⁵⁷ Neni 20 i Ligjit Nr. 26/2019 “Për shërbimin përmbaimit gjyqësor privat”.

¹⁵⁸ Neni 22 i Ligjit Nr. 26/2019 “Për shërbimin përmbaimit gjyqësor privat”.

¹⁵⁹ Neni 23 i Ligjit Nr. 26/2019 “Për shërbimin përmbaimit gjyqësor privat”.

¹⁶⁰ Neni 24 i Ligjit Nr. 26/2019 “Për shërbimin përmbaimit gjyqësor privat”.

- b) përkujdesjes për fëmijën e tij të mitur derisa fëmija të mbushë moshën 3-vjeçare;
- c) zgjedhjes ose emërimit në një funksion publik.¹⁶¹

Organet drejtuese të Dhomës Kombëtare të përmbauesve gjyqësorë privatë janë shtuar duke përcaktuar si strukturë Kryetarin e Dhomës, i cili ka kompetencat e parashikuara në Nenin 35 të ligjit të 2019.

Të drejtat dhe detyrat e përmbauesit janë plotësuar në Nenin 36 dhe 37 të ligjit. Përmbauesit gjyqësor privat në ndryshim me ligjin e 2008, mund të mbajnë veçmas, me qëllim ushtrimin e veprimtarisë profesionale, një llogari bankare për administrimin e aktivitetit tregtar si person fizik ose juridik si dhe shpërblimin dhe pagimin e shpenzimeve për veprimtaritë dytësore të parashikuara në pikën 2, të nenit 2, të këtij ligji. Llogaria bankare e veçantë e përmbauesit gjyqësor privat përdoret vetëm për të mbajtur, transferuar dhe kryer pagesa që realizojnë qarkullimin e vlerave monetare, me të cilat do të paguhen palët kreditore dhe shumat e bartura në këtë llogari do të shfrytëzohen ekskluzivisht për përmbushjen e interesave të tyre në procesin përmbarimor.¹⁶² Gjithashtu neni për llogarinë bankare të përmbauesit plotësohet me mënyrën e administrimit dhe ndarjen e të ardhurave të kreditorëve.

Përmbauesi gjyqësor privat zëvendësues¹⁶³ është një parashikim i ri i ligjit të 2019. Në rastin e heqjes së licencës dhe çregjistrimit nga regjistrat e përmbauesve gjyqësorë privatë, ose në rast se përmbauesi gjyqësor privat nuk mund të përmbushë detyrat e

¹⁶¹ Neni 26 i Ligjit Nr. 26/2019 “Për shërbimin përmbarimor gjyqësor privat”.

¹⁶² Neni 42 i Ligjit Nr. 26/2019 “Për shërbimin përmbarimor gjyqësor privat”

¹⁶³ Neni 48 i Ligjit Nr. 26/2019 “Për shërbimin përmbarimor gjyqësor privat”

tij për shkak të sëmundjes, mungesës ose pezullimit, ministri mund të caktojë një përmbarues gjyqësor privat zëvendësues për një periudhë kohe të caktuar ose të pacaktuar, nga lista e vënë në dispozicion nga Dhoma, sipas parashikimeve të këtij ligji. Të drejtat dhe detyrat e përmbaruesit gjyqësor privat janë të përcaktuara në nenin 49 të ligjit.¹⁶⁴

Përmbaruesi gjyqësor privat ka të drejtë që të kërkojë ndihmën e Policisë së Shtetit, të institucioneve të tjera shtetërore apo subjekteve private, në rastet, kur e çmon të arsyeshme, se veprimet procedurale përmbarimore nuk mund të kryhen pa mbështetjen, ndihmën dhe prezencën e tyre.¹⁶⁵

Përmbaruesi gjyqësor privat përfiton një tarifë suksesi, e cila mund të jetë në formën e një shume të caktuar, një përqindjeje të caktuar mbi vlerën e detyrimit të vjelë ose titullit të ekzekutuar, ose nëpërmjet kombinimit të të dyjave mbi vlerën e detyrimit të ekzekutuar dhe caktohet me marrëveshje mes kreditorit dhe përmbaruesit gjyqësor privat.¹⁶⁶

Veprimtaria e përmbaruesve gjyqësorë privatë apo zyrave të përmbarimit privat kontrollohet nga ministria.¹⁶⁷ Njëkohësisht veprimtaria e tyre mbikëqyret nga Dhoma.¹⁶⁸ Përmbaruesi gjyqësor privat ka detyrimin t'i paraqesë ministrisë dhe

¹⁶⁴ Neni 49 i Ligjit Nr. 26/2019 “Për shërbimin përmbarimor gjyqësor privat”

¹⁶⁵ Neni 54 i Ligjit Nr. 26/2019 “Për shërbimin përmbarimor gjyqësor privat”

¹⁶⁶ Neni 56 i Ligjit Nr. 26/2019 “Për shërbimin përmbarimor gjyqësor privat”

¹⁶⁷ Neni 58 i Ligjit Nr. 26/2019 “Për shërbimin përmbarimor gjyqësor privat”

¹⁶⁸ Neni 59 i Ligjit Nr. 26/2019 “Për shërbimin përmbarimor gjyqësor privat”

Dhomës në formë elektronike një raport vjetor statistikor për veprimtarinë e tij. Raporti përfshin edhe informacion në lidhje me administrimin e llogarisë bankare të veçantë, sipas parashikimeve të nenit 42 të këtij ligji.¹⁶⁹

Procedimi Disiplinor është një kapitull i ri i shtuar në ligjin e ri të 2019, në ndryshim më atë të 2008 ku ishin vetëm 2 nene që e rregullonin. Procedimi disiplinor është detajuar duke përfshirë të gjitha hallkat duke përfshirë fillimin e hetimit disiplinor, ankesat, fillimin e hetimeve kryesisht, bashkimin e hetimeve, pezullimin e tyre, te drejtat e përmbauesit, marrjen në pyetje, dokumentacionin e hetimit, përfundimin e hetimit, Komisionin Disiplinor, të drejtat e palëve gjatë procedimit disiplinor, vendimet e Komisionit Disiplinor për çështjet disiplinore, ekzekutimi i vendimeve dhe regjistri disiplinor.¹⁷⁰

Shkeljet disiplinore janë plotësuar me:

- ushtrimi i praktikave të ndaluara, sipas nenit 38 të këtij ligji;
- moslidhja e marrëveshjes së sigurimit të përgjegjësisë profesionale;
- fshehja me dashje e pengesave ligjore për licencim, sipas nenit 16 të këtij ligji;
- zbatimi i tarifave ose rimbursimeve më të larta ose më të ulëta se niveli i parashikuar me udhëzimin e miratuar për këtë qëllim, ose afrimi i kreditorëve duke zbatuar tarifa më të ulëta në krahasim me nivelin e tarifave të parashikuara në udhëzimin e miratuar për këtë qëllim;

¹⁶⁹ Neni 60 i Ligjit Nr. 26/2019 “Për shërbimin përmbauesor gjyqësor privat”

¹⁷⁰ Neni 61- 83 i Ligjit Nr. 26/2019 “Për shërbimin përmbauesor gjyqësor privat”

- pakujdesi në drejtim të administrimit të zyrës, si pasaktësi në mbajtjen e regjistrave dhe të dokumentacionit;
- tejkalimi i kompetencave të dhëna nga ligji;
- trajtimi i pasurive dhe asetëve në kundërshtim me ligjin ose autorizimin e palëve;
- bërja publike e rrethanave personale, familjare dhe financiare të mësuara gjatë kryerjes së veprimtarisë së përmbauesit gjyqësor privat;
- refuzimi për t'u angazhuar në Programin e Detyrueshëm të Trajnimit Vazhdues pa arsye të përligjura;
- shkelja e detyrave, sipas akteve nënligjore në fuqi;
- punësimi në detyrë publike, administrative ose mbikëqyrëse ose angazhimi në një shoqëri tregtare ose institucion publik ose në veprimtari si noter, avokat, veprimtari tregtare ose ndërmjetësuese ose ushtrimi i profesionit në kundërshtim me reputacionin, integritetin ose paanësinë e përmbauesit gjyqësor privat në kundërshtim me nenet 12 dhe 13 të këtij ligji; - kryerja e transaksioneve të veta në emër të një personi tjetër ose të transaksioneve të një personi tjetër në emër të vet, qenia palë në transaksione, për të cilat vepron edhe si përmbaues gjyqësor privat dhe/ose përvetësimi i asetëve të lëna në ruajtje si pjesë e veprimtarisë së tij si përmbaues gjyqësor privat; o) shkelja e rregullave për krijimin, administrimin dhe ruajtjen e arkivit.¹⁷¹

¹⁷¹ Neni 84 i Ligjit Nr. 26/2019 “Për shërbimin përmbaues gjyqësor privat”

Janë shtuar shkeljet për të cilat jepen masat disiplinore. Masat disiplinore jepen bazuar në natyrën dhe rëndësinë e shkeljes. Për kryerjen e shkeljeve të parashikuara në nenin 84, të këtij ligji, jepen masat disiplinore si më poshtë:

a) për shkeljet si: shkelja në mënyrë të përsëritur që lidhen me ushtrimin e veprimtarisë së përmbaruesit gjyqësor privat dhe/ose shkelja në mënyrë të përsëritur e detyrave të parashikuara në nenin 37 të këtij ligji; mos përmbushja me faj e veprimeve përmbarimore, që kanë cenuar të drejtën e palëve në proces ekzekutimi; shkelja e besimit të palës kontraktuese, nëpërmjet kryerjes së veprimeve korruptive me palën tjetër, për të mos ekzekutuar apo vonuar ekzekutimin e titullit ekzekutiv; ushtrimi i praktikave të ndaluara, sipas nenit 38 të këtij ligji; fshehja me dashje e pengesave ligjore për licencim, sipas nenit 16 të këtij ligji; punësimi në detyrë publike, administrative ose mbikëqyrëse ose angazhimi në një shoqëri tregtare ose institucion publik ose në veprimtari si noter, avokat, veprimtari tregtare ose ndërmjetësuese ose ushtrimi i profesionit në kundërshtim me reputacionin, integritetin ose paaanësinë e përmbaruesit gjyqësor privat në kundërshtim me nenet 12 dhe 13 të këtij ligji; bëhet heqje të licencës dhe çregjistrimin nga regjistrat;

b) për shkeljet si: mosrespektimi i dispozitave të Kodit të Etikës dhe standardeve profesionale së përmbaruesit gjyqësor privat; konflikti i interesit në një procedurë ekzekutive; mosevidentimi në mënyrë të rregullt i të gjitha akteve dhe veprimeve procedurale të kryera gjatë veprimtarisë së ekzekutimit; zbatimi i tarifave ose rimbursimeve më të larta ose më të ulëta se niveli i parashikuar me udhëzimin e miratuar për këtë qëllim, ose afrimi i kreditorëve duke zbatuar tarifa më të ulëta në krahasim me nivelin e tarifave të parashikuara në udhëzimin e miratuar për këtë qëllim; pakujdesi në drejtim të administrimit të zyrës, si pasaktësi në mbajtjen e regjistrave dhe të dokumentacionit; refuzimi për t'u angazhuar në Programin e

Detyrueshëm të Trajnimit Vazhdues pa arsye të përlegjura; shkelja e detyrave, sipas akteve nënligjore në fuqi; shkelja e rregullave për krijimin, administrimin dhe ruajtjen e arkivit me gjobë nga 50 000 deri 200 000 lekë;

c) për shkeljet si: shkelja e kërkesave të këtij ligji për ruajtjen e konfidencialitetit, sigurinë dhe mbrojtjen e të dhënave që merr, si rezultat i ushtrimit të veprimtarisë së vet gjatë procedurës së ekzekutimit; refuzimi për të lejuar strukturat përgjegjëse shtetërore për të ushtruar kontroll ndaj veprimtarisë procedurale të tij dhe refuzimi i pagimit të detyrimit profesional; moslidhja e marrëveshjes së sigurimit të përgjegjësive profesionale; tejkalimi i kompetencave të dhëna nga ligji; trajtimi i pasurive dhe asetëve në kundërshtim me ligjin ose autorizimin e palëve; bërja publike e rrethanave personale, familjare dhe financiare të mësuara gjatë kryerjes së veprimtarisë së përmbaruesit gjyqësor privat; kryerja e transaksioneve të veta në emër të një personi tjetër ose të transaksioneve të një personi tjetër në emër të vet, qenia palë në transaksione, për të cilat vepron përmbarues gjyqësor privat dhe/ose përvetësimi i asetëve të lëna në ruajtje si pjesë e veprimtarisë së tij si përmbarues gjyqësor privat; me pezullim të licencës nga tre muaj deri në dy vjet.

Masat disiplinore jepen brenda 6 muajve nga data e konstatimit të shkeljes, por jo më vonë se 2 vjet nga çasti i kryerjes së saj. Në këtë rast parashkrimi i masës fillon pas afateve të përcaktuara.¹⁷²

¹⁷² Neni 84 i Ligjit Nr. 26/2019 “Për shërbimin përmbarimor gjyqësor privat”

Masat disiplinore kanë pësuar një rritje të shumës së gjobës nga 30000- 50000 ALL që ishin me ligjin e vjetër, në 50000 - 200000 ALL me ligjin e ri. Masat disiplinore jepen brenda 6 muajve nga data e konstatimit të shkeljes, por jo më vonë se 2 vjet nga çasti i kryerjes së saj.

Si konkluzion mund të themi se, masat që janë marrë në kuadër të përditësimit të ligjit për shërbimin përmbartimor kanë një rëndësi të veçantë. Ato përmirësojnë ndjeshëm kuadrin rregullator të funksionimit të këtij shërbimi. Rrisin kontrollin ndaj veprimtarisë së tij, duke i shtuar kompetenca edhe Ministrin në i cili ka të drejtë jo vetëm të mbikëqyrë punën e tij por edhe të marrë masa disiplinore ndaj çdo shkelje.

Me këtë ligj, krijohet për herë të parë një qendër kombëtare trajnimi për këtë shërbim. Kjo do të sjelli rritje të profesionalizmit dhe kualifikimeve të përmbartuesve duke rritur kështu standardet e punës së tyre dhe këtij shërbimi. Në tërësi ky ligj ka si qëllim në vetvete të risë performancën e shërbimit përmbartimor.

Përmbartuesve privat u është dhënë e drejta për kryer edhe shërbime dytësore. Mbi bazën e Urdhrit nr. 136, datë 27.4.2020 “Për miratimin e kodit të etikës profesionale të përmbartuesit gjyqësor privat” është miratuar edhe një Kod Etike, ky fakt rrit ndjeshëm standardet e cilësisë në ushtrimin e profesionit dhe forcim të masave disiplinore në rast të mos përmbushjes së tyre.

Thënë kjo, arrijmë në konkluzionin se ligji i ri për shërbimin përmbarimor privat sjell përmirësime në kuadrin ligjor të sistemit të drejtësisë. Por më e rëndësishmja dhe sfida që vjen pas këtij hapi është implementimi dhe zbatimi i tij. Nga ky aspekt shohim një situatë jo të kënaqshme, pasi ende sot nuk kemi akte nënligjore që detajojnë dhe saktësojnë të drejtat dhe detyrat e përmbaruesit. Mungesa e akteve nënligjore e bëjnë jo funksional ligjin.

Edhe pse në njoftime publike Ministria e Drejtësisë shprehet se ka investuar në zhvillimin e sistemeve elektronike të të dhënave, ende sot nuk kemi të dhëna të sakta dhe databaza të punës së rëndësishme që kryejnë përmbaruesit.

Ligji për përmbaruesit publik mbetet ende i pa azhurnuar dhe nuk shkon paralel me atë të përmbaruesve privat. Ende nuk kemi të dhëna mbi formën e bashkëpunimit të sistemit bankar me shërbimin përmbarimor, raport ky shumë i rëndësishëm për realizimin e punës së tyre.

KREU IV

GJYKATA KUSHTETUESE DHE VENDIMET GJYQËSORE

4.1. Vendimet e Gjykatës Kushtetuese dhe ekzekutimi i vendimeve gjyqësore

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë nuk është pjesë e sistemit të zakonshëm gjyqësor. Ajo është një institucion kushtetues e cila ka si përgjegjësi të zgjidh mosmarrëveshjet që lidhen e parashikimet kushtetuese, bën interpretimin e Kushtetutës, garanton të drejtat dhe liritë themelore si dhe shfuqizon çdo akt normativ që vjen në kundërshtim të saj.¹⁷³

Gjykata Kushtetuese mund të investohet mbi bazën e kërkesës së:

a) Presidentit të Republikës; b) Kryeministrit; c) jo më pak se një të pestës së deputetëve; ç) Avokatit të Popullit; d) Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit; dh) çdo gjykatë, sipas nenit 145, pika 2, të kësaj Kushtetute; e) çdo komisioneri të krijuar me ligj për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të garantuara nga Kushtetuta; ë) Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë; f) organeve të qeverisjes vendore; g) organeve të bashkësive fetare; gj) partive politike; h) organizatave; i) individëve.¹⁷⁴

Pas çdo shqyrtimi gjyqësor, Gjykata Kushtetuese shprehet me vendim.

¹⁷³ Neni 124, pika 1, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, e ndryshuar

¹⁷⁴ Neni 134 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, e ndryshuar

Vendimet e Gjykatës Kushtetuese merren me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të saj.¹⁷⁵ Peshë e votës është e barabartë.

Vendimet e Gjykatës Kushtetuese arsyetohen me shkrim dhe hyjnë në fuqi ditën e botimit të tyre në Fletoren Zyrtare, por ka raste që vetë ajo parashikon ndryshe në vendim. Vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë përfundimtare dhe të formës së prerë.¹⁷⁶ Nga ky përcaktim kushtetues zërthejmë fuqinë detyruese të saj.

Si rregull, vendimet e Gjykatës Kushtetuese nuk kanë fuqi prapavepruese.¹⁷⁷ Megjithatë ligji parashikon rastet përjashtimore të tilla si: (i) vendimet gjyqësore që shfuqizojnë dënimet me karakter penal; (ii) vendimet që interpretojnë Kushtetutën; (iii) vendime që lidhen me pasoja ende të pa ezauruara të aktit normativ të shfuqizuar; (iv) për çështjet në proces të gjykatave derisa vendimet nuk kanë marrë formë të prerë.¹⁷⁸

Vendimet e Gjykatës Kushtetuese kanë karakter *erga omnes*. Kjo nënkupton se vendimi që deklaron si të papajtueshme me Kushtetutën një dispozitë të një ligji apo cenimin e një shkelje të të drejtave themelore të njeriut dhe atë në tërësi ka detyrueshmëri të përgjithshme sepse i përgjithshëm është vetë objekti i tij.

¹⁷⁵ Neni 133.2 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, e ndryshuar

¹⁷⁶ Neni 132, 1 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, e ndryshuar

¹⁷⁷ Neni 134 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, e ndryshuar

¹⁷⁸ Neni 76, 7 Ligj Nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

Gjykata Kushtetuese është shprehur lidhur me vendimet dhe efektet e tyre, se ato përbëjnë detyrim për zbatim për çdo individ, organ i pushtetit shtetëror, autoritet kushtetues apo gjyqësor. Ato përbëjnë jurisprudencë kushtetuese dhe, për rrjedhojë, kanë efektet e forcës së ligjit.

Efekti i detyrueshmërisë i vendimeve të GJK shtrihet jo vetëm në dispozitivin e saj, por edhe në pjesën arsyetuese. Mbi bazën e të doktrinës dhe të jurisprudencës kushtetuese, Gjykata ka mbajtur qëndrimin se: *“Efekti detyrues që pasqyrohet mbi argumentet thelbësore të vendimit të saj përbëjnë edhe një ratio decidendi, eliminimi i të cilave do ta bënte vendimin, në tërësinë e tij, të pakuptimtë. Nga kjo pikëpamje, Gjykata ka theksuar se nga standardi i detyrueshmërisë së zbatimit të vendimmarrjes kushtetuese nuk mund të bëj përjashtim as vet Gjykata Kushtetuese.”*¹⁷⁹

Neni 81 i Ligjit Nr.8577, datë 10.2.2000 (ndryshuar me ligjin nr.99/2016) “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës Së Shqipërisë” përcakton procesin e ekzekutimit të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese.

Sipas përcaktimeve të këtij neni Ekzekutimi i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese sigurohet nga Këshilli i Ministrave me anën e organeve përkatëse të administratës shtetërore.

¹⁷⁹ Vendimet nr. 5, datë 07.02.200; nr.14, datë 03.06.2009; nr. 21, datë 29.04.2010 GJL.

Gjykata Kushtetuese ka në diskrecionin e saj, kur e sheh të arsyeshme në varësi të llojit të vendimit të përcaktojë në pjesën urdhëruese autoritetin që ka për detyrë të kryejë ekzekutimin e vendimit, si dhe vendos për formën e ekzekutimit, afatin kohor, procedurën përkatëse të zbatimit. Gjithashtu në rastet ku GJK vendos papajtueshmërinë e një akti normativ me dispozitat kushtetuese ajo angazhon organet kompetente të plotësojnë vakumin ligjor që krijohet. Moszbatimi ose pengimi i ekzekutimit të vendimit të Gjykatës Kushtetuese dënohet sipas dispozitave përkatëse të Kodit Penal.¹⁸⁰

Në realitetin shqiptar prej vitesh, por edhe sot, hasim rëndom raste të moszekutimit të vendimeve. Kjo cënon të drejtën themelore dhe kushtetuese të individit për një proces të rregullt, por njëherazi edhe vetë parimin e shtetit të së drejtës dhe funksionimin e tij. Këto rregulla duhet të konsiderohet të paprekshme për sa kohë janë të përcaktuar në aktin themeltar të vendit tonë dhe për garantimin e të cilave është krijuar një Gjykatë e posaçme, vendimet e të cilës kanë efekte të një rëndësie të veçantë.¹⁸¹ Fuqia detyruese e vendimeve të saj shtrihet si në pjesën urdhëruese të dispozitivit, ku përcakton shkeljen e rastit konkret që merr në shqyrtim, ashtu dhe në pjesën arsyetuese të tij me një efekt më të gjerë.¹⁸²

¹⁸⁰ Neni 320 dhe 321 i Kodit Penal.

¹⁸¹ V. Bala (Pajo), Punim doktrate, Kontrolli kushtetues në Shqipëri. roli i gjykatës kushtetuese si garante e shtetit të së drejtës dhe të drejtave themelore të njeriut: sfidat, arritjet, perspektiva, Tiranë, 2014, fq.327.

¹⁸² Vendimi nr. 14, datë 03.06.2009 të Gjykatës Kushtetuese të RSH.

Mbi bazën e nenit 131/f të Kushtetutës së RSH, Gjykata Kushtetuese mund të vihet në lëvizje nga individit. Me ndryshimet e fundit të Kushtetutës, individit ndryshe nga më parë që mund të kërkonte në Gjykatë Kushtetuese vetëm cënim të procesit të rregullt ligjor, atij tashmë i ka lindur e drejta t'i drejtohet kësaj gjykate për çdo shkelje apo cenim të të drejtave të të drejtave dhe lirive themelore.¹⁸³

Kjo është një risi e rëndësishme e ndryshimeve të fundit që janë bërë lidhur me kompetencat e GJK, mbi bazën e ligjit nr. 76/2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”. Me këtë parashikim është rritur ndjeshëm gama e shkeljeve për të cilat një individit mund të ankohet në këtë Gjykatë, duke e bërë Gjykatën Kushtetuese një mjet ankimi efektiv në rastet e cënimit të të drejtave të njeriut dhe kjo mund të ndikojë edhe në uljen e numrit të ankimeve të GJEDNJ nga këta individ duke reduktuar kështu edhe faturat e kripura të kësaj të fundit.

Ajo që vlen për tu theksuar në këtë moment është menaxhimi i ankesave dhe organizimi i gjykimeve nga ana e Gjykatës dhe përballimi i një fluksi të cilin nuk e ka pasur më parë në mënyrë që të mos bjerë edhe ajo vetë në shkelje të parimit të gjyqimit brenda një afati të arsyeshëm. Ky institucion dhe vetë pushteti legjislativ duhet të marrin masa për ngritjen e strukturave të mirëfillta dhe mekanizmave të efektshëm për t'i dhënë të gjithë qytetarëve të drejtën për akses në GJK për të kërkuar njohje dhe garantim të të drejtave themelore.

¹⁸³A. Kula, Individit si subjekt që vë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese, Revista shkencore “Kushtetushmëri”, Tiranë, 2018, fq. 4.

Neni 81 i Ligjit Nr.8577, datë 10.2.2000 (ndryshuar me ligjin nr.99/2016) Për Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës Së Shqipërisë përcakton procesin e ekzekutimit të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese. Mekanizmat e përcaktuara në këtë nen duhet të aplikohen në realitet. Gjykata Kushtetuese dhe pushteti legjislativ duhet të marrin të gjitha masat për garantimin e kësaj.

Çdo pushtet qoftë ai legjislativ, ekzekutiv apo gjyqësor kanë mundësi të japin kontributin e tij në realizimin e ekzekutimit të vendimeve të GJK. Vënia në jetë e parashikimeve kushtetuese përmes ekzekutimit të vendimeve të saj do sillte një sukses më tepër në raport edhe me sfidat dhe objektivat që ka vendi ynë lidhur me integrimin në Bashkimin Evropian.

4.2. Jurisprudenca e GJK që ka trajtuar mosekzekutimin e vendimeve të formës së prerë si cënim të procesit të rregullt ligjor

Jurisprudenca e GJK që ka trajtuar mosekzekutimin e vendimeve të formës së prerë si cënim të procesit të rregullt ligjor. Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore të formës së prerë është tashmë një element procedural, i cili trajtohet si pjesë integrale e të drejtës për një proces të rregullt ligjor.

Kjo e drejtë është e njohur shprehimisht nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë si një e drejtë themelore e individit. Në këtë kuptim këtij koncepti i atribuohet jo vetëm një rol i rëndësishëm për realizimin dhe garantimin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut, por rrjedhimisht edhe një ndikim të fuqishëm në funksionimin e sistemit gjyqësor.

Procesi i ekzekutimit të vendimeve të formës së prerë është i mirë përcaktuar në legjislacionin tonë të së drejtës procedurale civile. Por pas ndjekjes së çdo hapi shumë individë e gjejnë veten, me një urdhër ekzekutimi, i cili endet prej kohësh i pa ekzekutuar, duke mos përfituar kështu nga e drejta e tyre e fituar gjyqësisht. Kjo përbën shkelje të procesit të rregullt ligjor.

Neni 42 pika 1 e Kushtetutës e përmend procesin e rregullt ligjor, por pa i dhënë atij, ndonjë kuptim konkret. Megjithatë përkufizimin dhe shtjellimin e konceptit të procesit të rregullt ligjor e jep literatura juridike. Gjithashtu me një peshë të rëndësishme lidhur me këtë të drejtë ka jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese, e cila është indoktrinu

nga jurisprudenca e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut e të Gjykatave Kushtetuese evropiane.

Kujtdo duhet t'i garantohet e drejta për një proces të rregullt ligjor, si një e drejtë themelore e individit. Kushdo që në mbrojtje të interesave të tij, i drejtohet gjykatës, si organi shtetëror më i përshtatshëm dhe efektiv për të realizuar këtë mbrojtje nëpërmjet vendimeve të veta, duhet të përfitoj nga kjo e drejtë dhe ta realizoj atë.

Të gjitha burimet e së drejtës sonë të brendshme që lidhet me procesin e rregullt qartësojnë detyrimin e shtetit shqiptar për të ekzekutuar vendimet e gjykatave që kanë marrë formë të prerë, por kjo nuk ka qenë e mjaftueshme për respektimin e tyre.

Në këto kushte situata mbetet ende pa zgjidhje, por është pikërisht ky momenti në të cilin shteti shqiptar nuk mund të humbas më kohë, po duhet të ndërmarrë të gjitha masat për realizimin e të drejtave dhe në këtë mënyrë do ndikoj në uljen e numrit të ankimeve në Gjykatën e Strasburgut dhe sipas direktivave të kësaj të fundit do realizojë edhe detyrimin tonë për ta bërë Gjykatën Kushtetuese një mjet efektiv garantues të së drejtave.

Gjykata Kushtetuese, në kuadër edhe të rekomandimeve nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ) është vënë në lëvizje dhe ka investuar në zgjidhjen e kësaj problematike nëpërmjet vendimeve të saj, por deri në ç'masë ka shërbyer ky investim. Në këtë kuadër ky kapitull do të analizojë jurisprudencën e tyre duke shtjelluar rastet më tipike që ka sjellë praktika dhe duke analizuar zgjidhjen që i është dhënë kësaj problematike.

Shqyrtimet e çështjeve të mosekzekutimit të vendimeve gjyqësore janë bërë pjesë relativisht vonë në jurisprudencën e GJK. Në një vendim të saj GJEDNJ ndër të tjera parashikoi detyrimin e GJK për trajtuar mosekzekutimin e vendimeve gjyqësore si pjesë e procesit të rregullt ligjor. Bëhet fjalë për vitin 2005 ku kjo gjykatë u investua nga një shoqëri tretarë shqiptare me këtë kërkesë, pasi kishte ezauruar pa sukses edhe GJK të RSH.¹⁸⁴

GJK fillimisht kishte një sërë dilemash në lidhje me këtë kompetencë. Ato lidheshin me natyrën e shqyrtimit që ajo do të bënte si edhe me llojin e vendimit që do të jepte¹⁸⁵

Në ato vite lindën shumë diskutime dhe kishte përplasje të mendimeve të ekspertëve për formën e kontrollit që duhet të ushtronte tashmë GJK, a do mundeshe ajo të shqyrtonte në themel të gjitha veprimet e autoriteteve administrative që kishin kryer shkeljen. Kjo sillte vështirësi edhe nga pikëpamja praktike dhe njëkohësisht zgjeronte hallkat e kontrollit të saj.

Vitet në vijim konsoliduan praktikën e saj lidhur me këto vendime, por problematike mbetet ende fakti se GJK konstaton cenimin e procesit të rregullt ligjor si rrjedhojë e mosekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë brenda një afati të arsyeshëm është një vendim tjetër i formës së prerë, përfundimtar dhe i detyrueshëm

¹⁸⁴ Qufaj & Co sh.p.k kundër Shqipërisë”, 30.03.2005. GJEDNJ

¹⁸⁵ A. Vorpsi, Procesi i rregullt ligjor në Praktikën e Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë, Botimet Maluka, Tiranë 2011, fq. 217.

për zbatim që i jepet kërkuesit, pa u shoqëruar me dëmshpërblim apo urdhërime të tjera.¹⁸⁶

Jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese që prej miratimit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë njeh dhe trajton periodikisht të drejtën për një proces të rregullt ligjor, duke dalë kështu garante në mbrojtjen e kësaj të drejte themelore të individit.

Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore të formës së prerë nuk është konsideruar si pjesë integrale e procesit të rregullt në përputhje me nenin 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ deri vonë, ku në vendimin e GJEDNJ-së, kjo gjykatë u shpreh se: *“Gjykata Kushtetuese është kompetente të shqyrtojë kërkesën e shoqërisë ankuese në lidhje me mosekzekutimin e një vendimi të formës së prerë, si pjesë të juridiksionit të saj për të siguruar të drejtën për një proces të rregullt ligjor.”*¹⁸⁷

Në këtë kuadër, që nga ai moment mosekzekutimi i vendimeve gjyqësore të formës së prerë është bërë pjesë e jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese. Këtu merr një rëndësi të veçantë analiza e një prej vendimeve të Gjykatës Kushtetuese i cili trajton konstatimin e cënimit të procesit të rregullt ligjor, si pasojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë.

¹⁸⁶ A. Vorpsi, Procesi i rregullt ligjor në Praktikën e Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë, Botimet Maluka, Tiranë 2011, fq. 233.

¹⁸⁷ Çështja Qufaj & Co kundër Shqipërisë, par. 40-42 GJEDNJ.

Pas direktivave të dhëna nga GJEDNJ për të marrë në shqyrtim këto raste, në çështjet e mëpasshme Gjykata Kushtetuese aplikoi këtë rregull duke ndryshuar kështu jurisprudencën e saj. Këto ndryshime janë konsoliduar tashmë nga një numër i konsiderueshëm vendimesh të dhëna nga kjo gjykatë.

Vendimi nr.6, datë 31.03.2006 ka qenë vendimi i parë në të cilën Gjykata Kushtetuese çmon se: *“E drejta për të kërkuar ekzekutimin brenda një afati të arsyeshëm të një vendimi të formës së prerë të gjykatës duhet konsideruar si pjesë përbërëse e të drejtës për një proces të rregullt ligjor në kuptim të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.”*¹⁸⁸

Deri në vitin 2006, Gjykata Kushtetuese nuk e konsideronte ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë pjesë të procesit të rregullt ligjor, mbi bazën e neneve 42 të Kushtetutës dhe 6 të KEDNJ. Madje as veten e saj si kompetente për gjykimin e kërkesave për shkelje të këtij parimi, si pasojë e moszekutimit të vendimeve gjyqësore. U desh një vendim i GJEDNJ¹⁸⁹ që të detyronte Shqipërinë që të sillte ndryshime në jurisprudencën e saj.

Vendimi nr.6, datë 31.03.2006 mendoj se ka sjellë risi dhe ka hapur rrugën kësaj praktike në zgjidhjen e një problematike të karakterit ligjor tejet të rëndësishme.

Konkretisht në këtë vendim kërkuesi ka kërkuar konstatimin e cënimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, pasi autoritetet shtetërore nuk kanë zbatuar një vendim gjyqësor të formës së prerë.

¹⁸⁸ Vendimi nr.6, datë 31.03.2006, Gjykata Kushtetuese, fq 5.

¹⁸⁹ Qufaj & Co sh.p.k kundër Shqipërisë”, 30.03.2005. GJEDNJ

Lidhur me këtë rast, Gjykata Kushtetuese pasi e shqyrtoi vendosi se: *“Ndodhemi përpara refuzimit për ekzekutimin e vendimeve të formës së prerë për shkaqe subjektive, pasi Bashkia e Tiranës dhe Zyra e Përmbartimit Tiranë, nuk kanë përmbushur detyrimet ligjore që kanë për vënien në zbatim të një vendimi gjyqësor të formës së prerë, duke mos e kthyer kërkuesin në vendin e mëparshëm të punës dhe nuk e kanë paguar plotësisht për pagën sipas urdhërimeve të vendimeve të lartpërmendura.”*¹⁹⁰

Diçka me rëndësi që është pjesë e këtij vendimi, është se Gjykata Kushtetuese vlerëson se gjykimi për realizimin e një të drejte, si një proces kompleks, në vetvete përbëhet nga dy faza¹⁹¹:

- *Faza e parë, ose gjykimi në kuptimin e ngushtë, ka të bëjë me njohjen ose deklarimin e të drejtës që si rregull përfundon kur vendimi gjyqësor merr formë të prerë. autoritetet publike janë të detyruara të ekzekutojnë vendimet gjyqësore, të cilat fuqi detyruese jo vetëm për palët, por dhe për trashëgimtarët e tyre, për personat që heqin të drejta nga palët, për gjykatën që ka dhënë vendimin dhe për të gjitha gjykatat dhe institucionet e tjera. Sipas nenit 146 të Kushtetutës “Gjykatat i japin vendimet “Në Emër të Republikës”. Ky deklaram kushtetues dëshmon faktin se vendimet e gjykatave janë vlerësuar nga Kushtetuta, si për sa i përket karakterit të tyre ashtu dhe për pasojat që ato sjellin për shtetasit dhe për shoqërinë në tërësi. I gjithë procesi gjyqësor, shpesh herë i vështirë e problematik, nuk do të kishte vlerë në qoftë se nuk do të pasohej nga një proces që lidhet drejtpërsëdrejti me*

¹⁹⁰ Vendimi nr.6, datë 31.03.2006, Gjykata Kushtetuese.

¹⁹¹ Vendimi nr.6, datë 31.03.2006, faqe 4, Gjykata Kushtetuese.

veprimtarinë e organeve të përmbartimit, me ekzekutimin e vendimit ose të realizimit të së drejtës së fituar.

- *Faza e dytë, kur lipset dhe ndërhyrja, qoftë dhe me masa shtrënguese për zbatimin e tij, realizohet ajo që quajmë qëllimi i drejtësisë. Në këtë fazë, e drejta është e sigurt, por kërkohet që ajo të vihet në jetë, qoftë dhe me masa shtrënguese, nëse zbatimi vullnetar nuk jep rezultatet e duhura.*

Duke qenë kështu, gjykimi nuk duhet konceptuar ngushtë vetëm me sigurimin e një vendimi gjyqësor, por me përfundimin e gjithë këtij procesi, sepse një e drejtë e fituar, nëse ajo nuk realizohet nëpërmjet ekzekutimit të vendimit, mbetet pa asnjë vlerë.¹⁹²

Ky vendim paraqet rëndësi të veçantë edhe nga një pikëpamje tjetër që lidhet me kompetencat e Gjykatës Kushtetuese për konstatimin e cënimit të një të drejte themelore nga organet që merren me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Siç shihet, kjo Gjykatë në këtë rast konstaton shkeljen e bërë nga organet përkatëse, të cilat nuk kanë zbatuar, pa shkaqe të përligjura, një vendim të formës së prerë të gjykatës.

Në këto kushte, shohim se Gjykata Kushtetuese, ndërmerr edhe vendime konstatuese apo deklarative, pavarësisht se natyra e vendimeve të saj sipas nenit 132 të Kushtetutës, si rregull, lidhet me të drejtën për të shfuqizuar aktet që shqyrton.

¹⁹² Vendimi nr.6, datë 31.03.2006, faqe 5, Gjykata Kushtetuese.

Pyetja që shtrohet është se, Gjykata Kushtetuese në rastet e konstatimit të shkeljes së të drejtave të individit për shkak mosekzekutimi të vendimeve gjyqësore të formës së prerë nga organet e administratës publike, a e plotëson kriterin e të qenit 'mjet ankimi juridik efektiv' si dhe si do të rregullohen efektet e këtij vendimi?

Mbi bazën e këtij vendimi, Gjykata pohon se mund të japë edhe vendime konstatuese apo deklarative dhe këto vendime kane efekte pavarësisht se nuk janë të natyrës që shfuqizojnë një akt konkret. Gjithashtu ajo shprehet se Gjykata Kushtetuese është një mjet ankimi efektiv¹⁹³ për kërkesa me objekt mosekzekutimin e vendimeve gjyqësore përpara se individi t'i drejtohet GJEDNJ-se dhe se çdo autoritet publik që ka detyrime nga vendimi përkatës, është i detyruar të marrë masat e nevojshme për të ekzekutuar vendimin e formës së prerë sipas Kodit të Procedurës Civile.

Në këtë vendim Gjykata Kushtetuese rithekson jurisprudencën e GJEDNJ, e cila e ka trajtuar gjerësisht këtë argument. Sipas saj: *"...kohëzgjatja e procedurave normalisht llogaritet nga momenti i fillimit të procesit gjyqësor, deri në momentin kur jepet vendimi dhe ekzekutohet ai"*¹⁹⁴, apo *"...faza ekzekutive duhet të llogaritet, pra të konsiderohet si fazë e mëtejshme e të njëjtit proces."*¹⁹⁵

Gjykata Kushtetuese në këtë vendim të saj ka përmendur edhe një rekomandim¹⁹⁶ mbi ekzekutimin e vendimeve administrative dhe gjyqësore nga Komiteti i Ministrave të

¹⁹³ Vendimi nr.6, datë 31.03.2006, faqe 7, Gjykata Kushtetuese.

¹⁹⁴ Giralanci kundër Italisë, 19.02.1999, GJEDNJ

¹⁹⁵ Vakaturro kundër Italisë, 25.05.1991, GJEDNJ

¹⁹⁶ Vendimi nr.6, datë 31.03.2006, faqe 7, Gjykata Kushtetuese.

Këshillit të Evropës, të miratuar më 9 shtator 2003, ku ndër të tjera, rekomandon shtetet anëtare të Këshillit të Evropës që të sigurojnë një autoritet administrativ, të zbatojnë vendimet gjyqësore brenda një kohe të arsyeshme dhe në mënyrë që t'u jepet efekt i plotë këtyre vendimeve, ato duhet të marrin të gjitha masat e nevojshme në përputhje me ligjin.

Në të, rekomandohet gjithashtu, se në rastet e moszbatimit të një vendimi gjyqësor nga një autoritet administrativ, duhet të parashikohet një procedurë e përshtatshme për të mundësuar ekzekutimin e tij, veçanërisht përmes një urdhërimi gjyqësor apo një gjobe detyruese. Është e rëndësishme të theksohet fakti se në këtë dokument rekomandohet që vendimet gjyqësore të gjejnë zbatim domosdo nga funksionarë publikë që janë të ngarkuar me këtë detyrë. Sipas këtij rekomandimi, në rast se ata nuk përmbushin si duhet detyrat e tyre ligjore, ata mund të ngarkohen me përgjegjësi individuale ligjore.

Gjykata Kushtetuese, tashmë ka konsoliduar praktikën e saj duke u shprehur se: *“Ekzekutimi i vendimit përbën një element thelbësor të konceptit të shtetit ligjor e të vetë nocionit të gjyimit të drejtë dhe se asnjë organ shtetëror nuk mund të verë në diskutim drejtësinë e vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Çdo organ shtetëror detyrohet të marrë masat përkatëse për zbatimin e tyre”*.¹⁹⁷

Pas vendimit të saj në vitin 2006 GJK ka shqyrtuar shumë raste me këtë objekt duke marrë në analizë çdo kërkesë të individëve, duke përlogaritur afatet që kërkon çdo

¹⁹⁷ Vendim nr.43, datë 19.12.2007; vendim nr.1, datë 19.1.2009; vendim nr.6, datë 6.3.2009 i GJK.

veprim i organeve të ngarkuara për ekzekutimin e vendimeve si dhe duke vërejtur sjelljen e tyre.¹⁹⁸ Gjykata Kushtetuese vlerëson të pajustificueshme sjelljen e organeve shtetërore në mosveprimin e tyre dhe refuzimin e përmbushjes së detyrimit ligjor kundrejt një vendimi të formës së prerë.

Një aspekt tjetër që analizon GJK është sjellja e Përmbaruesit. Ajo thekson se Përmbaruesi i cili është i ngarkuar nga ligji të finalizojë ekzekutimet e vendimeve, duhet të kryejë me përgjegjësi detyrën e tij, pavarësisht faktit se debitor në këtë rast është një institucion publik. Ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë e kanë detyrim ligjor të gjithë subjektet, qofshin këto privatë apo publikë, duhet të përgjigjen njëjloj”.¹⁹⁹

Qëndrimet e GJK lidhur me këtë të drejtë themelore kanë qenë në përputhje me indikacionet e vazhdueshme të GJEDNJ, e cila ka prej vitesh është munduar t'i rekomandojë shtetit shqiptar se ai duhet t'i garantojë çdo individ të drejtën për pasur akses efektiv në sistemin e drejtësisë, përfshi këtu sistemin gjyqësor dhe atë administrativ, në formë të tillë, që ai jo vetëm të përfitojë nga liritë dhe të drejtat kushtetuese, por të arrijë në një kohë sa më të përshtatshme të përdorë mekanizmat shtetërorë në favor të tij, dhe jo pikërisht këto struktura t'i bëhen pengesë.

¹⁹⁸ A. Vorpsi, Procesi i rregull ligjor në Praktikën e Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë, Botimet Maluka, Tiranë 2011, fq. 221.

¹⁹⁹ Vendim i GJK nr.43/2007.

Gjykata Kushtetuese gjithashtu ka argumentuar se: *“Asnjë organ shtetëror nuk mund të vërë në diskutim drejtësinë e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, por detyrohet të marrë të gjitha masat përkatëse për zbatimin e tyre”*²⁰⁰ dhe se: *“...gjykimi nuk duhet konceptuar ngushtë, vetëm me sigurimin e një vendimi gjyqësor, por me përfundimin e gjithë këtij procesi, sepse një e drejtë e fituar, nëse ajo nuk realizohet nëpërmjet ekzekutimit të vendimit, mbetet pa asnjë vlerë”*.²⁰¹

Në vijim të jurisprudencës së saj Gjykata Kushtetuese ka mbajtur po këto qëndrime në vendimmarrje dhe ka pranuar se mbi bazën e nenit 142/3 individët për realizimin e të drejtave të tyre të fituara gjyqësisht, kanë mundësinë t’i drejtohen një gjykatë kompetente, pra t’i ofrohet një mjet ligjor dhe për këtë ata nuk duhet dhe nuk mundet të qëndrojnë në pritje pa kufi.

Në Vendimin të saj nr. 9/2009, GJK gjykon se veprimet e përmbaruesit janë jo të plota në raport me instrumentet procedural që ligji i ka vënë në dispozicion për garantimin e zbatimit të vendimeve përfundimtare.

Në Vendimin Nr. 8/2010, Gjykata thekson shprehimisht se mungesa e buxhetit të akorduar nuk mund të përdoret si justifikim për vonesa në ekzekutimin e vendimeve, në rastin kur debitori është organ shtetëror, dhe se kjo do të cënonte themelin e asaj të

²⁰⁰ Vendimet të Gjykatës Kushtetuese nr. 6, datë 31.03.2006, Nr. 1, dt. 19.1.2009; nr. 6/2009.

²⁰¹ Vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr. 6, dt. 31.03.2006, nr. 43, dt. 9.12.2007, apo nr. 8, dt. 23.03.2010.

drejte. Shkaqe të arsyeshme për vonesa në ekzekutim mund të kemi në disa rrethana të veçanta, të cilat do të shqyrtohen rast pas rasti nga gjykata, por sidoqoftë ato nuk duhet të çenojnë thelbin e të drejtës së fituar gjyqësisht dhe as të procesit të rregullt ligjor.²⁰² Në këtë vendim ajo vijon se justifikim nuk mundet të jetë as deklarimi i palës debitore se përpjekja është bërë por nuk ka qenë rezultative.

Në vendimin nr. 8, datë 23.03.2010 të Gjykatës Kushtetuese, kjo Gjykatë ka arritur në përfundimin se: *“Kur autoritetet administrative refuzojnë, neglizhojnë ose vonojnë t`i ekzekutojnë këto vendime, garancitë që gëzon një palë e përfshirë në një proces gjyqësor e humbasin qëllimin e tyre.”*

Në vendimin nr. 24, datë 22.04.2014 Gjykata Kushtetuese në interpretim për legjislacionit, ka përcaktuar më së miri edhe aktorët përgjegjës lidhur me procesin e ekzekutimit të vendimeve.

Ajo konsideron palë në këtë proces jo vetëm debitorin, kreditorin dhe gjykatën që ka dhënë vendimin, por edhe organet që kanë si detyrë të realizojnë të gjitha hapat për ekzekutimin e vendimeve. Pra GJK i jep edhe njëherë rëndësi punës së përmbaruesit, duke e përcaktuar si vendimtar në finalizimin me sukses të këtij procesi. Neglizhenca e përmbaruesit, në rast të mos ekzekutimit të vendimeve apo titujve ekzekutiv nga ana e debitorit, duhet ta ngarkojë atë me përgjegjësi të madhe.

²⁰² Vendimet e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, 2010, Shtypshkronja ILAR, f. 122. Si dhe vendimet nr.21, datë 07.04.2014; nr.14, datë 30.03.2015 të Gjykatës Kushtetuese.

Në vendimin nr.15, datë 30.03.2015 të Gjykatës Kushtetuese, kjo gjykatë duke qenë shpesh herë e detyruar të trajtojë në themel hapat procedural të ndjekur nga individë që pretendon se i është shkelur e drejta dhe standardi brenda një afati të arsyeshëm, ajo arrin në përfundimin se kriteri brenda një afati të arsyeshëm lidhet me vlerësimin e kompleksitetit të çështjes për çdo fazë që kalon qytetari dhe për këtë duhet analizuar, përlogaritur dhe vlerësuar objekti i çështjes, rrethanat, sjellja e palëve dhe volumi i provave materiale e shkresore. Sidoqoftë kompleksiteti i çështjes duhet verifikuar në raport të ngushtë me zbatimin e rregullave për një administrim të mirë të drejtësisë, që më pas të nxirret një konkluzion, nëse kemi apo jo shkelje.²⁰³

Si konkluzion mund të themi se, kryesisht në rastet kur debitor është një organ shtetëror, justifikimet për të mos ekzekutuar vendimet gjyqësore, janë nga më të ndryshmet. Por ajo që përbën shkak ligjor janë vetëm ato rrethana që e bëjnë objektivisht të pamundur veprimin e përmbushjes së detyrimit të tyre ligjor. Këto rrethana në çdo rast do të mëren në analizë nga GJK dhe do të vlerësohen gjithmonë në raport me respektimin nga ana e këtyre organeve të rregullave të procesit të rregullt.

GJK në pjesën arsyetuese të vendimeve të saj në mënyrë të vazhdueshme thekson se shteti duhet të përdorë çdo mjet, mekanizëm, strukturë dhe instrument për të vënë në jetë vendimet e gjykatave.

²⁰³ Cravcenko kundër Moldavisë, 15.04.2008, GJEDNJ.

GJK këtë e lidh edhe me të drejtën për të pasur akses në gjykatë dhe me parimin e sigurisë juridike, duke konkluduar se nëse vendimet nuk marrin jetë, çënohet rrjedhimisht e drejta e qytetarëve për t'iu drejtuar gjykatës në mbrojtje të interesave të tyre, çënohet njëkohësisht siguria juridike e individëve kundrejt sistemit të drejtësisë dhe shtetit të së drejtës.

Në vendimin nr. 66 datë 07.11.2016, GJK konstaton se përmbaruesi gjyqësor publik ashtu si dhe ai privat, si subjekt në procesin e ekzekutimit, i ka të gjitha mjetet procedurale që i japin mundësi të realizojnë ekzekutimin e titullit ekzekutiv, por nuk i ka përdorur ato me efikasitet, duke u bërë shkak për mosekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë. Mosekzekutimi i vendimit gjyqësor prej më shumë se 14 vitesh nga momenti që është nxjerrë urdhri i ekzekutimit duhet të kishte sjellë një reagim të Ministrisë së Drejtësisë, si institucion përgjegjës për sa i takon shërbimit përmbarimor. Vetëm kontrolli nëse janë përpiluar aktet procedurale pa u shoqëruar me veprime konkrete dhe të vazhdueshme për ekzekutimin e vendimit gjyqësor nuk mund të konsiderohet i mjaftueshëm nga ana e zyrës së përmbarimit.²⁰⁴

Në vendimin nr. 35 datë 18.04.2017 të GJK, ajo thekson se: *“Neni 523 i KPC-së parashikon detyrimin për bashkëpunim, me kërkesë të përmbaruesit gjyqësor dhe në rast nevojë, të Policisë së Rendit apo të inspektoratit ndërtimor pranë pushtetit vendor dhe të Inspektoratit Kombëtar. Këto organe janë të detyruara të mbështesin përmbaruesin gjyqësor gjatë procedurave të ekzekutimit. Po kështu neni 30 i ligjit nr.8730, datë 18.01.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e shërbimit*

²⁰⁴ Vendim nr. 66 datë 07.11.2016 GJK.

përmbarrimor gjyqësor” thotë: “Përmbarruesi gjyqësor, për kryerjen e detyrave të ngarkuara, bashkëpunon me Policinë e Shtetit, me Policinë Ndërtimore dhe policinë e tjera, me organet e pushtetit vendor dhe prefekturat. Autoritetet publike kanë detyrimin të bashkëpunojnë me përmbarruesit gjyqësor gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre, mbi bazën e përcaktimeve ligjore. Shteti vë në dispozicion të tyre organet e policisë dhe autoritete të tjera të cilat sigurojnë forcën shtrënguese të tij. Për këtë arsye, Gjykata vlerëson se mungesa e mjeteve dhe fuqisë punëtore të përmendura në disa shkresa të Zyrës Përmbarrimore apo edhe kostot financiare, janë thjesht një problem faktik, të cilat nuk duhet të përbëjnë shkak për mosëkzekutimin e vendimit gjyqësor.”²⁰⁵

Nga sa më lart, Gjykata gjen me vend të theksojë domosdoshmërinë e ndërhyrjes dhe të bashkëpunimit të këtyre organeve për të siguruar shmangien e situatave të tilla, të cilat mund të bëhen pengesë në ekzekutimin e vendimeve të formës së prerë.”²⁰⁶

Nëse do flasim për shtet të së drejtës, besimi ndaj autoriteteve të drejtësisë dhe siguria juridike janë ndër komponentët kryesorë për ndërtimin dhe funksionimin e tij, për këto arsye e drejta për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë merr rëndësi të veçantë.

Në vijim të praktikës së saj, GJK ka ri theksuar qëndrimin e saj duke konstatuar shkelje të kushtetutës, mosveprimin e organeve shtetërore apo subjekteve të tjerë debitore, duke përfshirë edhe shërbimin përmbarrimor për të ekzekutuar vendimet

²⁰⁵ Vendim nr. 35 datë 18.04.2017 GJK

²⁰⁶ Po aty.

gjyqësore të formës së prerë dhe i ka konsideruar si përgjegjës kryesor në pengimin e tyre.

Gjithashtu ka analizuar thuajse në çdo vendim rëndësinë e sigurimit të parimit për një proces të rregullt duke e deklaruar veten si mjet efektiv në garantimin e saj. Nga një analizë e jurisprudencës në vite vihet re se një pjesë e konsiderueshme të çështjeve për shqyrtim nga Gjykata Kushtetuese i takojnë trajtimit të cënimit të kësaj të drejte.

Gjatë punës për këtë punim, kam analizuar një numër të konsiderueshëm vendimesh të Gjykatës Kushtetuese me objekt “Konstatimin e cënimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor si pasojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë”, në veçanti për vitet 2016, 2017 dhe 2018.

Për vitet 2012 -2016 janë marrë mbi 10 vendime në favor të individëve, nga GJK ku është konstatuar cënim i së të drejtës kushtetuese për një proces të rregullt, si rezultat i mosekzekutimit të një vendimi të formës së prerë të gjykatës.

Ne vitin 2016 nga 89 vendime që ka lëshuar Gjykata Kushtetuese, 10 prej tyre kanë këtë objekt gjykimi dhe të gjitha pranojnë kërkesën e individit, të cilit i është cënuar e drejta për një proces të rregullt ligjor si pasojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë.

Në vitin 2017 nga 90 vendime, 12 vendime janë me këtë objekt.

Ndërsa në vitin 2018 deri në muajin Maj, i fundit ky për funksionimin e kësaj Gjykate nuk janë shpallur më vendime me objekt konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor si pasojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë. Kjo pasi deri në muajin Maj kjo gjykatë ka nxjerrë vetëm 15 vendime në total dhe më tej, për shkak të mos plotësimit të vendeve vakante që janë hapur, si pasojë e procesit të vetting-ut nuk funksionon më.

4.3. Gjykata Kushtetuese si një mjet ankimi efektiv në lidhje me mosekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë

Një ndër sfidat e këtij punimi është të nxjerrë konkluzion lidhur jo vetëm me rëndësinë e të drejtës për të përfituar nga ekzekutimi i vendimeve por edhe me efektivitetin e mjeteve ligjore në sistemin tonë të drejtësisë për ta garantuar atë.

Gjykata Kushtetuese si aktore kryesore e interpretimit të Kushtetutës e konsideron veten si mjet tepër efektiv, kjo bazuar edhe në rekomandimet e vazhdueshme nga GJEDNJ e KE lidhur me këtë të drejtë.

GJEDNJ në lidhje me këtë çështje, ka theksuar se çdo shtet që ka aderuar në Konventën Evropiane të të drejtave të Njeriut, ka detyrim në zbatim të nenit 13 të Konventës tu garantojë shtetasve të tij mjete ligjore efektive për mbrojtjen e tyre lidhur me shkeljet e të drejtave dhe lirive të parashikuara në Konventë. Pra sipas nenit 13, shteti ynë duhet të sigurojë dhënien e kompetencave një gjykate tek e cila çdo individ të mund të aksesojë për çdo cënim që i bëhet kundrejt të drejtave të tij themelore. Kjo gjykatë gjithashtu duhet të jetë e aftë të marrë vendime të përshtatshme në mënyrë që të individit t'i garantohen këto të drejta.

Në gjykimet e bëra nga GJEDNJ ku është trajtuar neni 13 i Konventës ajo ka përcaktuar se mjete ankimit vendas që të jetë efektiv, duhet të plotësojë këto kritere:

- I. Të realizohet nga një Gjykatë.²⁰⁷
- II. Vendimet e saj të jenë me efekte të plota detyruese.²⁰⁸
- III. Legjislacioni duhet ta parashikojë si mjet ankimimi.²⁰⁹
- IV. Arsyeimi i kësaj gjykate duhet të jetë konform rregullave të Konventës dhe t'i garantojnë shtetasit të drejtën e shkelur.²¹⁰
- V. Kjo gjykatë duhet të shprehet me vendim.²¹¹

Në lidhje me Shqipërinë, GJEDNJ është shprehur se Gjykata Kushtetuese Shqiptare mundet të konsiderohet mjet ankimi efektiv i brendshëm ligjor, për sa i përket gjykimit të kërkesave me objekt shkelje të së drejtës për një proces të rregullt ligjor. Ajo ka theksuar disa herë se ankimi në Gjykatën Kushtetuese duhet shfrytëzuar në lidhje me pretendimet e shkeljeve të nenit 6 të KEDNJ-së.²¹²

Një çështje tjetër me shumë rëndësi për tu marrë në konsideratë në këtë kapitull është kompetenca e GJK për të sanksionuar shpërblim dëmi në procese, ku ajo konstaton shkelje të të drejtës për një proces të rregullt ligjor, për shkak të tejzgjatjes në kohë të gjykimeve, përfshirë këtu edhe procesin e ekzekutimit të tyre.

Që prej vitit 2013, Ministria e Drejtësisë e RSH kishte planifikuar dhe përgatitur një projekt ligj nëpërmjet të cilit do t'i jepte mundësinë GJK të vendoste për një shpërblim financiar në rastet e tejzgjatjes së gjykimeve të proceseve gjyqësore. Për këtë ajo

²⁰⁷ Chahal kundër Mbretërisë së Bashkuar, 15.11.1996 GJEDNJ.

²⁰⁸ Aksoy kundër Turqisë, 18.12.1996; Hasan dhe Chaush kundër Bullgarisë, 26.11.2000 GJEDNJ.

²⁰⁹ Balliu kundër Shqipërisë, 31.11.2005. GJEDNJ

²¹⁰ Soering kundër Mbretërisë së Bashkuar, 07.07.1989 GJEDNJ.

²¹¹ Chahal kundër Mbretërisë së Bashkuar, 15.11.1996. GJEDNJ.

²¹² Balliu kundër Shqipërisë, 09.11.2004; Qufaj & Co kundër Shqipërisë, 30.03.2005; Beshiri dhe të tjerë kundër Shqipërisë, 22.08.2006; Hysi kundër Shqipërisë, 26.02.2008, GJEDNJ.

kishte informuar edhe Komisionerin për të Drejtat e Njeriut në Këshillin e Evropës.²¹³

Për vite me radhë kjo temë është trajtuar gjerësisht, pasi GJK mbi bazën e rekomandimeve të GJEDNJ duhet të përcaktonte edhe dëmshpërblime apo kompensime financiare në shqyrtimin e rasteve me këtë objekt.

Në vendimin nr. 14, datë 10.03.2016 të GJK njëri prej gjyqtarëve në mendimin e pakicës, lidhur me vendimet e GJK, shprehet, se: *“Vendime të tilla kanë natyrë thjesht deklarative dhe formale dhe nuk riparojnë në thelb shkeljen e pretenduar. Ato vetëm konstatojnë shkeljen dhe e deklarojnë atë, por nuk rregullojnë pasojat e ardhura prej saj dhe as nuk i njohin individit, ndaj të cilit konstatohet shkelja, dëmshpërblim, siç parashikohet në sisteme të tjera ligjore.”*

Në vazhden e kësaj dhe në kuadër të Reformës në Drejtësi, vetëm në vitin 2016, u miratuan ndryshimet kushtetuese por edhe ndryshime të tjera në kuadrin ligjor që lidhen me zvarritjet e proceseve gjyqësore.

Ndryshimet e vitit 2016 në ligjin e miratuar me shumicë të cilësuar, Gjykatës Kushtetuese i kanë njohur të drejtën e ankuesit për dëmshpërblim deri në masën 100.000 lekë për çdo vit vonesë për tejzgjatje të procesit, por vetëm për çështjet e zhvilluara në proceset e gjykatave para Gjykatës Kushtetuese.

²¹³ Raport nga Nils Muižnieks Komisioneri për të Drejtat e Njeriut i Këshillit të Evropës, 2013 Link: <https://www.refworld.org/cgi-bin/texis/vtx/remain/opendocpdf.pdf?reldoc=y&docid=53046b9a4>

Ky dëmshpërblim akordohet nga Gjykata Kushtetuese, nëse ajo konstaton se gjykimi para saj është zgjatur tej afatit, pa shkak të arsyeshëm dhe nëse konstatohet se nga tejzgjatja e procesit atij i janë cenuar të drejtat dhe liritë e tij të parashikuara nga Kushtetuta.²¹⁴

Në kuptim të kësaj dispozite GJK ka marrë një kompetencë të re, e cila nuk e kufizon më vetëm në njohjen deklarative të shkeljes, por ka të drejtë edhe të vendosë një sanksion ndëshkues. Në dukje kjo formë është ka sjellë një mekanizëm të rëndësishëm lidhur më rivendosjen e të drejtës për individët por në realitet ky përbën vetëm një dëm moral.

Shpërblimi i dëmit është një e drejtë e cila i garantohet çdo individ i ka pësuar një dëmtim në kuptim të dispozitave të Kodit Civil dhe që përbëhet nga humbja e pësuar nga dëmi dhe të ardhurat që do të përfitoheshin në rast se dëmi nuk do të kishte ndodhur (*“restitutio in integrum”* riparim i plotë i dëmit). Pra që të kemi të bëjmë me një dëmshpërblim duhet të plotësohet disa kushte që caktuara në përlllogaritjen e dëmit dhe kurrsesi të përcaktohet një vlerë apriori nga ligji. E parë në këtë këndvështrim arrijmë në konkluzionin se GJK nuk krijon një garantim të plotë të vënies në vend në thelb të të drejtave të shkelura.

Në kuadër të reformës në drejtësi dhe në përpjekje të rivendosjes në vend të të drejtave të shkelura që individët të përfitonin nga shpërblimi i dëmit i ardhur si pasojë e

²¹⁴ Neni 71/ç, Ligj Nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

te jzgjatjes së proceseve gjyqësore, në vitin 2017 u parashikua një mjet ligjor ankimimi. Me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 38/2017 “Për disa ndryshime në Kodin e Procedurës Civile”, është shtuar kreu X “Mbi gjykimin e kërkesave për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm, përshpejtimin e procedurave dhe shpërblimin e dëmit”.

Dispozitat e këtij kreu përcaktojnë se çfarë do të nënkuptojmë me “afat të arsyeshëm” të procesit edhe me “shpërblim të drejtë” kur kemi të bëjmë me afate paarsyeshme në procedurat e hetimit, gjykimin e çështjeve, si edhe në procedurat e ekzekutimit të vendimeve.²¹⁵

Sipas ndryshimeve të fundit ligjore, mjeti i ri i ankimit do të përshpejtojë proceset e të gjitha niveleve dhe do të garantojë shpërblim të drejtë për ata të cilëve iu është cënuar kjo e drejtë, pra një rezultat të kënaqshëm me qëllim rivendosjen e së drejtave të shkelura për proces të rregullt ligjor. Por si mund ta vërtetojmë një gjë të tillë? Në fakt vetëm koha do dëshmojë nëse këto ndryshime ligjore do të sjellin efektivitet, pasi tregues të saktë mbi zhvillime që mund të sjellin ndryshimet nuk kemi. Përkundrazi në katër vitet e fundit që pas aplikimeve të ndryshimeve nuk kemi ende raste të praktikës që të vërtetojnë rezultatin e tyre.

Një aspekt tjetër që duhet sjellë në vëmendje, është se këto rregullime të reja ligjore nuk kanë efekt prapaveprues për çështjet të cilat janë mbyllur me vendime

²¹⁵ Neni 399/1 i Kodit të Procedurës Civile

përfundimtare në themel në gjykata apo pranë shërbimeve përmbarimore dhe për të cilat kanë kaluar afatet e arsyeshme sipas përcaktimeve në ligj. Ato do të vlejnjë si mjet ligjor vetëm për çështjet që e zhvilluara pas nëntorit të vitit 2017, pranë gjykatave lidhur me pretendimet për afat të paarsyeshëm të procesit ligjor, sipas nenit 6/1 të KEDNJ.

Për pasojë për të gjitha rastet të cilat janë zhvilluar më herët, individët duhet t'i drejtohen GJEDNJ, si i vetmi mjet efektiv që mbron të drejtën kushtetuese për shqyrtimin e çështjeve brenda një afati të arsyeshëm.²¹⁶ Për këtë arsye ende sot gjykimet për cënim të procesit të rregullt ligjor në përputhje me nenin 42 të Kushtetutës, lidhur me kohëzgjatjen e paarsyeshme të gjykimeve nga ana e GJK bëhet krejtësisht jo efektive për shkak se nuk mundësojnë riparimin e shkeljes.

Për gjykimet e këtyre çështjeve Gjykata Kushtetuese mbetet de facto një mjet ankimi joefektiv lidhur me si elementë të duke mos arritur t'i sigurojë kërkuesit dëmshpërblim për të drejtën e shkelur.

Duke marrë shkas nga jurisprudenca GJEDNJ-së, në veçanti për rastet kundër Shqipërisë, vendi unë duhet të nxisë autoritetet të marrin të gjitha masat për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, me objekt konstatimin e cënimit të një procesi të rregullt ligjor dhe t'i sigurojnë individëve rivendosjen e të

²¹⁶ Vendim nr.76, dt.4.12.2017 dhe nr.80, dt.18.12.2017 i Gjykatës Kushtetuese

drejtave të shkelura. Kjo do të sillte ulje të aplikimeve në GJEDNJ dhe rrjedhimisht shmangie të ndëshkimeve financiare të shtetit shqiptar nga ajo.

Nëse do të analizojmë sa më sipër, ende sot mund të themi se nuk kemi një gjykatë të tillë. Pasi vendimet e gjykatës kushtetuese janë deklarative, konstatojnë një shkelje por nuk kanë mundësi të dëmshpërblejnë palët e cenuara. Më ndryshimet e fundit legislative ka një përmirësim në aspektin e zgjerimit të shkeljeve që mund të pretendohen pranë Gjykatës Kushtetuese, si dhe i është dhënë e drejta kësaj të fundit të sanksionojë shpërblim dëmi. Por në analizën që i bëmë formulës së re për një shpërblim të drejtë mund të konkludojmë se as këto ndryshime nuk e bëjnë GJK mjet ankimi efektiv.

Në çështjen Gjyli kundër Shqipërisë, GJEDNJ ka konstatuar se GJK nuk ka qenë një mjet ankimi efektiv në realizimin e të drejtave të gjyqfituesit dhe as për dhënien e një shpërblimi të drejtë.²¹⁷

E drejta për një proces të rregullt ligjor është trajtuar thuajse në çdo element të saj nga jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese përfshirë dhe mosekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë dhe atyre të Gjykatës Kushtetuese.

²¹⁷ Vendim i datës 29.09.2009, para. 39

Si përfundim mund të themi se Gjykata Kushtetuese ka kompetencën të vendosë për çështje me objekt mosekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, si shkelje e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, pasi individit i kanë shteruar të gjitha rrugët e ankimit. Por në praktikë vërejmë se kjo gjykatë mbetet mjet ankimi jo efektiv për gjykimet me objekt mosekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Arsyeya kryesore e këtij konkluzioni aspak të kënaqshëm vjen si pasojë e faktit se vendimmarrja e GJK ende sot nuk na ofron riparim e të drejtave të shkelura.

KREU V

GJYKATA EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT DHE EKZEKUTIMI I VENDIMEVE GJYQËSORE

5.1. Ekzekutimi i vendimeve të GJEDNJ

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut është hartuar nga Këshilli i Evropës²¹⁸ dhe ka hyrë në fuqi me 3 shtator 1953. Duke marrë si burim Deklaratën Universale e të Drejtave të Njeriut të vitit 1948, hartuesit e Konventës u përpoqën të ndiqnin objektivat e Këshillit të Evropës duke ruajtur dhe garantuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut.

KEDNJ është e trupëzuar në Kushtetutën Shqiptare dhe madje në kuptim të disa prej dispozitave të saj, ne mundemi të vërejmë rëndësinë e saj, duke përfiturar dhe vetë një pasqyrim të saj dhe të pozicionit të saj krahasuar me Kushtetutën dhe legjislacionin e brendshëm. Neni 17 i Kushtetutës në paragrafin e dytë të tij pozicionon KEDNJ-në edhe mbi dispozitat të vetë Kushtetutës.

Përveç paraqitjes së një tërësie të drejtash dhe lirish civile dhe politike, Konventa gjithashtu krijoi mekanizma për përmbushjen e detyrimeve që kanë shtetet kontraktuese.

²¹⁸ Këshilli i Evropës (shih: www.coe.int)

Kjo përgjegjësi iu caktua tri institucioneve: Komisioni Evropian për të Drejtat e Njeriut (themeluar me 1954), Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (e themeluar me 1959), dhe Këshilli i Ministrave i Këshillit të Evropës, ku ky i fundit përbëhet nga Ministrat e Punëve të Jashtme të shteteve anëtare apo përfaqësues të tyre.

GJEDNJ²¹⁹ si autoritet që ka kompetencë interpretimin Konventës, luan një rol kyç në ndërtimin e praktikave gjyqësore të brendshme, në veçanti për Gjykatën Kushtetuese, në përputhje me standardet e KEDNJ.

Vendimet e GJEDNJ kanë një efekt *erga omnes* në nivel kombëtar, sepse vërtet vendimi është *inter partes*, por për raste të njëjta, jo domosdoshmërisht shteti shqiptar duhet të ndjekë të njëjtin rrugëtim dhe çështja të përfundojë me gjobitjen e tij, prandaj ky i fundit duhet të marrë në konsideratë efektet e vendimit për rastet e njëjta.²²⁰

Ekzekutimi i një vendimi të dhënë nga një gjykatë duhet të konsiderohet si një pjesë integrale e ‘grykimit’ për qëllimet e nenit 6, pra e drejta e ekzekutimit rrjedh nga ‘parimi i sundimit të ligjit’.

²¹⁹ GJEDNJ përbëhet nga një numër gjykatësish të barabartë të Shteteve Kontraktuese. Gjykatësit janë zgjedhur për një mandate prej 9 vitesh nga Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës dhe nuk mund të rizgjidhen. Gjatë mandatit të tyre Gjykatësit nuk do të angazhohen në asnjë aktivitet tjetër, i cili nuk është në përputhje me pavarësinë e tyre, paanshmërinë, apo me kërkesat për të punuar me orar të plotë.

²²⁰ Ma. I. Barjamaj, Ekzekutimi i detyrueshëm i vendimeve gjyqësore dhe problematika e praktikës gjyqësore, Disertacion, Tiranë 2016, fq. 144.

Për ekzistencën e një mekanizmi për mbrojtjen e të drejtave themelore, mund t'i referohemi në veçanti detyrimin të ekzekutimit efektiv të vendimeve të GJEDNJ. Ky fakt do dëshmonte themelet e një demokracie të shëndetshme në një shoqëri të caktuar.

Nëpërmjet analizës së skemës ekzistuese të ekzekutimit të vendimeve të Gjykatës Evropiane, synohet të dalin në pah detyrimet e shteteve për ekzekutimin e vendimeve dhe masat që ndërmarrin këto të fundit në këtë kuadër.

Komiteti i Ministrave është autoriteti i cili ka si detyrë të mbikëqyr ekzekutimin e vendimeve të GJEDNJ-së. Shtetet që kanë aderuar janë përgjegjëse për zbatimin rigoroz të Konventës brenda juridiksionit të tyre dhe me monitorimin e Komitetit të Ministrave. Përveç kësaj, Gjykata dhe Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës kanë kapacitetin për të ndikuar në procesin e ekzekutimit.

Shtetet kur janë pjesë e proceseve gjyqësore të GJEDNJ, kanë detyrimin t'i binden vendimit përfundimtar të saj. Vendimi përfundimtar i kalon Komitetit të Ministrave, i cili mbikëqyr ekzekutimin e tij. Përmbyllet nga shteti debitor, përmbillet kur Komiteti i Ministrave merr një rezolutë përfundimtare për mbylljen e çështjes.

Në zbatim të nenit 46/1²²¹ të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, shtetet janë të detyruara për ekzekutimin e vendimeve të GJEDNJ, dhe detyrimi i tyre do të

²²¹ Neni 46/1 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, në të cilën parashikohet detyrimi ligjor i shteteve për të ekzekutuar vendimin e GJEDNJ.

zbatohet duke ndërprerë menjëherë veprimin e paligjshëm, duke rivendosur të drejtën e shkelur dhe duke mos përsëritur të tilla dëme në të ardhmen. Për të realizuar këto detyrime shtetet kontraktuale kanë përgjegjësi dy dimensionale, nga njëra anë ato duhet të ndërmarrin masa individuale dhe nga ana tjetër masa të përgjithshme.

Masat individuale janë ato masa të cilat lidhen më së shumti me objektin konkret të gjykimit dhe me rivendosjen në vend të të drejtave të shkelura.

Masat individuale përfshijnë një sërë veprimesh:

Së pari është detyrimi i shtetit të ndërpresë shkeljen ndaj palës kërkuese dhe vazhdimësinë e saj;

Së dyti përmbushja e detyrimit për t'i siguruar palës kërkuese rivendosjen rivendosjen në vend të të drejtave të shkelura (*restitutio in integrum*).²²²

Dhe së treti marrja e masave për të parandaluar këtë kategori shkeljesh në të ardhmen, në lidhje me individë të tjerë apo raste të ngjashme. Ky detyrim duhet të përmbushet duke ndërhyrë në legjislacionin e brendshëm në mënyrë që të mos jetë mundësia e përsëritjes.

Komiteti i Ministrave në bashkëpunim me Gjykatën i bën thirrje vazhdimisht shteteve për të zbatuar rishikimin e procedurës, apo të miratojnë ligje të reja për të mundësuar ndryshimin e procedimit. Gjithashtu si masë individuale shteteve mund t'i kërkohet edhe që të rishikojnë, ndryshojnë ose të lëshojnë urdhra administrative, si në rastin

²²² Brumarescu kundër Rumanisë, 23.01.2001, GJEDNJ.

‘Rodrigues Da Silva dhe Hoogkamer kundër Holandës’, ku shteti i pajis me leje qëndrimi pasi u konstatua cenim i nenit 8 të Konventës.

Në rastet kur detyrimi ndaj një shteti i vendosur nga GJEDNJ nuk mund të ekzekutohet për arsye objektive të vetë rrethanave apo natyrës së të drejtës që është cënuar atëherë shteti do të kompesojë detyrimin e tij më një shumë të caktuar të hollash që i përshtatet masës së dëmit të pësuar, pra në asnjë rast shteti nuk përjashtohet nga përgjegjësia për të zbatuar vendimet e GJEDNJ.

Detyrimi i shteteve për të kompensuar të dëmtuarin me një shumë të hollash, parashikuar në nenin 41 të Konventës, përdoret nga GJEDNJ edhe si sanksionon për të ndëshkuar shtetet. Këto janë mekanizmat e saj për të realizuar mbrojtjen dhe garantimin e të drejtave dhe lirive themelore.

Çdo shtet detyrohet të ekzekutojë shpërblimin e dëmit, por ka të drejtë të përcaktojë vetë mënyrën e shlyerjes. Një formë tjetër është edhe kompesimi me një pronë që ka një vlerë të barabartë dhe përputhet me dëmin e pësuar.

Në mënyrë që shtetet të arrijnë të plotësojnë të gjitha kriteret për zbatimin e Konventës, për çdo rast që gjykohet nga GJK dhe GJEDNJ, me objekt cënimin e parimit të procesit të rregullt apo shkelje të të drejtave e lirive të tjera, duhet të shqyrtojnë në mënyrë të detajuar arsyet e shkeljes. Të tilla masa lidhen më së shumti me predispozicionin e

shteteve për të përmirësuar situatën e krijuar nga shkelja dhe kjo kushtëzon disi efektin e drejtë për drejtë.

Nëse GJEDNJ do të arrijë në përfundimin se ka shkelje të Konventës, shtetet detyrohet të zbatojnë vendimin e saj dhe të marrin të gjitha hapat e nevojshme për realizimin e masave individuale dhe atyre të përgjithshme. Shtetet kanë lirinë të zgjedhin mjetet më të përshtatshme, që ato shohin të arsyeshme për të zbatuar vendimin, në çdo rast me mbikëqyrje nga Komitetit të Ministrave. Mundësitë e çdo shteti për realizimin sa më të përshtatshëm të masave janë vendimtare për garantimin e KEDNJ.

Masat e përgjithshme zakonisht janë reformat në drejtësi ose investim në jurisprudencën vendase. Këtu përmendim rastet kundër Shqipërisë²²³, ku autoriteteve të brendshme u është kërkuar miratimi i legjislacionit të nevojshëm dhe marrja e të gjitha masave, që bëjnë të mundur ekzekutimin e vendimeve gjyqësore apo administrative.

GJEDNJ ka të drejtë të vendosë edhe afate për plotësimin dhe përmbushjen e detyrimeve të shteteve. Në rast se gjykata identifikon një mangësi në legjislacion apo mekanizëm të caktuar, ajo del me një vendim ‘Pilot’ dhe shteti detyrohet të sigurojnë gjithashtu një zgjidhje efektive të brendshme për rastet analoge.

²²³ “Ramadhi kundër Shqipërisë”, 27.11.2007, “Beshiri kundër Shqipërisë”, 22.08.2006, “Qufaj & Co sh.p.k kundër Shqipërisë”, 30 05.2005, GJEDNJ.

Ndërsa në rastin kur shkelja ka ardhur si pasojë e keqinterpretimit të ligjit nga ana e gjykatave kombëtare, një modifikim në jurisprudencën gjyqësore mund të jetë një formë funksionale në zbatim të vendimit.

Gjithsesi personalisht mendoj se jurisprudenca e GJK, përpos investimit të saj lidhur me konstatimet e shkeljeve të tilla, interpretimin e dispozitave të Kushtetutës lidhur me to dhe argumenteve që arsyetojnë shkeljet, nuk arrin të riparojë dëmet e ardhura si pasojë e këtyre shkeljeve tek individët. Kjo e bën GJK një mjet jo efektiv për garantimin e të drejtave të Konventës.

Në tjetër çështje që vlen të theksohet është se njohja me vendimet e GJEDNJ të autoriteteve përkatëse dhe të publikut në përgjithësi në praktikë ka sjellë efikasitet.

Pas një rekomandimi²²⁴ dhe një rezolutë²²⁵ e Komitetit të Ministrave për publikimin dhe shpërndarjen e vendimeve të Gjykatës, bënë që shtetet të inkurajohen për të siguruar se jurisprudenca përkatëse e kësaj gjykate të botohet sa më parë dhe gjerësisht në gjuhën përkatëse duke ia shpërndarë strukturave shtetërore.

Shtetet kontraktuese kanë marrë përsipër të respektojnë vendimet e GJEDNJ-së në çdo çështje ku ato janë palë, përmes integritit të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe protokolleve shtesë të saj në legjislacionin e brendshëm. Është një detyrim që rrjedh nga neni 46 i KEDNJ-së. Kjo dispozitë parashikon fuqinë ligjore të

²²⁴<https://wcd.coe.int/ViewDoc.jsp?id=331657&Sector=secCM&Language=lanEnglish&Ver=original>

²²⁵[https://wcd.coe.int/ViewDoc.jsp?Ref=Rec\(2004\)4&Sector=secCM&Language=lanEnglish&Ver=original](https://wcd.coe.int/ViewDoc.jsp?Ref=Rec(2004)4&Sector=secCM&Language=lanEnglish&Ver=original)

vendimeve, formën e ekzekutimit të tyre, si dhe Komitetit e Ministrave si autoritet përgjegjës për kontrollin e këtij procesi.

Komiteti i Ministrave ka publikuar në vitin 2009, ndër të tjera edhe ecurinë lidhur me ekzekutimin e vendimeve të caktuara të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, nga vendi ynë. Ky akt pati si fokus kryesor të tij procedimet civile të tejzgjatura dhe mungesën e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Komiteti ka si qëllim të nxisë shtetet që të identifikojnë dhe përcaktojnë një mekanizëm të posaçëm që të ngarkohet me përgjegjësinë e mbikëqyrjes së procesit të ekzekutimit të vendimeve.

GJEDNJ në mënyrë të vazhdueshme inkurajon pasurimin e jurisprudencës së GJK, në të gjitha rastet kur palët nuk kanë marrë vendime përfundimtare brenda një kohe të arsyeshme, në mënyrë që të sigurohet përshpejtimi i procedurave.

Komiteti i Ministrave, në rezolutën e ndërmjetme të vitit 2013, u bëri thirrje autoriteteve publike shqiptare që të hartonin me prioritet maksimal një plan veprimi. Ky plan që do të jepte mundësinë e krijimit të një mekanizmi kompensimi efektiv brenda një periudhe 18 mujore, duke mbajtur parasysh edhe masat e identifikuaratashmë brenda afateve të vendosura nga Gjykata.

Miratimi i kësaj rezolute të ndërmjetme, erdhi si shkak i mos realizimit të një plani veprimi të përditësuar dhe të plotë në lidhje me ekzekutimin e vendimeve, nga ana e

autoriteteve publike shqiptare, plan të cilin kishin detyrim për ta paraqitur. Kjo erdhi si pasojë e faktit se për një periudhë të gjatë kohore, më shumë se tre-vjeçare, shteti nuk ndërmori ndonjë hap të rëndësishëm për ekzekutimin e rreth gjysmës e këtyre vendimeve, ku përfshihej edhe hartimi i një plani veprimi në lidhje me ekzekutimin e vendimeve.

Shqipëria ratifikoi Protokollin e 16-të të Konventës “Për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore”, me ligjin nr.48 datë 07.05.2015, i cili parashikon një formë për komunikimin ndërmjet gjykatave kombëtare dhe GJEDNJ. Ky mekanizëm do të përmirësonte bashkëveprimin midis Gjykatës dhe strukturave shtetërore vendase për zbatimin e Konventës, në përputhje me parimin e subsidiaritetit.

Më synimin e përmirësimit të situatës lidhur me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore, si element thelbësor në funksionimin e shtetit të së drejtës, janë realizuar edhe projekte të ndryshme, si psh. projekti “Eliminimi i pengesave për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore vendase/Sigurimi i zbatimit efektiv të vendimeve të gjykatave vendase” (Janar 2009).²²⁶

Të tilla iniciativa, projekte e aktivitete lidhen ngushtësisht, dhe shërbejnë për të përmirësuar punën e Komitetit të Ministrave, në misionin e mbikëqyrjes së ekzekutimit të vendimeve të GJEDNJ.

²²⁶ <https://www.coe.int/sq/web/tirana/excecution-of-echr-s-decisions>

Shteti Shqiptar në kuadër të ekzekutimit të vendimeve të GJEDNJ, ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm, një fakt i tillë konstatohet edhe nga jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese.

Në mbledhjen datë 19 shtator 2018, Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës, miratoi Rezolutën për Shqipërinë, me konkluzionin se mekanizmi i ri i kompensimit të pronave, parashikuar me ligjin 133/2015 është plotësisht funksional dhe efektiv.

Ligji mori fuqi gjatë vitit 2016 dhe plani i veprimit vijoi deri në vitin 2018. Në këtë kuadër Komiteti i Ministrave vendosi të miratojë rezolutën për mbylljen e procesit të mbikëqyrjes së masave të përgjithshme për grupin e çështjeve që lidhen me kompensimin e pronave, duke përfshirë këtu dhe planin e masave të vendimit pilot të Manushaqe Puto e të tjerë kundër Shqipërisë.²²⁷

Ministria e Drejtësisë shprehet se: *“Shqipëria i ka përmbushur të gjitha detyrimet të adresuara nga vendimi Pilot sipas këndvështrimit të Komitetit të Ministrave, duke ngritur një skemë të brendshme të efektive për kompensimin e pronave të shpronësuara. Madje ligji shërbeu edhe për 16 raste të tjera që kishin aplikuar lidhur me këtë çështje.”*

Nëpërmjet kësaj zgjidhjeje, Komiteti i Ministrave ka vendosur se, Shqipëria i ka dhënë fund mungesës së gjatë të një mekanizmi efektiv si dhe është vlerësuar mbështetja

²²⁷<http://www.drejtesia.gov.al/newsroom/lajme/njoftim-per-mediat-keshilli-i-evropes-konfirmon-sifunksional-dhe-efektiv-mekanizmin-e-kompensimit-te-prones-te-miratuar-nga-qeveria-shqiptare/>

politike, financiare dhe teknike që është dhënë nga qeveria shqiptare që nga viti 2014 e në vazhdim.²²⁸

Vendimi i marrë nga Komiteti i Ministrave, tregon se Shqipëria i ka vënë në zbatim të gjitha masat e vendosura nga Gjykata Evropiane dhe Komiteti i Ministrave, duke vendosur të mos ushtrojë më mbikëqyrjen e kësaj çështje.

Komiteti i Ministrave, vlerëson angazhimin konkret të Qeverisë në përmbushjen e detyrimeve të vendimeve të Gjykatës Evropiane, si dhe në masat konkrete që ka marrë për të garantuar zbatimin e vendimeve të formës së prerë të gjykatave vendase.

Ministria e Drejtësisë shprehet se në këtë mënyrë Shqipëria zgjidh përfundimisht pas 25 vitesh, problemin e madh të kompensimit të pronave, duke pasur një formulë kompensimi për pronarët dhe një mekanizëm ligjor efektiv që lejon që pronarët të dëmshpërblehen, mekanizëm i pranuar dhe i certifikuar tashmë edhe me këtë vendim të Komitetit të Ministrave.²²⁹

Gjithsesi vendi ynë në projektplanin kombëtar për integrimin evropian 2020 – 2022, thekson se do të vijojnë reformat janë në fushën e të drejtave të pronësisë si dhe në plani i veprimit për zbatimin e vendimeve gjyqësore të GJEDNJ-së për kthimin dhe kompensimin e pronës.²³⁰

²²⁸<http://www.drejtesia.gov.al/newsroom/lajme/njoftim-per-mediat-keshilli-i-evropes-konfirmon-sifunksional-dhe-efektiv-mekanizmin-e-kompensimit-te-prones-te-miratuar-nga-qeveria-shqiptare/>

²²⁹<http://www.drejtesia.gov.al/newsroom/lajme/njoftim-per-mediat-keshilli-i-evropes-konfirmon-sifunksional-dhe-efektiv-mekanizmin-e-kompensimit-te-prones-te-miratuar-nga-qeveria-shqiptare/>

²³⁰ Projektplani kombëtar për integrimin evropian 2020 – 2022, RSH, fq.20.

Ndonëse shteti ynë ka realizuar një sërë masash veprimi për ekzekutimin e vendimeve të GJEDNJ, përpjekjet duhet të vazhdojnë, përgjegjësia duhet të rritët, jo vetëm kundrejt strukturave ndërkombëtare por edhe në raport me vetë popullin shqiptar.

Gjithashtu mund të themi se përpos ekzekutimit të vendimeve konkrete GJEDNJ, shteti shqiptar duhet të angazhohet më shumë në rritjen e efektivitetit të mjeteve ligjore kombëtare dhe të marrë të gjitha masat për ekzekutimin e çdo vendimi gjyqësor që merr formë të prerë. Një ndër aspektet themelore të shtetit të së drejtës është edhe parimi i sigurisë juridike. Ky parim kërkon mbi të gjitha që kur gjykatat për një çështje të caktuar japin një vendim të formës së prerë, ky vendim nuk duhet të vihet në dyshim.²³¹

²³¹ Wildhaber, 2006, GJEDNJ, nr 31.

5.2. Ekzekutimi i vendimeve të GJEDNJ në RSH

Ekzekutimi i vendimeve të GJEDNJ në RSH ka qenë prej vitesh një sfidë për vendin tonë. Në mënyrë të vazhdueshme GJEDNJ ka orientuar Republikën e Shqipërisë në investimin nëpërmjet kapaciteteve, strukturave dhe mekanizmave konkret dhe efektiv për ekzekutimin e vendimeve të saj, jo vetëm për të realizuar kështu detyrimet që lindnin nga hyrja në fuqi e tyre, por kjo do të vlente edhe për garantimin e Konventës ndaj qytetarëve shqiptarë.

Risia kryesore që vjen, në lidhje me këtë argument është miratimi i Ligjit Nr. 86/2018 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10 018, datë 13.11.2008, “Për Avokaturën e Shtetit”. Ky ligj, referuar edhe Strategjisë së Reformës në drejtësi kishte si qëllim pikërisht ngritjen e një mekanizmi kombëtar efektiv për ekzekutimin e vendimeve të GJEDNJ. Ligji përcakton mënyrën se si shteti ynë do realizojë masat e përgjithshme rregullatore ose unifikuese të praktikës.

Ndryshimet në ligjin “Për avokaturën e shtetit” dhe shtimi i një Kreu te ri me 10 nene specifike, të cilat përcaktojnë në mënyrë të detajuar të gjitha procedurat për ekzekutimin e vendimeve të GJEDNJ në Shqipëri, janë një reflektim i sugjerimeve të ardhura nga ekspertët e misionit EURALIUS dhe nga Këshilli i Evropës.

Ky ligj i jep për herë të parë, Avokaturës së Shtetit një rol shumë të rëndësishëm në iniciimin e procedurave të ekzekutimit të vendimeve të GJEDNJ-së dhe mbikëqyrjen

e ekzekutimit të këtyre vendimeve. Ligji parashikon gjithashtu veprimet që duhet të kryhen nga çdo institucion përgjegjës për ekzekutimin, afatet procedurale të bashkëpunimit ndërinstitucional, dhe rolin monitorues të Kuvendit, me qëllim përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga KEDNJ për ekzekutimin e vendimeve të gjykatës në përputhje me afatet e caktuara prej saj.²³²

Kreu i ri parashikon në mënyrë konkrete dhe të detajuara:

1. procedurën për ekzekutimin e vendimeve të GJEDNJ-së, me qëllim rritjen e efikasitetit dhe efektivitetit;
2. rolin e Avokaturës së Shtetit, në cilësinë e institucionit kompetent për iniciimin e procedurave të ekzekutimit të vendimeve të GJEDNJ-së dhe mbikëqyrjen e ekzekutimit të këtyre vendimeve;
3. përcaktimin e detyrave të secilit institucion përgjegjës për ekzekutimin e vendimeve të formës së prerë të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut duke parashikuar në këtë aspekt edhe afate specifike veprimi nga secili institucion;
4. procedurën e kryerjes së pagesës për vendimet e GJEDNJ-s që parashikojnë kompensime financiare duke siguruar një mekanizëm efektiv, që parandalon vonesat dhe burokracitë në procedurën e ekzekutimit;
5. parashikimin e llojeve të masave parandaluese që duhet të ndërmerren nga autoritetet kombëtare në rastin e konstatimit të shkeljeve të Konventës;

²³² Raport për projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.10018, datë 13.11.2008, “Për Avokaturën e Shtetit”, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut Dokument Parlamentar, Kuvendi, Tiranë, 2018, fq 7.

6. ngritjen e një Këshilli Konsultativ, që do të asistojë Avokaturën e Shtetit në përmbushjen e rolit të saj si propozuese e masave të përgjithshme parandaluese;
7. rolin monitorues të Kuvendit të Shqipërisë në procesin e ekzekutimit të vendimeve të GJEDNJ.²³³

Sipas këtij Ligji Avokatura e Shtetit, në cilësinë e përfaqësuesit dhe mbrojtësit të interesave pasurorë të shtetit shqiptar pranë GJEDNJ-së, është institucioni kompetent për nisjen e procedurave të ekzekutimit të vendimeve të GJEDNJ-së.²³⁴

Me marrjen e dijani mbi vendimin e formës së prerë, Avokatura e Shtetit brenda 10 ditëve pune, përcjell vendimin përkatës për përkthim dhe certifikim pranë Ministrisë së Drejtësisë. Ministria e Drejtësisë, brenda 15 ditëve pune nga data e depozitimit të kërkesës së Avokaturës së Shtetit, dërgon vendimin e përkthyer dhe certifikuar për publikim në Qendrën e Botime Zyrtare, si dhe pranë Avokaturës së Shtetit, me qëllim ndjekjen e procedurave të mëtejshme të ekzekutimit të vendimit të GJEDNJ-së. Një kopje e vendimit origjinal dhe një kopje e përkthyer dhe certifikuar nga Ministria e Drejtësisë, dërgohet nga Avokatura e Shtetit pranë Gjykatës Kushtetuese, Gjykatës së Lartë dhe në institucioneve të tjera të për efekt të zbatimit të njëjësuar të praktikës gjyqësore. Brenda 5 ditëve pune, nga dërgimi i vendimit të përkthyer nga Ministria e Drejtësisë, Avokatura e Shtetit paraqet kërkesën pranë Kryeministrit për propozimin e projektvendimit të Këshillit të Ministrave, në lidhje me ekzekutimin e vendimit të

²³³ Raport për projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.10018, datë 13.11.2008, “Për Avokaturën e Shtetit”, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut Dokument Parlamentar, Kuvendi, Tiranë, 2018, fq 6.

²³⁴ Neni 19/1, pika 2, i Ligjit nr. 10 018, datë 13.11.2008, “Për Avokaturën e Shtetit”, i ndryshuar.

GJEDNJ-së. Vendimi i Këshillit të Ministrave miratohet brenda 30 ditëve pune nga paraqitja e kërkesës së Avokaturës së Shtetit.²³⁵

Avokatura e Shtetit është përgjegjëse për koordinimin e procesit të ekzekutimit, hartimin e planeve të veprimit dhe të raporteve, përfaqësimin përpara Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës, si dhe monitorimin e procesit të ekzekutimit të vendimeve të GJEDNJ-së, nga autoritetet kombëtare. Avokatura e Shtetit informon Këshillin e Ministrave në rastet kur konstaton se procesi i ekzekutimit është vështirësuar, apo është ndërprerë dhe mund t'i shkaktohet dëm financiar shtetit.²³⁶

Vendimet e GJEDNJ-së që kanë vendosur kompensimin e drejtë, ekzekutohen nga institucionet përkatëse, sipas fushës së tyre të përgjegjësisë, brenda 3 muajve nga momenti kur vendimi i gjykatës merr formën e prerë.²³⁷

Detyrimet financiare që burojnë nga vendimet e GJEDNJ-së mbulohen nga buxheti i shtetit, sipas përcaktimeve të parashikuara në vendimin e Këshillit të Ministrave për ekzekutimin e vendimit të GJEDNJ-së. Përjashtimisht, për detyrimet financiare deri në 10000 (dhjetëmijë) euro, pagesa ekzekutohet në mënyrë të drejtpërdrejtë nga Ministria e Financave pas njoftimit nga Avokatura e Shtetit. Në rast të moskryerjes së pagesës brenda afateve kohore, mbi masën e detyrimeve përkatëse financiare paguhet interesi, sipas përcaktimeve në vendimin e GJEDNJ-së. Brenda 10 ditëve pune, nga

²³⁵ Neni 19/2 i Ligjit nr. 10 018, datë 13.11.2008, "Për Avokaturën e Shtetit", i ndryshuar.

²³⁶ Neni 19/3 i Ligjit nr. 10 018, datë 13.11.2008, "Për Avokaturën e Shtetit", i ndryshuar.

²³⁷ Neni 19/4 i Ligjit nr. 10 018, datë 13.11.2008, "Për Avokaturën e Shtetit", i ndryshuar.

miratimi i vendimit të Këshillit të Ministrave, apo i marrjes së njoftimit nga Avokatura e Shtetit, sipas rastit, Ministria e Financave publikon listën e subjekteve përfitues dhe kërkesën për dorëzimin e dokumentacionit të nevojshëm, për shpërndarjen e fondit përkatës. Në rastet kur pala e interesuar brenda 30 ditëve pune, nuk dorëzon dokumentacionin e kërkuar, Ministria e Financave transferon pagesën në një llogari të veçantë depozitimi për kërkuesin, e cila qëndron e ngurtësuar derisa të përmbushen procedurat e parashikuara me ligj, por jo më shumë se 6 muaj nga data e depozitimit, me përjashtim të rasteve kur kërkuesi provon se ka një proces gjyqësor ose administrativ të hapur, i cili e pengon në respektimin e këtij afati. Në përfundim të këtij afati, fondet kalojnë në buxhetin e shtetit.²³⁸

Krahas pagesës së kompensimit mund të merren masa shtesë, me qëllim rivendosjen në vend të të drejtave e shkelura. Këto masa përfshijnë veprime të cilat mund të ndërmerren nga Avokatura e Shtetit së bashku me institucionet përgjegjëse për të rikthyer sa më shumë të jetë e mundur, statusin që mbante kërkuesi përpara cenimit të të drejtave të tij/saj (*restitutio in integrum*).

Institucionet përgjegjëse për ekzekutimin e vendimit të GJEDNJ-së, jo më vonë se një muaj nga momenti kur ngarkohen për ekzekutimin e vendimit të gjykatë njoftojnë, Avokaturën e Shtetit, lidhur me faktin nëse: a) ekzekutimi do të kryhet brenda afateve ligjore; b) procesi i ekzekutimit është bllokuar, duke shpjeguar arsyet, si dhe duke marrë masa institucionale për ekzekutimin e vendimit; c) procesi i ekzekutimit nuk ka filluar ose nuk mund të fillojë, duke sqaruar arsyet përkatëse.²³⁹

²³⁸ Neni 19/5 i Ligjit nr. 10 018, datë 13.11.2008, “Për Avokaturën e Shtetit”, i ndryshuar.

²³⁹ Neni 19/6 i Ligjit nr. 10 018, datë 13.11.2008, “Për Avokaturën e Shtetit”, i ndryshuar.

Lidhur me masat e përgjithshme Avokatura e Shtetit ka të drejtën të sugjerojë masa të përgjithshme parandaluese, në lidhje me ndryshimet e nevojshme të legjislacionit apo praktikave, të cilat mund të shkaktojnë dëm financiar për shtetin si rezultat i shkeljes së Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, të cilat përfshijnë: a) ndryshime në legjislacionin në fuqi, apo praktikën e zbatimit të tij; b) ndryshime në praktikën administrative; c) propozime të cilat duhet të merren në konsideratë gjatë hartimit të ligjeve; ç) trajnime profesionale për Konventën dhe praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut për profesionistët në fushën e ligjit; si dhe d) masa të tjera të përshtatshme, në përputhje me sugjerimet e Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës. dh) institucionet përgjegjëse për zbatimin e masave. Institucionet përgjegjëse për zbatimin e masave, në çdo rast detyrohen të njoftojnë Avokaturën e Shtetit, lidhur me marrjen në konsideratë të sugjerimeve të saj dhe arsyet përkatëse mbi mënyrën e zbatimit të tyre.²⁴⁰

Avokatura e Shtetit, në kuadër të përmbushjes së detyrimeve konsultohet me Këshillin Konsultativ për çështjet e GJEDNJ. Këshilli Konsultativ përbëhet nga 5 anëtarë të emëruar nga Kryeministri, me propozim të Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit, ndërmjet juristëve me përvojë dhe të njohur në ushtrimin e funksioneve e veprimtarive profesionale juridike. Anëtarët e Këshillit Konsultativ për çështjet e GJEDNJ ushtrojnë këtë funksion për një periudhë 2 vjeçare me të drejtë riemërimi. Përbërja, mënyra e funksionimit, detyrat, afatet dhe shpërblimi përcaktohen me urdhër të Kryeministrit. Në varësi të natyrës së çështjes dhe nevojave që lindin, në përbërje të

²⁴⁰ Neni 19/7 i Ligjit nr. 10 018, datë 13.11.2008, “Për Avokaturën e Shtetit”, i ndryshuar.

këtij organi mund të caktohen dhe ekspertë të pavarur, shpërblimi të cilëve bëhet sipas legjislacionit në fuqi.²⁴¹

Avokati i Përgjithshëm i Shtetit paraqet raport të paktën një herë në vit përpara komisionit të përhershëm për çështjet ligjore, administratën publike dhe të drejtat e njeriut të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, mbi ekzekutimin e vendimeve të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe masat e ndërmarra në këtë drejtim.²⁴²

Mosmarrja e masave për ekzekutimin e vendimeve të GJEDNJ-s ose ekzekutimi i tyre jo në përputhje, nga zyrtarët e ngarkuar për kryerjen e tyre, përbën shkak për fillimin e ecurisë disiplinore sipas legjislacionit në fuqi.²⁴³

Si konkluzion mund të themi se dispozitat ligjore që ndryshojnë ligjin për Avokaturën e Shtetit, objektivisht rregullojnë në mënyrë të mirë përcaktuar ekzekutimin e vendimeve të GJEDNJ në vendin tonë. Përmbyllja e detyrimeve që burojnë nga Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut ka qenë prej vitesh një sfidë dhe objektivë shumë e rëndësishme për garantimin e të drejtave themelore. Ky hap gjykoj se është vendimtar në përmirësimin e situatës në realizimin e këtij qëllimi.

Bazuar në konkluzionet e Dokumentit Analitik të Reformës në Sistemin e Drejtësisë, objektivave të përcaktuar në planin e Veprimit për Reformën e Sistemit të Drejtësisë, por edhe në kuadrin ligjor në fuqi, vlerësohet se ndryshimi në mënyrën e organizimit

²⁴¹ Neni 19/8 i Ligjit nr. 10 018, datë 13.11.2008, “Për Avokaturën e Shtetit”, i ndryshuar.

²⁴² Neni 19/9 i Ligjit nr. 10 018, datë 13.11.2008, “Për Avokaturën e Shtetit”, i ndryshuar.

²⁴³ Neni 19/10 i Ligjit nr. 10 018, datë 13.11.2008, “Për Avokaturën e Shtetit”, i ndryshuar.

të Avokaturës së Shtetit, për sa i takon varësisë institucionale të tij do të ndikojë në shkurtimin e hallkave të panevojshme dhe që vonojnë proceset e Avokaturës së Shtetit duke ndikuar në zgjidhjen e problematikave të cilat janë vërejtur në veprimtarinë e këtij institucioni dhe në rezultatet e tij në kuadër të mbrojtjes së interesave pasurorë të shtetit, në veçanti në procedurat e propozimit të projektvendimeve për ekzekutimin e vendimeve të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Risia me e rëndësishme e këtij ligji është se në këtë mënyrë do të shmangen pasojat financiare në buxhetin e shtetit, që lindin nga vonesat në ekzekutimin e vendimeve të GJEDNJ.

5.3. Jurisprudenca e GJEDNJ në lidhje me ekzekutimin e vendimeve

Në bazë dhe për zbatim të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, dhe direktivave të dhëna nga GJEDNJ dhe KE, Shqipëria ka detyrim ligjor për të ndërmarrë masa që të ekzekutojë vendimet e brendshme të formës së prerë dhe për të siguruar mjete ankimi efektive, në rast të mos ekzekutimit të këtyre vendimeve.

GJEDNJ, në jurisprudencën e saj të vazhdueshme, e ka konsideruar pjesë integrale të nenit 6/1 të KEDNJ-së, të drejtën për të kërkuar ekzekutimin e një vendimi gjyqësor të formës së prerë.

Në vendimin ‘Qufaj & Co ShPK kundër Shqipërisë’ në vitin 2004-2005, GJEDNJ ka trajtuar problematikën e mos ekzekutimit të vendimeve gjyqësore në RSH. Ky është vendimi i parë i marrë nga kjo Gjykatë ndaj Shqipërisë, i cili ka të bëjë me ekzekutimin e një vendimi gjyqësor.

Kjo shoqëri tregtare u ankua fillimisht në Gjykatën Kushtetuese pasi vendimi i formës së prerë në favor të saj nuk u ekzekutua. GJK e rrëzoi kërkesën me argumentin se ekzekutimi i vendimeve gjyqësore ishte përtej kompetencës së saj.

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut deklaroi se shteti shqiptar ka shkelur Konventën, duke mos garantuar ekzekutimin e vendimit, pjesë përbërëse e procesit gjyqësor.

GJEDNJ paraqiti direktivën se: *“...sistemi gjyqësor duhet të ofrojë mjete ligjore efektive të brendshme për të ankimuar një shkelje të së drejtës për një gjykim të drejtë, mundësi kjo që teorikisht ishte në dispozicion të shoqërisë ankuese.”*²⁴⁴ Shoqëria u përpoq pa sukses ta shfrytëzonte këtë mjet, por Gjykata Kushtetuese e rrëzoi kërkesën e saj.

Në fakt në çështjen e njohur ‘Horsby kundër Greqisë’, datë 19 mars 1997, nr. 107/1995/613/701, Gjykata e Strasburgut kishte theksuar se *“...e drejta për një proces të rregullt ligjor do të mbetet një funksion, nëse kuadri ligjor i brendshëm do të lejonte që një vendim i formës së prerë të mbetet i pa u ekzekutuar, duke shkaktuar një dëm njëerës prej palëve në proces.”*

Në çështjen ‘Vukelić kundër Malit të Zi’ Gjykata ripohon se zbatimi i vendimeve gjyqësore përfundimtare mbrohet nga neni 6.1 i Konventës, dhe shtetet, të cilat kanë si parim bazë të ndërtimit të tyre ‘sundimin e ligjit’ nuk mund të qëndrojnë pasiv duke dëmtuar kështu njëerën prej palëve.

Për këto arsye, ekzekutimi i një vendimi gjyqësor nuk mund të pengohet, shfuqizohet, ose shtyhet padrejtësisht.²⁴⁵ Shteti ka detyrimin që të ndërtojë një sistem efektiv për ekzekutimin e vendimeve të formës së prerë, si nga pikëpamja e kuadrit ligjor, ashtu edhe nga pikëpamja praktike.

²⁴⁴ Çështja Qufaj & Co kundër Shqipërisë, 30.03.2005. para. 40-42. GJEDNJ.

²⁴⁵ Çështja nr. 58258/09, 4.06.2013, GJEDNJ.

Gjykata gjithashtu konstaton se: *“...pavarësisht nëse zbatimi duhet të kryhet kundër një subjekti privat apo shtetëror, shteti duhet të ndërmarrë të gjitha hapat e nevojshëm, në kuadër të kompetencave të tij, për arritur në ekzekutimin e një vendimi gjyqësor të formës së prerë dhe, duke vepruar kështu, për të siguruar pjesëmarrjen efektive të të gjithë aparatit të tij. Në të kundërt, shteti është në shkelje për mos përmbushje të kërkesave sipas Nenit 6§1 ... Megjithatë, moszbatimi i një vendimi, për shkak të mos pagesës së debitorit, nuk mund t'i ngarkohet paaftësisë së shtetit, përveç rasteve dhe në masën që situata shkaktohet nga autoritetet vendase, siç mund të jetë, për shembull, rasti i gabimeve ose vonesës së shkaktuar prej tyre në procesin e përmbarrimit ... Së fundmi, Gjykata përsërit se procedurat e ekzekutimit, nisur për nga vetë natyra e tyre, duhet të trajtohen me shpejtësi”*.

Në çështjen ‘Zyfli kundër Shqipërisë’, gjykata ka mbajtur qëndrimin se: *“rregulli i shterimit të mjeteve të brendshme juridike të përmendura në Nenin 35.1 të Konventës e detyron ankuesit që të përdorë mjete juridike që janë normalisht të disponueshme dhe të mjaftueshme në gjykatat vendase. E drejta për kompensim, brenda kuptimit të paragrafit 5, lind nëse autoritetet ose gjykatat e brendshme shkelin të paktën një ndër paragrafët e mësipërm të Nenit 5 të Konventës.”*²⁴⁶

Në çështjen ‘Bajrami kundër Shqipërisë’²⁴⁷, kërkuuesi parashtroi se vajza e tij ishte marrë nga nëna në shtetin Grek, pa pëlqimin e tij. Në vitin 2004 nëpërmjet Gjykatës së Qarkut Vlorë, ai kishte zgjidhur martesën duke marrë edhe kujdestarinë e fëmijës.

²⁴⁶ Çështja nr.12310/04, 27.09.2005, GJEDNJ.

²⁴⁷ Bajrami kundër Shqipërisë, 35853/04, 18.12. 2007, par.65 dhe 66, GJEDNJ.

Ky vendim nuk u ekzekutua asnjëherë, pasi fëmija nuk ishte në Shqipëri. Këtë argument përdori përmbaruesi gjatë përpjekjeve të dështuara për ta ekzekutuar vendimin.

Në këtë rast GJEDNJ vërejti se Shqipëria nuk i kishte miratuar akte shumë të rëndësishme lidhur me ribashkimin e prindërve me fëmijët e tyre, përfshirë këtu edhe Konventën e Hagës të vitit 1980 për aspektet e të drejtave prindërore.

Në çështjen Driza kundër Shqipërisë²⁴⁸, GJEDNJ shqyrtoi një rast në të cilin konstatoi se vendi ynë nuk kishte ekzekutuar për më tepër se gjashtë vite një vendim të formës së prerë të Gjykatës së Lartë. Ajo deklaroi se shteti nuk kishte shpjeguar arsyen e kësaj vonese.

Vendimi në favor të palës ankuese ishte dhënë mbi bazën e Ligjit për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave. Ekzekutimi i vendimeve të kësaj natyre u konsiderua urgjente nga GJEDNJ.

Ajo ka theksuar se pamjaftueshmëria e fondeve shtetërore nuk është një argument që mund të justifikojë një mosveprim të tillë, madje e ka përmendur Shqipërinë disa herë për dështimin në ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë.

²⁴⁸ Çështja nr. 33771/02, 13.11.2007, GJEDNJ.

Të njëjtin qëndrim GJEDNJ ka mbajtur edhe në një çështje të më passhme, ‘Nuri kundër Shqipërisë’²⁴⁹.

Në 31 korrik 2012, GJEDNJ nxjerr vendimin pilot lidhur me çështjen ‘Manushaqe Puto dhe të tjerë kundër Shqipërisë’²⁵⁰ Gjykata për këtë rast ndërmori një masë më të rreptë duke aplikuar procedurën për vendimet Pilot, për arsye se autoritetet kishin dështuar në ekzekutimin e një numri të konsiderueshëm vendimesh që lidhen me këtë problematikë.

Objektivi i procedurës së aplikimit të vendimit Pilot është nxitja e shtetit si palë e paditur, të zgjidhë tërësinë e çështjeve që rridhnin nga i njëjti problem strukturor në nivel të brendshëm. Për zgjidhje sa më të përshtatshme të kësaj situatë gjykata rekomandoi autoritetet vendase të përdornin forma alternative të “kompensimit”, të parashikuara në ligjin përkatës, çka do të ulte ngarkesën në buxhet.

E nxitur nga kjo iniciativë e GJEDNJ shteti shqiptar ndërmori masat e përshtatshme dhe në vitin 2018 arriti të përmbushë detyrimet e veta lidhur me këtë argument.

Në çështjen ‘Topallaj kundër Shqipërisë’, GJEDNJ më datë 21 prillit 2016 vendos se ka mungesë të mjeteve efektiv në lidhje me kohëzgjatjen e procedurave si dhe në çështjen ‘Sharrxhi dhe të tjerët kundër Shqipërisë,’ vendim i datës 11 Janar 2018,

²⁴⁹ Nuri kundër Shqipërisë, 12306/04, 03.02.2009, GJEDNJ, para 38.

²⁵⁰ Manushaqe Puto dhe të tjerë kundër Shqipërisë, 604/07, 31.07.2012, GJEDNJ.

GJEDNJ rithekson se vendi ynë ende nuk ka një mjet afektiv për shkeljen e së drejtës për një proces të rregullt lidhur me ekzekutimin e vendimeve të formës së prerë.

Tejzgjatja në ekzekutimin e një vendimi është e pa justifikueshme, në rastin kur ajo shkel thelbin e së drejtës së mbrojtur në kuptim të nenit 6.1 të Konventës. Është pikërisht GJEDNJ e cila ka kontribuar në zgjidhjen e kësaj problematike nëpërmjet jurisprudencës të saj, ndaj shteteve të tjera fillimisht, e më pas edhe ndaj Shqipërisë.

Siç shihet ekzekutimi i vendimeve ka qenë objekt gjykimi në mënyrë të vazhdueshme në GJEDNJ. Ajo ka investuar gjerësisht në trajtimin e kësaj të drejte dhe i ka treguar edhe Gjykatës tonë kushtetuese rrugën e drejtë për të arritur mbrojtjen e kësaj të drejte.

Jurisprudenca e GJEDNJ ka luajtur një rol kyç në hartimin dhe përmirësimin e kuadrit ligjor në vendin tonë, pasi me shumëllojshmërinë e vendimeve të saj lidhur me ankesat që ka marrë në shqyrtim, ajo nxjerr në pah një sërë problematikash të sistemit ligjor. Problematika që lidhen me drejtme të ndryshme përfshirë legjisllacionin, mjetet ligjore efektive për rivendosjen e të drejtave të shkelura dhe mosekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë si pasojë direkte e pasivitetit të autoriteteve shtetërore të ngarkuara për zbatimin e ligjit.

Në tre vitet e fundit vihet re një trend i qëndrueshëm i ankesave në GJEDNJ, konkretisht 95 kërkesa në vitin 2017, 98 në vitin 2018 dhe 88 në vitin 2019. Nga

këto në vitin 2017 nuk është pranuar asnjë rast, në vitin 2018 janë pranuar 9 raste dhe vetëm një rast në vitin 2019. Nga këto, vetëm një rast në 2018, u pranua për mosekzekutim të vendimit përfundimtar.

Më poshtë gjendet tabela me dhënat e publikuara nga GJEDNJ:

Tabela nr. 1 Aplikimet dhe gjykimet e rasteve të Shqipërisë në GJEDNJ

Situata e aplikimeve	2017	2018	2019
Aplikime	95	98	98
Të kaluara për dijëni shtetit	11	17	16
Aplikime që i është dhënë rrugë ligjore	56	54	58
Të rrëzuara (Gjyqtar i vetëm)	47	28	43
Të rrëzuara (Kolegj)	9	0	4
Të rrëzuara (Dhoma)	0	17	0
Të gjykuara	0	9	1
Me objekt mosekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë		1	

Sipas të dhënave të publikuara nga GJEDNJ aplikimet në pritje janë:

Tabela nr. 2 Aplikimet e rasteve të Shqipërisë në GJEDNJ në pritje

Aplikimet në pritje më 01/01/2020	
Aplikime gjithsej në pritje	616
Gjyqtar i vetëm	7
Komiteti (3 Gjyqtarë)	299
Dhoma (7 Gjyqtarë)	304
Dhoma e Madhe (17 Gjyqtarë)	0

Për sa më sipër, mund të themi roli i GJEDNJ është vendimtar në nxitjen e sigurimit të gjetjeve dhe zgjidhjeve sa më efektive lidhur me shkeljet që i bëhen Konventës, edhe pse shpesh herë ajo është një reflektim jo i bukur i realitetit tonë dhe të legjislacionit jo funksional.

KREU VI

SITUATA E RESPEKTIMIT TË TË DREJTAVE TË NJERIUT NË SHQIPËRI NË KUADËR TË VENDIMEVE GJYQËSORE

(RAPORTE DHE STATISTIKA)

6.1. Situata e respektimit të të drejtave të njeriut në Shqipëri në kuadër të vendimeve gjyqësore (Raporte dhe statistika)

Na zbatim të politikave të Bashkimit Evropian për zgjerimin dhe arritjen e negociatave, Kapitulli 23, përfshin: "*Politikat e BE-së në fushën e gjyqësorit dhe të të drejtave themelore, të cilat synojnë të ruajnë dhe zhvillojnë më tej Bashkimin si një fushë të lirisë, sigurisë dhe drejtësisë. Krijimi i një gjyqësori të pavarur dhe efikas ka një rëndësi të madhe. Paanshmëria, integriteti dhe standardi i lartë i gjykimit nga ana e gjykatave janë thelbësore për ruajtjen e sundimit të ligjit.*"

E gjithë kjo kërkon një angazhim tepër serioz në konsolidimin e një pushteti gjyqësor duke investuar nëpërmjet financimit të plotë dhe trajnimeve të herë pas hershme. Në lidhje me këtë argument, rëndësi të veçantë ka ndërtimi dhe konsolidimi i garancive ligjore për një proces të rregullt ligjor.

Njëkohësisht, Shtetet anëtare por edhe ato që janë në proces të aderimit, duhet të luftojnë në mënyrë efektive korrupsionin, pasi ky fenomen përbën një kërcënim për qëndrueshmërinë e institucioneve demokratike dhe shtetin e së drejtës.

Miratimi i një kornize ligjore të konsoliduar dhe garantimi i zbatimit të tyre nga institucione të besueshme janë një nevojë e domosdoshme. Shtetet anëtare kanë detyrimin të sigurojnë respektimin dhe garantimin e të drejtave themelore.²⁵¹

Përmirësimi i situatës të të drejtave të njeriut në Shqipëri nëpërmjet forcimit të shtetit të së drejtës në përmbushje të misionit të tij, ka vijuar punën në drejtim të respektimit dhe mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të njeriut në vendin tonë.

Lidhur me procesin e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë, mbi bazë dhe për zbatim të normave juridike kushtetuese dhe të KEDNJ janë hartuar dhe miratuar janë miratuar një sërë aktesh ligjore dhe nënligjore. Këto akte përmbajnë në mënyrë të detajuar formën e realizimit të këtij procesi, organet përgjegjëse dhe përgjegjësitë e tyre. Këtu mund të përmendim, Kodin Civil, Kodin Penal, Kodin e Procedurës Civile, Kodin e Procedurës Penale, Ligjin për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe mosmarrëveshjeve administrative, Ligjin nr. 8730, datë 18.01.2011, “Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit të Përmbartimit Gjyqësor”, Ligjin 26/2019 “Për Shërbimin Përmbartimor Gjyqësor Privat” etj. Të gjitha autoritetet shtetërore kanë detyrimin të bashkëpunojnë me Shërbimin e Përmbartimit Gjyqësor gjatë procesit të ekzekutimit të vendimeve gjyqësore dhe titujve të tjerë ekzekutiv.²⁵²

²⁵¹ https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/policy/conditions-membership/chapters-of-the-acquis_en

²⁵² Raport vjetor për veprimtarinë e institucionit të Avokatit të popullit, Viti 2019, fq. 56.

Shërbimi përbarimor gjyqësor ka si parime të funksionimit të tij parimin e ligjshmërisë dhe respektimin e të drejtave dhe lirive të garantuara nga ligji, i çdo subjekti që merr pjesë në ekzekutim.

Nga analiza që i bëhet procesit të ekzekutimit të vendimeve gjyqësore civile, vitet e fundin shihet një qëndrueshmëri e situatës. Problematikat vijojnë dhe mbeten pengesë për realizimin e kësaj të drejte themelore. Për të realizuar këtë analizë të situatës aktuale lidhur me respektimin e të drejtave themelore të njeriut, do të paraqes në vijim përmbledhje të rezultateve të nxjerra nga struktura të rëndësishme kombëtare dhe ndërkombëtare të cilat janë dhe vetë aktorë apo dëshmitarë të problematikave dhe pasojave që ato sjellin në gjithë sistemin e drejtësisë në vend.

6.1.1. Analiza të raporteve nga autoritete kombëtare lidhur me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore në RSH

Raportet zakonisht prekin më së shumti problematikat e moszekutimit të vendimeve, me palë debitore shtetin për të nxjerrë njëherazi edhe faturat e këtij të fundit që sjellin pasoja serioze dhe aspak premtuese për misionin që shteti ynë ka lidhur me rrugëtimin e tij drejt familjes evropiane. Mosekzekutimi i vendimeve gjyqësore reflekton mosfunksionim të mirë të strukturave përgjegjëse, neglizhencë të autoriteteve shtetërore si dhe mungesë të besimit nga ana e qytetarëve ndaj pushtetit gjyqësor.

Një nga raportet që do të analizohet në vijim është Raporti vjetor për veprimtarinë e institucionit të Avokatit të popullit, viti 2019. Avokati i popullit mbron të drejtat, liritë dhe interesat e ligjshme të individit nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike, si dhe të tretëve që veprojnë për llogari të saj. Ai ka si mision të tij parandalimin e konflikteve të mundshme midis administratës publike dhe individit.²⁵³ Avokati i Popullit vepron në bazë të ankesës apo kërkesës së paraqitur pranë tij.²⁵⁴

Në funksion të veprimtarisë së tij kushtetuese dhe realizimit të misionit për të cilin është konceptuar, çdo vit ai harton një raport vjetor lidhur me situatën e përgjithshme që respektimit të të drejtave themelore të njeriut. Në kuadër të misionit të tij ndër të tjera, sipas këtij raporti në vitin 2019 largimet ose heqjet e nëpunësve civilë nga administrata që kanë përfunduar në procese gjyqësore, i kanë kushtuar jo pak buxhetit të shtetit.

Gjykatat kanë vendosur në favor të të larguarve duke kërkuar ekzekutim të pretendimeve financiare të tyre si dhe rikthim në pozicionet e punës që kanë mbajtur para se të largoheshin, ose në një të ngjashëm. Në radhët e institucioneve tashmë diskutohet gjetja e mundësive për të rikthyer në pozicione të larguarit në mënyrë

²⁵³ Ligji Nr.8454, datë 4.2.1999, plotësuar me ligjin nr.8600 datë 10.04.2000, ndryshuar me ligjin nr.9398, datë 12.05.2005, shtuar dhe ndryshuar me ligjin nr.155/2014, datë 27.11.2014: “Për Avokatin e popullit”, neni 2.

²⁵⁴ Po aty.

që përfitimi i tyre financiar të mos vijë nga vendimi i gjykatave por të paguhen për punën që bëjnë.²⁵⁵

Raporti i Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil i vitit 2019 nënvizon, se konstatohen 601 vendime gjyqësore të formës së prerë të detyrueshme për t'u ekzekutuar. Nga këto 236 vendime, ose 39% e tyre janë zbatuar dhe nëpunësit janë rikthyer në shërbimin civil, ose janë liruar nga shërbimi civil për shkaqe ligjore (pension i plotë pleqërie ose dorëheqje) dhe 365 vendime ose 61% e tyre, gjyqfituesit janë regjistruar në listëpritje për t'u sistemuar në një pozicion të rregullt të shërbimit civil.

“Sipas të dhënave të raportuara nga institucionet, rezulton se aktualisht është paguar nga buxheti i shtetit në favor të nëpunësve gjyqfitues vlera prej 511.748.508 lekësh në zbatim të vendimeve gjyqësore” thuhet në raport. Po ashtu, “Procesi do të vijojë gjatë vitit 2020 me ndjekjen e zbatimit të vendimeve nga ministritë e linjës dhe do të vijojnë seancat dëgjimore me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, e cila ka rreth 143 vendime të pa ekzekutuara dhe me institucionet e administratës vendore dhe ato të pavarura”.²⁵⁶

²⁵⁵ Raport vjetor për veprimtarinë e institucionit të Avokatit të popullit, Viti 2019, fq. 57.

²⁵⁶ Raport vjetor për veprimtarinë e institucionit të Avokatit të popullit, Viti 2019, fq. 57.

Kthimi në detyrë i nëpunësve gjyqfitues ishte pjesë e rezolutës së një viti më parë miratuar nga Kuvendi, çka kërkonte ndjekjen e procesit dhe mënyrën sesi ishin zbatuar vendimet.²⁵⁷

Çështja e mosekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë të dhëna prej gjykatave në Republikën e Shqipërisë apo Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, mbetet një çështje me rëndësi thelbësore për shtetin shqiptar, pasi lidhet me forcimin dhe zhvillimin e një sistemi gjyqësor të respektueshëm nga të gjithë. Tejzgjatja e ekzekutimit, “vënia në diskutim” e drejtësisë së dhënë nga gjykata, ndikon në radhë të parë në humbjen e besimit ndaj shtetit.

Për çështjet e analizuara gjatë vitit 2019, me objekt detyrimin e organeve të administratës publike të paguajë shuma në të holla, Avokati i Popullit gjykon, se shkak i mosekzekutimit të titujve ekzekutivë, i cili ka cënuar të drejtën për një proces të rregullt ligjor, është dhe problematika që mbart Udhëzimi nr.1, datë 04.06.2014, i Këshillit të Ministrave, “Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njëjësive të qeverisjes së përgjithshme në llogaritë e thesarit”.

²⁵⁷ Komisioneri ka raportuar se ka komunikuar dhe ka administruar të dhëna nga 208 institucione të administratës publike, ku përfshihen ministrinë e linjës, institucionet e varësisë të administratës shtetërore, institucionet e pavarura dhe institucionet e administratës vendore nga të cilat rezultuan me probleme 36 prej tyre (11 ministrinë e linjës, 6 institucione në varësi të tyre, 11 bashki, 5 Këshilla Qarku dhe 3 institucione të pavarura).<http://www.panorama.com.al/largimet-e-padreja-nga-administrata-del-raporti-ja-sa-milione-euroka-paguar-buxheti-i-shtetit/>.

Raport vjetor për veprimtarinë e institucionit të Avokatit të popullit, Viti 2019, fq. 57.

<https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/reports/Raporti%20Vjetor%202019%20-%20Avokati%20i%20Popullit.pdf>

Çështja e moslejimit të borxheve të reja edhe pse është përcaktuar si objektivi qeverisë, sikurse shprehur në VKM nr.50, datë 05.02.2014, “Përmirësimin e strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura e të planit të veprimit”, rezulton se nuk është arritur.²⁵⁸ Organet apo institucionet debitoare, me rastin e dorëzimit të detyrimit në të holla, sikurse është vendosur nga gjykata nuk kanë kryer dhe nuk kryejnë procedurat e përcaktuara në aktet nënligjore, në bazë të të cilave drejtuesi i institucionit detyrohet të finalizojë një auditim të të gjitha hapave që kanë sjellë dëme monetare si dhe të ndëshkojë të gjithë përgjegjësit për situatën e krijuar. Mosrespektimi i akteve të lartpërmendura ka sjellë do të sjellë cënim të interesave pasurore për çdo taksapagues në Republikën e Shqipërisë.²⁵⁹

Cënimi i parimit për një proces të rregullt ligjor si rrjedhojë e mosëkzekutimit të vendimeve gjyqësore civile të formës së prerë në një afat të arsyeshëm në vlerësimin e Avokatit të Popullit²⁶⁰ vjen si pasojë e një sërë shkaqeve, të tilla si:

1. Shfaqja e mungesave të cilësive dhe njohurive profesionale nga ana e përmbauesve gjyqësorë të veçantë;
2. Kryerje e veprimeve përmbaimore jashtë objektit të ekzekutimit apo të parashikuara në ligj si dhe keqinterpretim i dispozitivit të vendimit gjyqësor civil apo administrativ;
3. Hezitim të pajustificueshëm nga ana e përmbauesve gjyqësorë për vendosjen e masave ndëshkimore ndaj subjektit debitor, personave të tjerë të cilët

²⁵⁸ Raport vjetor për veprimtarinë e institucionit të Avokatit të popullit, Viti 2019, fq. 57

²⁵⁹ Po aty.

²⁶⁰ Raport vjetor për veprimtarinë e institucionit të Avokatit të popullit, Viti 2019, fq. 57-58.

refuzojnë ose kryejnë në mënyrë të parregullt, nuk respektojnë afatet ose kryejnë të kundërtën e asaj që janë të detyruar me vendim të gjykatës;

4. Moskryerja e veprimeve të duhura prej personave përgjegjës për ekzekutimin e titujve ekzekutiv të cilat mundësojnë përmbushjen e detyrimit në të holla që institucioni shtetëror detyrohet të paguajë sipas vendimit gjyqësor të formës së prerë të gjykatës;
5. Mosnxjerrja e akteve nënligjore prej Këshillit të Ministrave, Ministrisë së Drejtësisë dhe ministrit përgjegjës për financat dhe atij për rendin dhe sigurinë publike, sikurse parashikuar në nenin 24, pika 3; nenin 36, pika 2; nenin 39; nenin 54, pika 4; nenin 55, pika 3 dhe nenin 56, pika 2, brenda afatit ligjor të parashikuar në nenin 89 të ligjit nr.26/2019, “Për Shërbimin e Përmbartimit Gjyqësor Privat”.

Në raportin vjetor të vitit të kaluar, Avokati i Popullit ka riprezantuar çështjen e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore penale të dënimit me gjobë të subjektit. Në kushtet kur Shërbimi i Përmbartimit Gjyqësor ka pranuar dhe pranon kërkesa për vënien në ekzekutim të tyre si dhe ka kryer dhe kryen veprime përmbartimore për ekzekutimin e detyrueshëm të tyre është rekomanduar Ministrit të Drejtësisë me shkresën nr.K2/I40-9 Prot, datë 22.02.2016, “Marrja e nismës për ndryshim legjislacioni”. Edhe pse ky rekomandim është pranuar në parim, Ministria e Drejtësisë me rastin e dërgimit në Kuvend të projektligjit për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore penale nuk ka reflektuar amendimet e kërkuara prej Avokatit të Popullit. Për rrjedhojë, çështjet e prezantuara në rekomandimin e dhënë Ministrit të Drejtësisë, kanë mbetur të pazgjidhura dhe se procesi i ekzekutimit të detyrueshëm të vendimeve penale të dënimit me gjobë të

subjektit, kryhet prej Shërbimit të Përmbarrimit Gjyqësor, jo në përputhje me parimet apo të drejtat e garantuara nga legjislacioni në fuqi.

Problematikë e trashëguar është procesi i ekzekutimit të detyrueshëm të titujve ekzekutivë mbi të ardhurat mujore (pagën) e debitorit. Shërbimi i Përmbarrimit Gjyqësor Shtetëror apo Privat me rastin e kryerjes së veprimeve përmbarrimore për ekzekutimin e detyrueshëm të titujve ekzekutivë, kanë kryer dhe kryejnë sekuestrimin e të ardhurave mujore të debitorit, duke krijuar situata në cënim të interesave jetike të tij për shkak të mosrespektimit të parashikimeve të nenit 533 të Kodit të Procedurës Civile apo nenit 123 të Kodit të Punës.

Fakti që deri më sot nuk është përcaktuar minimumi jetik, ka bërë që parashikimi i nenit 533 të Kodit të Procedurës Civile të jetë i pazbatueshëm prej Shërbimit të Përmbarrimit Gjyqësor. Sipas dispozitës ligjore në fjalë, vendosja e masës së sekuestros mbi të ardhurat mujore (paga) e debitorit, kryhet pa cënuar “minimumin jetik”, minimum i cili deri më sot është i pa përcaktuar.²⁶¹ Sipas Avokatit të popullit kjo situatë meriton vëmendjen maksimale për trajtimin e saj në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe në respektim të të drejtave të individit.

Një çështje tjetër të cilën e konsideron të rëndësishme është problematika me përmbarruesit privatë dhe Ministrinë e Drejtësisë për pozicionin e avokatit të popullit ndaj tyre si subjekt. Ky i fundit deklaron se në mënyrë të gabuar, kuptohet se,

²⁶¹ Raport vjetor për veprimtarinë e institucionit të Avokatit të popullit, Viti 2019, fq. 59

veprimtaria e Shërbimit të Përmbarrimit Gjyqësor Privat është jashtë sferës së kompetencës dhe juridiksionit të Institucionit të Avokatit të Popullit. Ky kuptim i dhënë prej organeve të lart përmendura bie ndesh me parashikimet e nenit 3/6 të Kodit të Procedurës Administrative si dhe nenit 2 të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit” të ndryshuar.

Gjithashtu nga përmbarrues gjyqësorë të veçantë në procesin e marrëdhënieve me Avokatin e Popullit, sipas tij janë shfaqur qëndrime refuzuese për dhënie informacioni dhe shpjegime në procesin e ekzekutimit të titujve ekzekutiv. Ky qëndrim vjen si rrjedhojë e mosnjohjes dhe interpretimit të gabuar të kuadrit ligjor, për sa i përket prevalimit të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999, “Për Avokatin e Popullit” të ndryshuar, mbi ligjin nr. 26/2019, “Për Shërbimin e Përmbarrimit Gjyqësor Privat”.

Një tjetër problematikë që thekson Avokati i popullit dhe që lidhet me ekzekutimin e vendimeve penale, e referuar kjo nga vetë shërbimi përmbarrimor është se Policia e shtetit nuk bashkëpunon për mbështetje me punonjës të policisë të përmbarruesve gjatë ekzekutimit të vendimeve gjyqësore.

Nëse do të analizojmë statistikën e publikuar nga avokati i popullit lidhur me ankesat e paraqitura në këtë institucion, do të vërejmë se prevalojnë ankesat ndaj administratës publike. Përqindja më e madhe e tyre janë ndaj Ministrisë së drejtësisë dhe numri më i madh i ankesave kanë për objekt shkeljen e procedurave të rregullta ligjore, kufizimi i lirisë së personit, ndjekur më pas nga kufizimet e të drejtës së pronës.

Në këtë raport theksohet se vetëm në vitin e fundit ka pasur 28 raste në të cilat subjektet gjyqësive/kreditor kanë pretenduar cënimin e parimit për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor si rrjedhojë e moszekutimit të titujve ekzekutiv në një afat të arsyeshëm nga autoritetet e ngarkuara me ligj për zbatimin e tyre.²⁶²

Nga sa më sipër shihet, sipas konstatimeve, se në shumë prej hallkave nëpërmjet të cilave kalon procesi i ekzekutimit të vendimeve, vetëm vitin e fundit gjenden një sërë pengesash. Rast pas rasti është tejet e vështirë të bësh një analizë lidhur me problematikat që vështirësojnë realizimin e tij, por kjo nuk do të thotë se shteti ynë duhet të qëndroj pasiv dhe të mjaftohet vetëm me ndryshime të herë pas herëshme të legjislacionit. Ai është përgjegjës për respektimin e të drejtave themelore, e në këto kushte duhet të krijojë mekanizma real dhe efektivë për garantimin e tyre.

Në raportin vjetor për vitin 2018 të Kontrollit të Lartë të Shtetit theksohet se:
“Vendimet gjyqësore të gjykatave vendase dhe ato të lidhura me çështjet e arbitrazhit ndërkombëtar apo Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut përbëjnë risk real për nevojat për financim si pasojë e mungesës së shkëmbimit të informacionit ndërmjet strukturave përkatëse shtetërore. Vendimet gjyqësore për largim nga puna vazhdojnë të krijojnë efekte negative për Buxhetin e shtetit (mbi 2 miliard lekë çdo vit), duke mos marrë masat e duhura nga institucionet buxhetore për sistemimin e gjyqësuesve

²⁶²<https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/media/Prezantimi%20i%20permbledhjes%20se%20raportit%20vjetor%202020.pdf>

pavarësisht vendeve vakante dhe lejuar akumulimin e pagave të pagueshme për çdo pozicion pune.”²⁶³

KLSH ka konstatuar se: “Në vendimet gjyqësore të formës së prerë nuk raportohen dhe nuk deklarohen si shpenzim në kundërshtim me nenin 61 të Ligjit nr.9936 datë 26.06.2008. Kjo krijon kushtet për akumulimin e kamatvonesave si pasojë e vonës në shlyerjen e tyre, nënvlerësimin e shpenzimeve të vitit dhe deficitit të vitit buxhetor, pagesën e tarifave përmbartimore si pasojë e mosekzekutimit vullnetar të vendimeve dhe thyerje të radhës së shlyerjes së vendimeve dhe selektivitet në përzgjedhjen e vendimeve për pagesë. Në shumë institucione nuk ekziston databaza e vendimeve gjyqësore në mënyrë që nga ana e KLSH të raportohet efekti i detyrimeve si pasojë e vendimeve gjyqësore të cilat kanë marrë formë të prerë. Efekti i pagesave të kryera nga Buxheti i Shtetit për vitin 2017 për largim të padrejtë të punonjësve nga puna nëpërmjet llogarive të shpenzimeve operative vlerësohet në rreth 2 miliardë lekë dhe për vendimet e tjera gjyqësore në rreth 1 miliardë lekë. Në të njëjtën linjë, edhe për vendimet gjyqësore me objekt çështjet e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut u konstatua se vendime gjyqësore të miratuara për pagesë nga viti 2016, rezultojnë sipas detyrimeve të aparatit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë të pa kontabilizuara për rreth 500 milionë lekë.”²⁶⁴

Nga sa më sipër KLSH thekson rëndësinë e ekzekutimit të vendimeve përfundimtare, fenomen i cili do të ketë një impakt shumë negativ në akumulimin e detyrimeve të

²⁶³ Raporti vjetor i performancës 2018, Kontrolli i Lartë i Shtetit, Tiranë 2019, fq. 16.

²⁶⁴ Po aty.

prapambetura. Gjithashtu i kërkon të gjitha institucioneve të nxjerrin të dhëna të sakta lidhur me detyrimet e tyre të pashlyera, deri më tani duke i ngarkuar ato me përgjegjësi.²⁶⁵

Sipas Këshillit të Ministrave në përmbledhjen e raport progresit të KE paraqitur në Qershor të vitin 2019, Shqipëria ka ndër prioritetet kryesore zbatimin e reformës gjithë përfshirëse dhe të plotë në sistemin e drejtësisë, duke rezultuar në tërësi, në një përparim të mirë. Janë krijuar institucionet e reja për vetëqeverisjen e gjyqësorit, si Këshilli i Lartë Gjyqësor, Këshilli i Lartë i Prokurorisë dhe Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, duke shënuar një hap vendimtar në forcimin e pavarësisë dhe llogaridhënies së gjyqësorit. Rivlerësimi i të gjithë gjyqtarëve dhe prokurorëve (procesi i vetting-ut) ka përparuar në vazhdimësi, duke prodhuar rezultate të prekshme. Këto rezultate konkrete dhe të besueshme kanë forcuar ndjeshëm sistemin e drejtësisë duke konsoliduar pavarësinë, paanësinë, profesionalizmin dhe llogaridhënien e gjyqësorit.²⁶⁶

Sipas Raporteve të monitorimit të strategjisë ndërsektoriale të drejtësisë 2017-2020 lidhur me hapat konkret të Reformës në Drejtësi, në kuadër të integrimin evropian, që po ndjek shteti ynë sipas të dhënave të paraqitura nga Ministria e Drejtësisë dhe konkretisht sfidat që lidhen me përmirësimin e situatën mbi ekzekutimin e vendimeve

²⁶⁵ Po aty.

²⁶⁶file:///C:/Users/user/Downloads/20190708131532Mbi%20gjetjet%20dhe%20%20rekomandimet%20e%20Raportit%20te%20Komisionit%20Evropian%20per%20Shqiperine%202019.pdf

gjqësore apo urdhrave ekzekutiv janë realizuar thuajse plotësisht sipas të dhënave, si më poshtë vijon:

Në kuadër të reformës në drejtësi dhe zbatimit të strategjisë, ajo raporton se për përmirësimin e godinave të shërbimit të përmbartimit shtetëror, infrastrukturës logjistike bashkëkohore, për përmirësimin e ambienteve të godinës së DPP dhe Zyrave Përmbartimore Tiranë, Fier, Korçë, Lushnje, Berat, Gjirokastër, Krujë, Kukës, Lezhë, Mat, Pogradec, Pukë, Shkodër, Tropojë, Dibër, Vlorë e Përmet është mundësuar realizimi në 100% të investimeve të planifikuara në vlerë faktike prej 7,459,589 lekë për blerje “pajisje elektronike”. Ky investim sipas MD ishte një domosdoshmëri e Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbartimit dhe Zyrës Përmbartimore Tiranë për të garantuar një shërbim të ekzekutimit të titujve ekzekutive në kushte normale pune.²⁶⁷

Drejtorja e Përgjithshme e Përmbartimit ka propozuar projekt idenë për rikonstruksion dhe përshtatje të ambienteve të institucionit të Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbartimit dhe Zyrës Përmbartimore Tiranë,. Projekt ideja propozohet të përfshihet në Projekt buxhetin e ardhshëm 2020 -2022.²⁶⁸

Drejtorja e Përgjithshme e Përmbartimit ka në proces realizimin e trajnimit për përmbartuesit gjyqësor me objekt “Ekzekutimi i çështjeve me objekt “takim me fëmijë dhe pensioni ushqimor”. Janë realizuar trajnime për përmbartuesit gjyqësor në

²⁶⁷Raport i monitorimit të strategjisë ndërsektoriale të drejtësisë 2017-2020, MD, fq. 103.

²⁶⁸ Raport i monitorimit të strategjisë ndërsektoriale të drejtësisë 2017-2020, MD, fq. 104.

periudhë prove me temë “Ekzekutimit i detyrueshëm i titujve ekzekutive” dhe “Etika dhe komunikimi”.²⁶⁹

Gjithashtu, të ndodhur përballë faktit, se pranë Shërbimit Përmbartimor Gjyqësor Shtetëror ka të regjistruara për ekzekutim një numër të lartë çështjesh përmbartimore dhe staf të reduktuar, Drejtoria e Përgjithshme e Përmbartimit, në cilësinë e organit qendror të këtij shërbimi, me përfundimin e analizës së nevojës për shtesë të organikës së shërbimit ka paraqitur kërkesën për shtim stafi me 20 punonjës.²⁷⁰

Me identifikimin e nevojës për një trajtim financiar të përshtatshëm, në masë të mjaftueshme me natyrën e përgjegjësisë së funksionit të përmbartuesit gjyqësor, shkallën e vështirësisë në përmbushjen e tij, është realizuar paraqitja e propozimeve konkrete në projektligjin për ndryshime të ligjit nr. 8730, datë 18.01.2001 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Shërbimit të Përmbartimit Gjyqësor”. Si dhe është finalizuar ndryshimi i kuadrit ligjor në fuqi, që lidhet me organizimin dhe funksionimin e shërbimit përmbartimor gjyqësor privat, si pjesë e paketës së reformës në drejtësi. Në datën 08.05.2019, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë miratoi ligjin nr.26/2019 “Për shërbimin përmbartimor gjyqësor privat”, i cili përmbylli edhe paketën e dytë të ligjeve të reformës në sistemin e drejtësisë.

²⁶⁹ Raport i monitorimit të strategjisë ndërsektoriale të drejtësisë 2017-2020, MD, fq. 104-105.

²⁷⁰ Raport i monitorimit të strategjisë ndërsektoriale të drejtësisë 2017-2020, MD, fq. 105.

Me miratimin e këtij ligji, Ministria e Drejtësisë shprehet se arrin të përmbushë objektiva²⁷¹ si :

- a. adresimin e problematikave të evidentuar në analizën e sistemit të drejtësisë për shërbimin përbarimor gjyqësor privat;
- b. garantimin e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë, si pjesë e parimit të procesit të rregullt ligjor referuar jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese.
- c. hedhjen e bazave solide për zhvillimin e profesionit të përbaruesit gjyqësor dhe statusin e tij profesional, përgjegjësisë së tij ligjore, garancive të procesit përbarimor, marrëdhënieve institucionale, integritetit akademik të përbaruesve gjyqësorë në përputhje me standardet më të mira ndërkombëtare në këtë fushë.

Për vitin 2019 nuk janë arritur marrëveshje dy ose shumëpalëshe për dhënien e aksesit në bazat e të dhënave me sistemin bankar dhe shkëmbimit në kohë reale të informacionit me sistemin bankar, me qëllim efikasitetin e procesit të ekzekutimit.²⁷²

Nga ana e Drejtorisë së Hartimit të Legjislacionit, është evidentuar si nevojë e përfshirjes së projektvendimit “Për përcaktimin e mënyrës së mbajtjes së regjistrimit qendror të kërkesave për vënie në ekzekutim të urdhrave të ekzekutimit dhe ndërveprimi me bazat e tjera të të dhënave shtetërore" në programin analitik të projekt-akteve që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave gjatë vitit 2020, i miratuar me VKM nr.837 datë 24.12.2019.²⁷³

²⁷¹ Raport i monitorimit të strategjisë ndërsektoriale të drejtësisë 2017-2020, MD, fq. 116.

²⁷² Raport i monitorimit të strategjisë ndërsektoriale të drejtësisë 2017-2020, MD, fq. 120.


²⁷³ Raport i monitorimit të strategjisë ndërsektoriale të drejtësisë 2017-2020, MD, fq. 119-121.

Përpos raportimeve të paraqitura nga Ministria e Drejtësisë, në Raportin e monitorimit të strategjisë ndërsektoriale të drejtësisë 2017-2020, të dhënat dhe statistikat konkrete publikuara prej saj paraqesin situatën e përpunuar nga ana ime në këtë studim, si më poshtë vijon:

Tabela 3. Çështjet e ekzekutuara dhe në ekzekutim

Vitet	Të Ekz.	Në Ekz.	Mes.Ekz	Mes. Në. Ekz	Ecuria Të Ekzekutuara	Ecuria Në Ekzekutim
2014	8,555	22,632	8,277	28,125	100%	100%
2015	9,260	27,282	8,277	28,125	108%	121%
2016	8,864	28,283	8,277	28,125	96%	104%
2017	7,664	30,796	8,277	28,125	86%	109%
2018	7,043	31,632	8,277	28,125	92%	103%

Grafik 1 Çështjet e ekzekutuara dhe në ekzekutim



Referuar statistikave në 5 vite, përkatësisht nga viti 2014 deri në fund të vitit 2018 kemi një total prej 41,386 vendime të ekzekutuara, pra mesatarisht 8,277 vendime në vit. Në vitin 2015 është arritur kulmi me 9,260 vendime shprehur ndryshe 11.88% mbi mesataren e viteve të marra në shqyrtim.

Pas vitit 2015 vendimet kanë një trend rënës, duke arritur minimumin në vitin 2018 me 7,043 ose -14.91% më pak se mesatarja.

Vendimet e ekzekutuara për çdo vit arrijnë të mbyllin jo më shumë se 23% të totalit të vendimeve të cilat janë në pritje. Këto tregues nënkuptojnë se strukturat përmbartimore nuk ofrojnë kapacitetin e nevojshëm për të përmbushur nevojat e krijuar ose janë të penguar nga rrethana të varura nga to.


Vendimet që mbeten në pritje për ekzekutim në 2018 kanë pësuar një rritje 39.77% krahasuar me vitin 2014 ose 12.47% nga mesatarja e 5 viteve. Viti 2018 shfaq dhe pikun më të ulët të vendimeve të marra duke arritur në realizimin e vetëm 18% e totalit në pritje për tu ekzekutuar.

Tabela 4 Çështjet e regjistruar në vite

Vitet	Totali I Çështjeve	Nr ÇZL	% ÇZL	Ecuria e Çështjeve	Ecuria E ÇZL
2014	34,863	11,042	32%	100%	100%
2015	42,417	12,148	29%	122%	110%
2016	44,437	13,487	30%	105%	111%
2017	46,394	12,411	27%	104%	92%
2018	44,055	15,056	34%	95%	121%

Shënim. Inicialet Ç.Z.L. janë çështjet që u është dhënë një zgjidhje ligjore.

Grafik 2 Çështjet e regjistruar në vite



Në 5 vite janë regjistruar mesatarisht 42,433 çështje ku 12,829 prej tyre në vit kanë marrë një zgjidhje ose 30% e shprehur në përqindje.

Çështjet e regjistruara kanë një trend rritës nga viti në vit por ky trend është shoqëruar thuajse me të njëjtin ritëm edhe me çështjet që kanë marrë një zgjidhje ligjore.

Çështjet e regjistruara arrijnë pikun në vitin 2017 me 46,394 çështje, 9% mbi mesatare, ndërkohë që zgjidhjet e tyre janë në minimum me 27%, rreth 3% më pak se sa vlera mesatare.

Kulmi i çështjeve që kanë marrë një zgjidhje ligjore është arrirë në vitin 2018 me 15,056 çështje, afërsisht 17% mbi mesataren e viteve dhe 34% e çështjeve të regjistruara brenda vitit.

Tabela 5 Çështjet e regjistruara në vite sipas rretheve gjyqësore

Gjykata e Rrethit Gjyqësor	2014	2015	2016	2017	2018	%	Total
Berat	1,325	1,570	1,124	1,728	1,775	4%	7,522
Dibër	976	1,299	1,432	1,434	1,193	3%	6,334
Durrës	3,133	4,429	5,840	6,493	7,022	13%	26,917
Elbasan	2,991	3,924	4,407	4,937	4,876	10%	21,135
Fier	1,761	2,154	2,696	1,796	1,108	4%	9,515
Gjirokastrë	857	1,000	905	822	945	2%	4,529
Kavajë	693	842	641	704	1,040	2%	3,920
Korçë	1,854	2,324	2,999	3,538	2,449	6%	13,164
Krujë	541	701	769	634	464	1%	3,109
Kukës	700	1,003	1,125	1,581	1,218	3%	5,627
Kurbin	441	853	1,003	964	899	2%	4,160
Lezhë	883	1,018	1,080	1,012	1,144	2%	5,137
Lushnje	879	785	1,051	855	608	2%	4,178
Mat	570	776	835	795	640	2%	3,616
Përmet	235	215	171	139	143	0%	903
Pogradec	690	1,349	1,263	1,110	1,175	3%	5,587
Pukë	422	570	373	339	313	1%	2,017
Sarandë	1,280	3,051	2,490	2,057	1,848	5%	10,726
Shkodër	1,377	1,637	1,750	1,932	1,356	4%	8,052
Tiranë	10,776	9,987	9,927	10,994	11,990	25%	53,674
Tropojë	177	311	315	201	223	1%	1,227
Vlorë	2,302	2,619	2,241	2,329	1,576	5%	11,067
Totali	34,863	42,417	44,437	46,394	44,005	100%	212,616

Numërohen 212,616 çështje të regjistruara në Republikën e Shqipërisë ku peshën kryesore e zënë : Rrethi i Tiranës me 53,674 çështje ose 25%, Rrethi i Durrësit me 26,917 çështje ose 13%, Rrethi i Elbasanit me 21,135 çështje ose 10%, Rrethi i Korçës me 13,164 çështje ose 6%, Rrethi i Vlorës me 11,067 çështje ose 5%. Këto rrethe në total përbëjnë afërsisht 60% të gjithë çështjeve të regjistruara në rang Republike.

Grafik 3 Çështjet e regjistruara në vite sipas rretheve gjyqësore




Tabela 6 - Renditja e 5 rretheve me më shumë çështje në republikën e Shqipërisë dhe përqindja e çështjeve në raport me popullsinë.

Rend	Gjykata e Rrethit Gjyqësor	2014	2015	2016	2017	2018	Total	Popullsia 2018	Çështje për Popullsi
1	Tiranë	10,776	9,987	9,927	10,994	11,990	53,674	883,996	6%
2	Durrës	3,133	4,429	5,840	6,493	7,022	26,917	289,626	9%
3	Elbasan	2,991	3,924	4,407	4,937	4,876	21,135	278,548	8%
4	Korçë	1,854	2,324	2,999	3,538	2,449	13,164	210,179	6%
5	Vlorë	2,302	2,619	2,241	2,329	1,576	11,067	189,311	6%
	Totali	21,056	23,283	25,414	28,291	27,913	125,957		

Në krahasim me popullsinë, rrethet konsiderohen të jenë në nivele të përafërta duke filluar nga 6% deri në 9%. Rrethi i Tiranës, Korçës, dhe Vlorës me 6%. Rrethi i Elbasanit 8%, dhe rrethi i Durrësit paraqet nivelin më të lartë në renditje me 9%.

Tabela 7. Përmbledhje të çështjeve dhe kategorizimi i tyre [2014-2018]

Gjykata e Rrethit Gjyqësor	%	Total	Në Ekzekutim +- 6 muaj	Ekzekutuar +- 6 muaj	Pushuar +- 6 muaj	Refuzuar	Pezulluar me vendim gjyqësor	Te transferuara	Pushuar	Te tjera
Tiranë	25%	53,674	42,909	9,034	533	36	282	593	267	20
Durrës	13%	26,917	22,716	3,817	35	1	189	46	97	16
Elbasan	10%	21,135	14,677	4,367	898	39	24	313	784	33
Korçë	6%	13,164	7,448	2,839	755	5	110	1,221	785	1
Vlorë	5%	11,067	6,218	2,551	1,709	6	154	116	312	1
Sarandë	5%	10,726	2,908	1,115	-	-	-	5,585	1,118	-
Fier	4%	9,515	4,998	2,377	1,130	15	93	262	432	208
Shkodër	4%	8,052	4,146	1,854	20	16	1,592	35	389	-
Berat	4%	7,522	5,680	1,700	54	-	3	23	62	-
Dibër	3%	6,334	3,301	1,617	885	31	3	188	309	-
Kukës	3%	5,627	4,107	958	266	176	2	29	86	3
Pogradec	3%	5,587	2,824	1,022	1,473	-	3	25	229	11
Lezhe	2%	5,137	2,311	1,728	41	28	701	141	187	-
Gjirokastrë	2%	4,529	3,786	636	1	-	3	21	6	76
Lushnjë	2%	4,178	2,182	1,285	166	7	71	95	371	1
Kurbin	2%	4,160	2,190	1,051	200	-	579	103	37	-
Kavajë	2%	3,920	2,737	864	18	-	44	120	137	-
Mat	2%	3,616	2,493	558	131	88	223	21	102	-
Krujë	1%	3,109	1,262	824	247	2	602	142	30	-
Pukë	1%	2,017	895	434	132	72	287	134	21	42
Tropojë	1%	1,227	484	456	123	7	30	99	28	-
Përmet	0%	903	433	299	135	-	17	14	5	-
Totali	100%	212,116	140,705	41,386	8,952	529	5,012	9,326	5,794	412
			66.33%	19.51%	4.22%	0.25%	2.36%	4.40%	2.73%	0.19%

Nga totali i çështjeve vihet re se 85.84% janë ekzekutuar ose janë në proces ekzekutimi, brenda afatit 6 mujor ose me afat të plotësuar mbi 6 muaj. Sipas kategorizimit në përqindjen më të lartë rrethet gjyqësore renditen : Rrethi Gjyqësor Durrës dhe Gjirokastrë kanë 84% të çështjeve në ekzekutim, Rrethi Gjyqësor Tropojë ka ekzekutuar 37% të çështjeve, Rrethi Gjyqësor Pogradec ka pushuar 26% të çështjeve, Rrethi Gjyqësor Pukë ka refuzuar 4% të çështjeve, Rrethi Gjyqësor Shkodër ka pezulluar me vendim gjykate 20% të çështjeve, Rrethi Gjyqësor Sarandë ka transferuar 52% të çështjeve dhe pushuar 10% të tyre.

Sistemi elektronik i centralizuar në të cilin duhet të regjistrohen të gjitha rastet nuk është akoma funksional. Në shumë institucione nuk ekziston databaza e vendimeve gjyqësore në mënyrë që nga ana e KLSH të raportohet efekti i detyrimeve si pasojë e vendimeve gjyqësore të cilat kanë marrë formë të prerë.

Për vitin 2019, nuk është arritur marrëveshje dy ose shumëpalëshe për dhënien e aksesit në bazat e të dhënave me sistemin bankar dhe shkëmbimit në kohë reale të informacionit me sistemin bankar, me qëllim efikasitetin e procesit të ekzekutimit.

Të gjithë këto tregues dëshmojnë se nuk kemi një përmirësim të dukshëm të situatës dhe se probleme të paidentifikuara mirë vijojnë të sjellin pengesa në realizimin e të drejtave të gjyqfituesve.

Në raportin vjetor të Departamentit të Administratës Publike për vitin 2019 në kuadër të Politikave në shërbimin civil, të udhëhequra nga reforma në këtë fushë, si dhe

zbatimi i politikave të shërbimit civil në institucionet e administratës shtetërore parashikohet se objektivë e kësaj administrate është zbatimi i mëtejshëm i vendimeve gjyqësore të formës së prerë dhe rikthimi në detyrë i nëpunësve civilë gjyqfitues me fokus²⁷⁴ në:

- rritjen e cilësisë së administrimit të dokumentacionit të nevojshëm (dosjeve personale të nëpunësve të larguar), me qëllim zbatimin e saktë të detyrimeve ligjore që burojnë nga këto vendime;

- vlerësimin rast pas rasti të secilit vendim dhe detyrimeve që burojnë prej tij; - detyrimin e institucioneve të administratës shtetërore për të përdorur sistemin 'online' të raportimit të të dhënave gjyqësore.

6.1.2. Analiza të raporteve nga autoritete ndërkombëtare lidhur me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore në RSH

Një raport tepër i rëndësishëm që vlen të përmendet në këtë kapitull, lidhur me situatën aktuale në Shqipëri është Raport Progresi i Komisionit Evropian, 2019. Shqipëria në zbatim të Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit dhe të takimeve të zhvilluara mes palëve në Prill 2018, Komisioni rekomandoi që Këshilli të vendosë për çeljen e negociatave për anëtarësimin e Shqipërisë në Bashkimin Evropian, duke inkurajuar Shqipërinë të ruajë dhe të thellojë veprimtarinë e saj lidhur me reformën në drejtësi, veçanërisht në fushën kryesore të sundimit të ligjit.²⁷⁵

²⁷⁴ Raporti vjetor i Departamentit të Administratës Publike, KM, 2019, fq. 4.

²⁷⁵ Albania 2019 Report, KE, Brussels, 29.5.2019, fq.3.

Komisioni ka vazhduar të monitorojë plotësisht zhvillimet në këto fusha dhe në këtë raport thekson se Shqipëria ka një nivel të lartë të përgatitjes për zbatimin e standardeve evropiane. Sipas këtij raporti është arritur një progres lidhur me zbatimin e reformave të gjera në drejtësi, duke theksuar se rezultate të pëlqyeshme ka dhënë në veçanti procesi i vetting-ut.²⁷⁶

Lidhur me të drejtat themelore, ajo vlerëson se Shqipëria ka kompletuar kuadrin ligjor lidhur me njohjen e drejtave themelore e të njeriut në përputhje me standardet evropiane. Gjatë periudhës së monitorimit Shqipëria ka bërë përpjekje për të përmbushur detyrimet që rrjedhin nga ndërkombëtarët për plotësimin e instrumenteve ligjore, ndonëse garantimi i përgjithshëm i këtyre instrumenteve mbetet ende për tu arritur.

Kuadri ligjor është përmirësuar edhe në luftën kundër korrupsionin. Përpjekjet operacionale kundër nivelit të lartë të korrupsionin kanë filluar të sjellin disa rezultate konkrete. Megjithatë, korrupsioni është i përhapur në shumë sektorë dhe mbetet çështje shqetësuese.²⁷⁷

Sipas këtij raport progresi, infrastruktura gjyqësore mbetet e dobët në përgjithësi dhe alokimet e buxhetit të ardhshëm duhet ta marrin parasysh këtë aspekt. Një pjesë e mirë e seancave gjyqësore vazhdojnë të mbahen në zyrat e gjyqtarëve, pasi shpenzimet për ambientet e gjykatës nuk janë parë si prioritare për shkak të krijimit të institucioneve

²⁷⁶ Albania 2019 Report, KE, Brussels, 29.5.2019, fq.14.

²⁷⁷ Albania 2019 Report, KE, Brussels, 29.5.2019, fq.23.

të reja gjyqësore.

Këshilli i Lartë Gjyqësor monitoron dhe vlerëson veprimtaritë gjyqësore në bazë mujore. Të gjitha gjykatave u kërkohet të dërgojnë një raport mujor në Këshillin e Lartë Gjyqësor. Atyre u kërkohet gjithashtu të hartojnë raporte vjetore të veprimtarisë. Të gjitha gjykatat kanë uebfaqe, të cilat janë të arritshme për publikun, megjithëse të dhënat nuk azhurnohen gjithmonë plotësisht për shkak të mungesës së kapacitetit. Kjo gjithashtu ndikohet nga mungesa e funksionalitetit të plotë në sistemin elektronik të menaxhimit të çështjeve, i cili deri më tani nuk prodhoi një informacion statistikor të besueshëm dhe koherent. Një sistem i ri modern, i centralizuar dhe i unifikuar për menaxhimin e çështjeve është duke u zhvilluar me mbështetjen e donatorëve, por mbetet për t'u vendosur.

Ndikimi i zgjidhjes alternative të mosmarrëveshjeve vazhdon të jetë i ulët.

Ende ka mungesë të raportimit të konsoliduar për efikasitetin e sistemit të drejtësisë. Efikasiteti i sistemit të drejtësisë ndikohet nga çështje të tilla si kohëzgjatja e procesit dhe e zbardhjes së vendimit, si dhe numri i çështjeve në pritje në të gjitha nivelet e gjykatës përfshirë Gjykatën Kushtetuese. Numrin më të ulët të vendimeve të zbardhura e ka Gjykata e Apelit, veçanërisht Gjykata Administrative e Apelit (37%). Kjo është për shkak të një numri të madh të ankesave dhe numrit të ulët të gjykatësve të akorduar në këtë Gjykatë. Numrin më të lartë të vendimeve të zbardhura (100%) e mban Gjykata e shkallës së parë për krime të rënda.

Shkarkimet dhe dorëheqjet që rrjedhin nga procesi i vetting-ut kanë krijuar vende të

lira në gjyqësor. Kjo rriti numrin e çështjeve të prapambetura, veçanërisht në nivelin e Gjykatës së Lartë, ku volumi aktual është afërsisht 30,000 çështje në pritje.²⁷⁸

Ndryshimet në kodet procedurale në kuadër të reformës kanë parashikuar dispozita të përmirësuara ligjore për kohëzgjatjen e procedurave.

Përveç kohëzgjatjes së përgjithshme të procedurave gjyqësore, ekzekutimi i vendimeve gjyqësore mbetet një shqetësim. Që nga prezantimi i shërbimit të zyrave private (përmbartimore), zbatimi i vendimeve gjyqësore është përmirësuar. Sidoqoftë, zbatimi i kërkesave monetare ndaj shtetit duhet të përmirësohet më tej. Tarifat e suksesit duhet të jenë më proporcionale me vlerën përfundimtare të pasurive të paluajtshme në fund të procedurës përmbartimore, sesa me vlerën fillestare të saj.

Sistemi elektronik i centralizuar në të cilin duhet të regjistrohen të gjitha rastet nuk është akoma funksional.²⁷⁹ Në të njëjtën kohë, përmbartuesit zyrtarë duhet të kenë qasje në regjistrat ekzistues të mbajtur nga shteti dhe bazën e të dhënave mbi pasuritë, siç janë pasuritë e paluajtshme. Ndryshimet e mëtejshme në ligjet procedurale janë të nevojshme për të siguruar zbatimin në kohë të vendimeve, veçanërisht për organet territoriale të lidhura me vendbanimin e debitorit.

Si përfundim Progres-raporti rekomandon në mënyrë prioritare përfundimin në kohë të reformës gjithëpërfshirëse në drejtësi, që do të thotë, në këndvështrimin tim, nëse

²⁷⁸ Albania 2019 Report, KE, Brussels, 29.5.2019, fq.17.

²⁷⁹ Albania 2019 Report, KE, Brussels, 29.5.2019, fq.17-18.

reforma në drejtësi do të mbyllet pa humbur kohë të çmuar dhe duke e adresuar fuqimisht në muajt në vijim, atëherë, rruga jonë për negociatat është e hapur. Nga ana tjetër, në Progres-raport është e qartë se kjo lidhet ngushtësisht me konsolidimin e rezultateve, ku theks të veçantë kanë hetimet, gjykimet dhe ndëshkimet, pra, i gjithë zinxhiri i pushtetit gjyqësor në Shqipëri.²⁸⁰

Në raportin për Shqipërinë, lidhur me praktikën për të drejtat e njeriut, Departamenti i shtetit i SHBA-SË, Byroja për demokracinë, të drejtat e njeriut dhe punën, pas një monitorimi ka evidentuar se ndërkohë që individët dhe organizatat mund të kërkojnë korrigjim të shkeljeve të të drejtave të njeriut, gjykatat ishin të prekshme nga korrupsioni, inefficenca, frikësimi dhe ndërhyrjet politike.

Gjykatësit zhvillonin shumë prej seancave gjyqësore në zyrat e tyre, duke demonstruar një mungesë profesionalizmi dhe duke ofruar mundësi për korrupsion. Këta faktorë minonin autoritetin e gjyqësorit, kontribuonin për vendime të debatueshme gjyqësore, dhe çonin në aplikim jokonseguent të ligjit. Pavarësisht të drejtës statutores për ndihmë ligjore falas në çështjet civile, OJF-të raportuan se shumë pak individë përfituan nga kjo gjatë vitit. Personat që kanë shteruar mundësitë në gjykatat e vendit mund të apelonin në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Në shumë raste, autoritetet nuk i vinin në zbatim vendimet e GJEDNJ, sidomos ato që lidheshin me të drejtën për një proces të rregullt ligjor.²⁸¹

²⁸⁰ Albania 2019 Report, KE, Brussels, 29.5.2019, fq.19.

²⁸¹ Raport për Shqipërinë, lidhur me praktikën për të drejtat e njeriut, Departamenti i shtetit i SHBA-SË, Byroja për demokracinë, të drejtat e njeriut dhe punën, Ambasada SHBA, 2017.

Në një analizë të realizuar nga Këshilli Evropës²⁸² janë vlerësuar ndryshimet e Kodit të Procedurës Civile lidhur me çështjen e “afatit të arsyeshëm” - Ligji 38/2017 'Për Ndryshimet e Kodit të Procedurës Civile'.

Sipas kësaj analize ndryshimet parashikojnë masa për të shkurtuar kohëzgjatjen e procedurave - gjatë rrjedhës së gjykimit, siç është e drejta e gjykatës për të vendosur gjoba (në çdo rast) kur palët vonojnë me dashje procedurat. Theksohej se aplikimi i ndryshimeve të reja do të varet shumë nga gjyqtarët nga mënyra sesi ata do të zbatojnë dispozitat legjislative, si ato ekzistuese ashtu edhe ato të prezantuara së fundmi.²⁸³

Sa i përket mjeteve juridike të reja, gjykatat shqiptare, të të gjitha instancave kanë kompetencë të gjykojnë kërkesat në lidhje me pretendime të individëve që kanë pësuar dëmtime monetare ose jo pasurore, për shkak të vonesës së paarsyeshme të gjykimit të tyre, në përputhje me përkufizimin e nenit 6, paragrafi 1 i KEDNJ-së (neni 399, paragrafi Por këto ndryshime nuk parashikojnë aplikim retrospektiv dhe ky fakt është kritikuar nga GJEDNJ. Do të ishte e këshillueshme që të ndryshohej ligji ose të krijohet një praktikë gjyqësore.

Neni 399, paragrafi 2 përcakton kuptimin e 'afatit të arsyeshëm', duke siguruar atë që do të konsiderohej e arsyeshme:

²⁸² Analysis of legislation introduced to deal with protracted domestic proceedings in Albania, Council of Europe October, November 2017.

²⁸³ Analysis of legislation introduced to deal with protracted domestic proceedings in Albania, Council of Europe October, November 2017, pg. 13.

- a) në lidhje me procedurat administrative në shkallë të parë dhe apelim, përfundimin e gjykimit brenda 1 viti nga fillimi i tij në çdo ²⁸⁴instancë (maksimumi 2 vjet - 1 vit në shkallën e parë + 1 vit në apelim)
- b) në lidhje me procedurat civile, përfundimin e gjykimit brenda 2 vjetëve për gjykatën e shkallës së parë, 2 vjet për Gjykatën e Apelit dhe gjithashtu 2 vjet për Gjykatën së Lartë.
- c) për procedurën e ekzekutimit/përmbarrimit të një vendimi të gjykatës civile ose administrative, afati 1 vjeçar fillon nga dita e paraqitjes së kërkesës për përmbarrim.
- ç) për hetimin e veprave penale, kohëzgjatja maksimale do të jetë siç parashikohet nga Kodi i Procedurave Penale.

Studimi nxjerr konkluzion se, kjo dispozitë përcakton në detaje afatet për çdo nivel dhe për lloje të ndryshme të procedurave. Në thelb, afatet e treguara për gjykatat nuk duken të jenë të paarsyeshme. Por, në këtë dispozitë nuk parashikohet dhe as merret në konsideratë lloji i çështjes dhe kompleksiteti i saj, argumente këto që kërkojnë kujdes të veçantë. Do të ishte e këshillueshme që të ndryshohej kjo në tekstin e ligjit ose gjykatat të krijojnë praktikë gjyqësore ku të parashikonte se në raste të caktuara, kohëzgjatja më e shkurtër ose më e gjatë mund të justifikohet.

Në praktikë, do të ishte e rëndësishme që gjykatat të aplikojnë këtë dispozitë me fleksibilitet dhe të verifikojnë nëse masat e marra për të përshpejtuar procedurat, në të vërtetë kishin një efekt real të shkurtimit të procedurave.

²⁸⁴ Analysis of legislation introduced to deal with protracted domestic proceedings in Albania, Council of Europe October, November 2017, pg.14.

Një aplikant që dëshiron të përdorë instrumentin ligjor, së pari do të duhet të aplikojë që gjykatat të vendosin nëse e drejta e tij për gjykim brenda një kohë të arsyeshme është shkelur dhe vetëm nëse është vendosur ai/ajo duhet të fillojë procedura të veçanta për kompensim. Kjo zgjidhje edhe pse nuk është shumë e zakonshme dhe në pamje të parë e rëndë për aplikantin, ekziston në Poloni dhe Gjermani, ku në parim mjetet juridike konsiderohen të jenë efektive. Sidoqoftë, siç vërtetohet nga çështja e Polonisë, edhe kjo zgjidhje mund të krijojë probleme në varësi të mënyrës së zbatimit të saj në praktikë.²⁸⁵

Parimi kryesor është se i takon gjykatës së shkallës pasardhëse më të lartë që të vendosë për mjetin juridik të kohëzgjatjes, në rastin e Gjykatës së Lartë, instrumenti juridik do të shqyrtohet nga një kolegji tjetër dhe për procedurat përmbarimore nga gjykata e shkallës së parë e cila është kompetente për përmbarimin. Kjo është një zgjidhje e zakonshme në shumë shtete anëtare të Këshillit të Evropës që kanë mekanizma të ngjashëm.

Një çështje e mundshme në këtë drejtim është një problem që ka ndodhur në praktikë në Poloni të një instrumenti juridik që fillimisht u vlerësua si efektiv. Në Poloni, konkretisht, u konstatua se nuk ishte në përputhje me praktikën gjyqësore të Gjykatës për vlerësimin e arsyetshmërisë së kohëzgjatjes së procedurave, veçanërisht aktgjykimet e Gjykatës që konsiderojnë se periudha që duhet të merret në konsideratë përfshin tërësinë e procedurës. Ajo që ishte problematike për GJEDNJ ishte që

²⁸⁵ Analysis of legislation introduced to deal with protracted domestic proceedings in Albania, Council of Europe October, November 2017, pg.15.

gjykatat polake që merreshin me ankesat e kohëzgjatjes aplikuan praktikën e quajtur "fragmentim i procedurave", duke bërë një vlerësim "fragmentar" të kohëzgjatjes së procedurave, të kufizuar në fazën e tyre aktuale.²⁸⁶

Për më tepër, gjatë shqyrtimit të kërkesës për vërtetimin e shkeljes së të drejtës për gjykim brenda një kohe të arsyeshme, gjykata e një më e lartë mund të nxjerrë udhëzime për përshpejtimin e procedurave të cilat janë të detyrueshme për gjykatën që shqyrton bazat e çështjes ose institucionin që është duke ekzekutuar/zbatuar vendimin përfundimtar (neni 399, paragrafi 11).

Ndërsa kjo dispozitë është mjaft e paqartë, ajo i jep të drejtën gjykatave më të larta për të vendosur masa për përshpejtimin e procedurave. Nëse zbatohet si duhet, kjo mund të shpejtojë ndjeshëm procedurat e gjata. Kjo mund të bëhet duke urdhëruar gjykatën e ulët që të japë aktgjykim brenda një afati të caktuar. Sidoqoftë, do të jetë e rëndësishme që kjo praktikë të jetë e qëndrueshme.

Sipas ligjit, nëse institucioni/gjykata ndërmer hapat/masat që pretendohen nga pala/paditësi gjatë kohës së gjykimit, brenda 30 ditëve nga dita e paraqitjes së kërkesës, gjykata e përfundon gjykimin. Nga formulimi i dispozitës, del se vetë palët mund të kërkojnë një masë të tillë. Kjo i jep aplikantit një të drejtë personale t'i kërkojë gjykatës të përdorë kompetencat e saj, siç vërehet në një numër të precedentëve të GJEDNJ-së. Sidoqoftë, duke pasur parasysh që kompensimi mund të kërkohet vetëm

²⁸⁶ Analysis of legislation introduced to deal with protracted domestic proceedings in Albania, Council of Europe October, November 2017, pg.15-16.

kur është konstatuar shkelje e së drejtës për gjykim në një kohë të arsyeshme, në këtë rast aplikanti nuk do të jetë në gjendje të kërkojë një kompensim të tillë.²⁸⁷

Ky kufizim mund të jetë problematik, përveç në rastet kur masa e marrë në të vërtetë ka dhënë kohëzgjatjen e procedurave në përputhje me standardet e GJEDNJ-së. Afati kohor për plotësimin e kërkesës për kompensimin e dëmeve është 6 muaj nga dita kur është konstatuar/përcaktuar shkelja me vendim gjyqësor të formës së prerë. Gjyqi për kompensimin e dëmeve (për shkelje të standardit 'afat i arsyeshëm') parashikohet të zhvillohet sipas të njëjtave procedura të rregullta/të zakonshme të gjyqimit, brenda 3 muajve nga data e plotësimit të padisë. Kështu, në mënyrë ideale dy procedurat e ndara duhet të zgjasin rreth 5 muaj, e cila është në përputhje me standardet e GJEDNJ-së. Sidoqoftë, kjo mbetet për t'u parë në praktikë, veçanërisht duke marrë parasysh shqetësimet e përsëritura në lidhje me njohjen e standardeve të GJEDNJ-së, numrit të pamjaftueshëm të gjyqtarëve dhe stafit gjyqësor dhe gjykatave tashmë të mbingarkuara.

Gjykata vendos për shkeljen bazuar në kompleksitetin e çështjes, objektin e padisë (çfarë është në pyetje), sjelljen e palëve, sjelljen e gjykatës, sjelljen e përmbauesit dhe sjelljen e çdo personi tjetër që lidhet me çështjen (neni 399 , paragrafi 9). Kjo dispozitë merr parasysh disa nga kriteret e përdorura nga GJEDNJ. Ai nuk përfshin kompleksitetin e çështjes dhe shton sjelljen e përmbauesit dhe "çdo person tjetër i lidhur me rastin". Ndërsa personat e tjerë, siç janë ekspertët mund të kontribuojnë në

²⁸⁷ Analysis of legislation introduced to deal with protracted domestic proceedings in Albania, Council of Europe October, November 2017, pg.16.

zgjatjen e procedurave, përgjegjësia është e gjykatës që të administrojë në mënyrë të efektshme procedurat. Do të jetë e rëndësishme që gjykata t'i zbatojë këto kritere në atë frymë dhe jo t'i përdorë në dëm të palëve që përdorin mjetin juridik duke pretenduar se nuk është as gjykata dhe as pala që kanë kontribuar në kohëzgjatjen e procedurës, por përkundrazi përgjegjësia e një eksperti, për shembull.

Në çdo rast, shuma e kompensimit nuk mund të tejkalojë vlerën e objektit të gjykimit/padisë ose ekzekutimit. Pas shqyrtimit të çështjes, gjykata mund të vendosë për kompensimin e dëmeve nga 50 000 lekë në 100 000 lekë për secilin vit vonesë, ose muaj në proporcion me kompensimin vjetor, që tejkalon 'kohën e arsyeshme' standard (neni 399, paragrafi 10). Shumat janë dukshëm më të vogla se shuma maksimale që mund të vendoset nga Kodi Civil dhe kanë një kufi më të ulët dhe të lartë, në krahasim me Kodin Civil që ka vetëm kufirin e fundit. Duke pasur parasysh shumat e vendosura nga GJEDNJ në çështjet kundër Shqipërisë, shumat nuk janë problematike në vetvete. Dispozita që vlera e "shpërblim së drejtë" nuk mund të tejkalojë vlerën e kërkesës, duket se është kufizuese.²⁸⁸

Për më tepër, në rastet që kërkojnë kujdes të veçantë ose në rastet kur ka vonesa shumë serioze, shumat e kompensimit mund të jenë më të larta. Kjo mund të zgjidhet duke shtuar një dispozitë, sipas së cilës nëse shuma e parashikuar në ligj nuk është e drejtë për shkak të rrethanave të çështjes, gjykata mund të lejojë një shumë më të lartë ose më të ulët.

²⁸⁸ Analysis of legislation introduced to deal with protracted domestic proceedings in Albania, Council of Europe October, November 2017, pg.17.

Kjo lloj dispozite u vlerësua pozitivisht nga GJEDNJ në një çështje kundër Gjermanisë në të cilën mjete i brendshëm u konsiderua si efektiv.

Për më tepër, konstatohet se ka mungesë të kriterëve ligjore për llogaritjen e kompensimit për dëmet kur gjykatat vendosin shkelje të standardit kohor të arsyeshëm.

Sa i përket procedurave penale, praktika do të tregojë duke marrë parasysh formulimin e dispozitave nëse mjete juridik është i zbatueshëm në hetimet paraprake. Sipas Rekomandimit CM / Rec (2010) 3 të Komitetit të Ministrave drejtuar shteteve anëtare mbi mjetet juridike efektive për kohëzgjatjen e tepërt të procedurave, shtetet duhet të konstatojnë se mjete të tilla juridike ekzistojnë në lidhje me të gjitha fazat e procedurave në të cilat mund të ketë përcaktim të të drejtave dhe detyrimeve civile ose i ndonjë akuze penale. Gjithashtu, duke pasur parasysh faktin se afatet kohore indikative mund të zgjaten, kjo lejon që të ketë një fleksibilitet në varësi të rrethanave të çështjes, por gjithashtu mund të lërë derën të hapet aq shumë sa që përjashtimi të bëhet rregull edhe kur nuk është i justifikuar. Prandaj do të ishte e këshillueshme që të merren parasysh masa shtesë për procedurën penale, siç është mundësia për të korrigjuar vonesat e mëparshme përmes mundësisë për të marrë një ulje të dënimit të shqiptuar ndaj të pandehurit të dënuar.

Ligji parashikon veprim disiplinor për gjyqtarët, por siç theksohet më lart në tekst, sipas GJEDNJ veprimi disiplinor në vetvete ka të bëjë me pozitën personale të gjyqtarëve përgjegjës, por nuk rezulton në ndonjë pasojë të drejtpërdrejtë dhe të menjëhershme për procedurat pasi që nuk mund as ta përshpejtojë përcaktimin e

çështjes dhe as t'i ofrojë aplikantit kompensimin e duhur për vonesat e ndodhura tashmë.

Nëse përdoret me kujdes dhe jo si një mjet kontrolli i gjyqtarëve nga degët e tjera të qeverisë, gjithsesi, ai mund të kontribuojë në një administrim më aktiv të çështjeve gjyqësore nga gjyqtarët.²⁸⁹

Së fundi, në përputhje me kriteret e GJEDNJ për mjetet ligjore efektive për procedurat e gjata brenda vendit, ligji mund të ndryshohet në mënyrë që të sigurojë që procedurat për kompensimin i nënshtrohen tarifave gjyqësore, të cilat mund të rimbursohen sipas kuotës së suksesit në gjykatë, duke ndjekur shembullin e Polonisë dhe Gjermanisë që kanë sistem të ngjashëm të mjeteve ligjore për kohëzgjatjen.

²⁸⁹ Analysis of legislation introduced to deal with protracted domestic proceedings in Albania, Council of Europe October, November 2017, pg.18.

KREU VII

KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

7.1. Hyrje

Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore të formës së prerë është tashmë një element procedural, i cili trajtohet si pjesë integrale e të drejtës për një proces të rregullt ligjor. E drejtë kjo e njohur shprehimisht nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë si një e drejtë themelore e individit. Ky këndvështrim i jep trajtimit të saj, jo vetëm një rol të rëndësishëm për realizimin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut, por rrjedhimisht edhe një ndikim të fuqishëm në veprimtarinë gjyqësore në vendin tonë. Objekt i këtij punimi ishte pikërisht analiza e institutit juridik të ekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë, si pjesë e procesit të rregullt ligjor, kategori e të drejtave themelore të njeriut. Procesi i ekzekutimit të vendimeve të formës së prerë është i mirë përcaktuar në legjislacionin tonë. Por pas ndjekjes së hapave procedurale shumë individë e gjejnë ende veten me një urdhër ekzekutimi i cili endet prej kohësh i pa ekzekutuar. Kjo përbën shkelje të procesit të rregullt ligjor.

7.2. Konkluzione dhe rekomandime

Ky punim u përpoq të paraqiste një panoramë të përgjithshme lidhur me të gjitha këndvështrimet për implementimin e këtij instituti. Nga analiza e realizuar dalim në konkluzione si më poshtë vijon:

1. Ekzekutimi i vendimeve është një koncept shumë dimensional dhe multidisiplinor. Përtej faktit të qenit një marrëdhënieve juridikë procedurale, ky institut mbi bazën e legjislacionit tonë, atij të KEDNJ, jurisprudencës të GJEDNJ dhe të Gjykatës

Kushtetuese, është element përbërës i të drejtës për një proces të rregullt ligjor dhe si i tillë kategorizohet si e drejtë themelore e njeriut. Njohja, zbatimi dhe garantimi i tij përbën kusht për ekzistencën e shtetit të së drejtës.

Rekomandim

